



**GAZETA ZYRTARE E INSTITUCIONEVE TË
PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË**

PRISHTINË
.....
VITI III / NR.22 / 1 MARS 2008

GAZETA ZYRTARE E INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË

Editon: Zyra për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, botohet në mbështetje të *Ligjit për Gazetën Zyrtare nr. 2004/47; si dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/25 për shpalljen e Ligjit për Gazetën Zyrtare.*

Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë boton tekstet zyrtare dhe përfundimtare të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe të shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm; rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, rregullativat dhe aktet e tjera normative të Qeverisë dhe ministrive; marrëveshjet e karakterit ndërkombëtar etj.

Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, botohet në pesë gjuhë: në gjuhën shqipe, angleze, serbe, turke dhe atë boshnjake.

Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë administrohet nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës.

Mbikëqyrja editoriale:

Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit, **FITIM KRASNIQI**

Drejtor i Zyrës për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë:

Naser Canolli

Redaktor përgjegjës:

Mentor Hoxha

Redaksia

Shqipe Fazliu - Gashi

Adresa dhe korrespondencat:

Ndërtesa e re e Qeverisë,

Prishtinë

gazetazyrtare@ks-gov.net

038-201 14039

www.ks-gov.net/gazetazyrtare

NË RAST MOSMARRËVESHJEJE NDËRMJET VERSIONEVE TË DOKUMENTEVE TË
NDRYSHME TË SHPALLURA NË GAZETËN ZYRTARE TË IPVQ-VE TË KOSOVËS,
VERSIONET NË GJUHËT ZYRTARE TË QEVERISË, NË PËRPUTHJE
ME PARAGRAFIN 9.3.19 TË KORNIZËS KUSHTETUESE, JANË NJËSOJ AUTENTIKE

PËRMBAJTJA

<i>LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË.....</i>	<i>1</i>
<i>LIGJI PËR ENERGJINË.....</i>	<i>17</i>
<i>LIGJI I SPORTIT.....</i>	<i>28</i>
<i>LIGJI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE.....</i>	<i>36</i>
<i>LIGJI PËR INSPEKTORATIN SANITAR TË KOSOVËS.....</i>	<i>45</i>
<i>LIGJI PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME.....</i>	<i>51</i>
<i>LIGJI PËR MATERIALIN FIDANOR.....</i>	<i>57</i>

LIGJ NR. 2004 / 9

PËR RREGULLATORIN E
ENERGJISË

Kuvendi i Kosovës,

Duke marrë parasysh Rregulloren e Misionit të Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë 1999/1 të datës 25 korrik 1999, Mbi Autoritetin e Administratës të Përkohshme në Kosovë;

Duke u bazuar në kompetencat e dhëna Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/9 të 15 majit 2001, mbi "Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje" sidomos Neni 5.1(ç), 9.1.26 (a) dhe 11.2;

Duke marrë parasysh kompetencat e rezervuara të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në nenin 8.1 (m) të Kornizës Kushtetuese.

Duke parë nevojën për themelimin e organit rregullativ të pavarur për sektorin e energjisë për tu siguruar konsumatorëve të Kosovës energji të qëndrueshme, të sigurtë duke mos dëmtuar mjedisin, dhe për të themeluar, promovojë dhe mbrojtë tregun e lirë dhe konkurses të energjisë që bazohet në parime objektive, transparente dhe jo-diskriminuese;

Miraton në vijim:

LIGJIN PËR RREGULLATORIN E
ENERGJISËKREU 1
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj themelon Rregullatorin e Pavarur për Energji dhe përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji; kushtet për nxjerrjen e licencës për të kryer aktivitete në fushën e energjisë; procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese; kriteret për rregullimin e çmimeve dhe kushtet për furnizim me energji.

Neni 2

Qëllimet e këtij ligji janë që të themelojë kornizën rregullative për sektorin e energjisë që do të sigurojë:

- a) funksionimin transparent dhe jo-diskriminues të tregut të energjisë bazuar në parimet e tregut të lirë;

- b) kryerjen e aktiviteteve të energjisë në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese, që janë subjekt i detyrimeve të shërbimeve publike;
- c) kriteret transparente dhe të hapura për dhënien e licencave dhe autorizimeve;
- d) kryerjen e aktiviteteve të energjisë sipas rregulloreve për çmimet e energjisë që rregullohen në bazë të sistemit tarifor;
- e) që asnjë ndërmarrje për energji të mos abuzojë me pozitën dominuese dhe ndalimin e praktikave jo-konkurrese;
- f) që të gjithë konsumatorët të mund t'i kyçin stabilitetet e tyre në rrjetat për furnizim universal me energji, kurdoherë që kjo të jetë e mundur teknikisht dhe ekonomikisht;
- g) që konsumatorët dhe të licencuarit të jenë të mbrojtur me procedura adekuate për zgjidhjen e kontesteve;
- h) që interesi në mes konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji të jetë i balancuar mirë;
- i) zbatimin e masave të arsyeshme për të forcuar unitetin social dhe ekonomik në tërë Kosovën;
- j) përmirësimin gradual të standardeve për mbrojtje të mjedisit;
- k) siguri në furnizim me energji elektrike, energji për ngrohje dhe gaz natyral me anë të mirëmbajtjes dhe ndërtimit të kapaciteteve prodhuese dhe bartëse të nevojshme si dhe infrastrukturës të rrjetës përfshirë kapacitetet e interkoneksionit.

Neni 3

- 3.1. Termet që përdoren në këtë ligj kanë domethënie si në vijim:

" **Informata konfidenciale** " janë të dhëna, dokumente apo informacione të tjera, komerciale apo teknike, që kanë të bëjnë me disajnin, rehabilitimin, sigurinë, veprimin, mirëmbajtjen dhe financimin e veprimeve energjetike apo aktivitete që nuk janë më në domenin publik dhe që shpallja e tyre mund të vëjë në rrezik interesat komercial të aplikantëve apo të të licencuarëve;

" **procedurat e zgjidhjes së kontesteve** " janë procedura të nxjerra nga Zyra e Rregullatorit për Energji në pajtim me këtë ligj për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë;

" **Zyra e Rregullatorit për Energji** " është organ i pavarur rregullator që themelohet me këtë ligj;

" **tarifat e bazuara në performansë** " është përfshirja e një stimulimi për përmirësimin e shërbimeve në tarifën ekzistuese, përfshirë faktorin produktiv, që kushtëzon ndërmarrjet e rregulluara që me kalimin e kohës të përmirësojnë efikasitetin, si dhe përfshirja e dënimeve për mosarritjen e standardeve të përshk-

LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË

ruara të performancës.

“**dokumentacioni i projektit**” është dokumentacioni i hartuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji ku paraqet projektin për një vit kalendarik;

“**shërbimet publike të detyrueshme**” janë detyrimet që i përshkruhen një ndërmarrjeje të energjisë të cilës i është besuar ofrimi i shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, që ka parasysh faktorët e përgjithshëm socialë, ekonomikë dhe mjedisorë.

“**shkelje e përsëritur**” është kryerja e një veprimi kundër ligjor në bazë të të cilit kryersi i veprës ka përsëritur veprën e tillë brenda një viti;

“**sigurimi i furnizimit**” është siguria teknike si dhe siguria për një sasi adekuate të energjisë për të përmbushur nevojat për furnizim.

“**procedurat e tenderimit**” janë procedurat e publikuara për kryerjen e një tenderi që specifikojnë formularët e nevojshëm, instrukcionet dhe dokumentacionin ku janë planifikuar nevojat dhe kërkesat për kapacitete për të përmbushur furnizimin nga kapacitetet ekzistuese apo kapacitetet e reja prodhuese.

“**Ndërmarrje e energjisë e integruar vertikalisht**” është ndërmarrje që merr pjesë në dy apo më shumë funksione (bartje, distribuim, prodhim dhe furnizim) brenda sektorit të njëjtë energjetik (energji elektrike, gaz dhe ngrohje)

3.2. Termat tjerë në këtë ligj, do të kenë domethënie, siç është cekur në Ligjin për Energjinë apo në ligjin për Energjinë Elektrike.

KREU 2**ORGANIZIMI I ZYRËS
SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI****Neni 4**

4.1. Zyra e Rregullatorit për Energji themelohet me këtë ligj si një organ i pavarur në bazë të nenit 11.2 të Kornizës Kushtetuese me qendër në Prishtinë për rregullimin e aktiviteteve në sektorin e energjisë në Kosovë.

4.2. Zyra e Rregullatorit për Energji kryen detyra në bazë të këtij ligji, ligjeve të tjera dhe memorandumeve të mirëkuptimit.

Neni 5

5.1 Zyra e Rregullatorit për Energji do të drejtohet nga bordi (“Bordi”) që përbëhet nga pesë anëtarë përf-

shirë kryesuesin. Çdo anëtarë do të jetë në marrëdhënie pune të rregulltë.

5.2. Anëtarët e mandatit të parë të Bordit do të emërohen si vijon brenda 60 ditë pas shpalljes të këtij ligji:

a) tre anëtarë, përfshirë edhe kryesuesin, do të emërohen nga PSSP-ja pas konsultimeve me Zv-PSSP-në të Shtyllës të BE-së dhe Kuvendin e Kosovës;

b) dy anëtarë do të propozohen nga Qeveria, miratohen nga Kuvendi, dhe emërohen nga PSSP-ja;

5.3. Mandati i anëtarëve të parë të Bordit që do të emërohen sipas Nenit 5.2 (a), është:

a) 2 vjet për kryesuesin;

b) 2 vjet për një anëtar;

c) 3 vjet për një anëtar.

5.4. Mandati i anëtarëve të parë të Bordit që do të emërohen sipas Nenit 5.2 (b), është:

a) 4 vjet për një anëtar;

b) 5 vjet për një anëtar.

5.5. Anëtarët e ardhshëm të Bordit do të propozohen nga Qeveria dhe do të emërohen nga Kuvendi.

5.6. Mandati i anëtarëve të ardhshëm do të jetë nga pesë vite.

5.7. Çdo anëtar i Bordit, përfshirë edhe anëtarët e parë, mund të riemërohen edhe për një mandat tjetër pesë vjeçar.

Neni 6

6.1. Me përjashtim të kryesuesit të parë të Bordit, të gjithë anëtarët e tjerë të Bordit do të jenë banorë të përherëshëm të Kosovës.

6.2. Anëtarët e Zyrës të Rregullatorit për Energji duhet të kenë kualifikime universitare dhe pesë (5) vjet përvojë pune në lëminë e inxhinjerisë, ekonomisë, menaxhmentit, kontabilitet apo drejtësisë.

6.3. Anëtarët e Bordit nuk do të:

a) jenë zyrtarë qeveritar;

b) jenë anëtarë aktivistë të apo kryejnë punë nëpër parti politike apo shoqata politike;

c) jenë ata vetë, bashkëshortet/ët e tyre dhe kushërinjët nga linja direkte, pronarë apo menaxhues

LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË

të ndonjë subjekti juridik pjesëmarrës në aktivitetet të energjisë ku dispozitat e këtij ligji mund të aplikohen;

- d) bëjnë çfarëdo pune në ndonjë ndërmarrje për energji të cilës mund t'i aplikohen dispozitat e këtij ligji;
- e) kryejnë asnjë aktivitet tjetër që mund të rezultojë në konflikt interesash sipas Kodit Profesional të Punës.

Neni 7

7.1. Organi që bën emërimin e anëtarëve të Bordit do të shkarkojë një anëtar para përfundimit të mandatit të tyre vetëm në rastet kur anëtari:

- a) parashtron dorëheqjen;
- b) bën shkelje serioze të detyrave profesionale;
- c) është i dënuar për një vepër penale në bazë të këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër;
- d) nuk është në gjendje të kryej detyrat për më shumë se tre muaj me rradhë nga aspekti fizik apo mental;
- e) bën shkeljen e Kodit Profesional të Punës të nxjerrë sipas këtij ligji; dhe
- f) shkel kushtet e përcaktuara me nenin 6.
- g) dështon të marrë pjesë në tri mbledhje me radhë, apo pesë mbledhje gjatë një viti kalendarik, për çfarëdo arsye tjetër, përpos arsyeve të justifikuara mjekësore.

7.2. Në rastet e përshkruara në paragrafin (1), do të emërohet një anëtar tjetër të shërbejë gjer në fund të mandatit të anëtarit që trashëgon në pajtim me dispozitat e nenit 5.

Neni 8

8.1. Asnjë anëtar i Bordit nuk mund të ketë statusin e nëpunësit civil.

8.2. Anëtarët e Bordit do të paguhet me rroga mujore dhe mëditje udhëtimi apo mëditje të tjera sipas pëlqimit të PSSP-së për anëtarët e parë dhe sipas pëlqimit të Qeverisë për anëtarët e ardhshëm.

8.3. Rroga mujore e anëtarëve të Bordit që janë banorë të përhershëm të Kosovës nuk do të jetë më e vogël se pesë rroga mujore mesatare të një nënpunësi të sektorit publik.

8.4. Rroga mujore e anëtarit ndërkombëtar të Bordit do të caktohet nga PSSP-ja, duke u bazuar në përvojën parapake dhe përgjegjësitë e postit dhe fondet e lira.

8.5. Për një periudhë një vjeçare pas mbarimit të mandatit si anëtar i Bordit, personi i tillë nuk do të lejohet të paraqitet para Bordit në emër të një ndërmarrje

për energji që është licencuar në bazë të këtij ligji, apo një entitet që kontrollohet në mënyrë direkte apo indirekte nga një ndërmarrje e licencuar.

Neni 9

9.1. Përpos përgjegjësisë të përcaktuara me këtë ligj, Bordi i Zyrës të Rregullatorit për Energji do të:

- a) miratojë politikën rregullative dhe operacionale;
- b) organizojë dhe mbikëqyrë aktivitetet menaxhuese të Zyrës të Rregullatorit për Energji;
- c) mbikëqyrë menaxhimin e buxhetit dhe atë financiar të Zyrës të Rregullatorit për Energji dhe bën aprovimin e raporteve dhe të dhënave financiare të kësaj zyreje;
- d) emërojë dhe mbikëqyrë menaxhmentin dhe stafin e Zyrës të Rregullatorit për Energji;
- e) miratojë kushtet dhe konditat për punësim për menaxhimin e stafit të Zyrës të Rregullatorit për Energji.
- f) Nxjerrë akte nënligjore të përgatitura nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që janë në pajtim me këtë Ligj.

9.2. Kryesuesi i Bordit do të përfaqësoj Zyrën e Rregullatorit të Energjisë me palët e treta.

9.3. Bordi do të përgatitë dhe miratojë Statutin e Zyrës të Rregullatorit për Energji në bazë të së cilit do të qeveriset organizimi dhe veprimi i Zyrës, përfshirë aktivitetet e zyrës, strukturën e zyrës, procedurat për punësimin e stafit administrativ dhe atij menaxhues si dhe çështjet që kanë të bëjnë me organizimin e punës.

9.4. Statuti përcakton procedurat për punësimin e stafit administrativ dhe menaxhues në bazë të kontratave për një periudhë të caktuar. Stafi administrativ kryen punët teknike dhe administrative që nevojiten për përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të Zyrës të Rregullatorit për Energji.

9.5. Statuti gjithashtu përcakton kërkesat për një auditim publik të jashtëm dhe të pavarur për aktivitetet dhe funksionet e ndërmarrja të Zyrës të Rregullatorit për Energji.

Neni 10

Kryesuesi i Zyrës të Rregullatorit për Energji i dërgon Kuvendit dhe PSSP-së, çdo vit raportin vjetor, tre muaj pas mbylljes së vitit kalendarik. Raporti duhet të jetë publik dhe të përfshijë:

- a) përshkrimin e aktiviteteve për çështjet që lidhen me funksionin, detyrat, kompetencat e Zyrës të Rregullatorit për Energji si dhe zhvillimet në tregun konkurrues të energjisë;

LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË

- b) përshkrimin e të gjitha vendimeve individuale të ndërmarrja, zgjidhjen e kontesteve si dhe procedurave zbatuese të ndërmarrja nga Zyra e Rregullatorit për Energji gjatë vitit të kaluar;
- c) përshkrimin e licencimeve dhe aktiviteteve të tjera gjatë vitit të kaluar;
- d) raport për veprimet financiare të Zyrës të Rregullatorit për Energji për vitin e kaluar, përfshirë këtu shumën e taksave të mbledhura nga Zyra e Rregullatorit për Energji si dhe shpenzimet e bëra;
- e) çdo çështje tjetër që Kuvendi dhe PSSP-ja mund ta kërkojë kohë pas kohe.

Neni 11

11.1. Anëtarët e Bordit të Zyrës të Rregullatorit për Energji hartojnë dhe nxjerrin Kodin Profesional të Punës për anëtarët dhe punëtorët tjerë për të siguruar që punët të kryhen me përgjegjësi dhe ndershmëri, duke ju larguar konflikeve të mundshme të interesit.

11.2. Kodi Profesional i Punës do të ndalojë anëtarët e Bordit dhe punëtorët nga:

- a) pranimit i ndonjë të mire financiare, direkt apo tërthorazi, nga cilado ndërmarrje për energji, përfshirë, por duke mos u kufizuar, para, mall, patundshmëri, dhurata, udhëtime apo shërbime personale;
- b) pronësimi, ose të ushtrojë menaxhmentin e kontrollit mbi veprimet e një ndërmarrjeje për energji apo bartësve edhe trashëgimtarëve titullar të tyre.

Neni 12

Zyra e Rregullatorit për Energji sipas nevojës mund të emërojë konsulentë apo këshilltarë, që ta ndihmojnë gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve në bazë të parimeve të hapura, transparente dhe jo-diskriminuese sic janë përcaktuar në statut. Çdo shpenzim, për një konsulent apo këshilltar të angazhuar në bazë të këtij neni, bëhet në baza konkurruese. Këto shpenzime janë pjesë e shpenzimeve të përgjithshme të Zyrës të Rregullatorit për Energji.

Neni 13

13.1. Zyra e Rregullatorit për Energji ka të drejtë të kërkojë nga secila ndërmarrje për energji apo autoritet publik çdo informatë, të dhëna dhe dokumentacione të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, përfshirë edhe informacionet konfidenciale.

13.2. Zyra e Rregullatorit për Energji do të marrë një vendim të prerë në rast se një material përbën informacion konfidencial në pajtim më aktet nënligjore të

nxjerra nga Zyra e Rregullatorit për Energji .

13.3. Informacionet e mbledhura që përbëjnë informacion konfidencial nuk lejohet të zbulohen, përveç për organet me jurisdiksion apo organet tjera publike, sipas procedurave të themeluara me ligj.

Neni 14

14.1. Të gjitha autoritetet publike dhe ndërmarrjet për energji, së bashku me zyrtarët e tyre, duhet të japin gjithë ndihmën Zyrës të Rregullatorit për Energji për të mundësuar ushtrimin e detyrave të saj.

14.2. Gjatë ushtrimit të funksioneve, kompetencave dhe detyrave të saja, Zyra e Rregullatorit për Energji, mund të bashkëpunojë me persona apo organizata që përfaqësojnë apo ruajnë interesat e konsumatorëve.

KREU 3

KOMPETENCAT E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Neni 15

15.1. Zyra e Rregullatorit për Energji ka përgjegjësi për themelimin dhe ekzekutimin e nje kornize rregullative për sektorin e energjisë në Kosovë, që do sigurojë jo-diskriminimin, konkurrencën efektive, dhe funksionimin e tregut të energjisë.

15.2. Për përmbushjen e përgjegjësisve, Zyra e Rregullatorit për Energji ka kompetencat në vijim:

- a) të japë, modifikojë, suspendojë dhe tërheqë licencat;
- b) të mbikëqyrë dhe kontrollojë pajtueshmërinë me kushtet e licencës;
- c) të miratojë, monitorojë dhe fuqizojë tarifa dhe metodologji tarifore për shërbimet e energjisë;
- d) të jap leje për ndërtimin dhe veprimin e kapaciteteve të reja prodhuese dhe sistemin e gazsjelësve përfshirë linjat gypore direkte dhe linjat direkte të energjisë elektrike;
- e) të monitorojë ndarjen e formës juridike, organizative, vendim-marrëse dhe llogarive të ndërmarrjeve për energji;
- f) të përcaktojë kushtet dhe konditat e përgjithshme për furnizim si dhe standardet e kualitetit që duhen përmbushur nga i licencuari;
- g) të zgjidhë kontestet në mes konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve;
- h) të hartojë akte të përgjithshme, individuale dhe

LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË

- akte tjera nënligjore në pajtim me këtë ligj;
- i) të ndryshojë, miratojë, kontrollojë pajtueshmërinë me të gjitha kodet, kodin për rrjetet, kodin për distribuim, kodin për mbrojtjen e konsumatorëve, kodin për pajisjet e energjisë elektrike, kodin e standardeve elektrike, kodin e tregut dhe kodin matës;
 - j) të ndryshojë, miratojë dhe kontrollojë pajtueshmërinë me të gjitha rregullat teknike, përfshirë rregullat e tregut dhe rregullat për qasje;
 - k) zbaton dispozitat e këtij ligji dhe vendosë gjoba për shkëlqen e tyre;
 - l) të kryejë detyra tjera të përcaktuara me këtë ligj apo ligje tjera.
- 15.3. Gjatë ushtrimit të kompetencave të veta Zyra e Rregullatorit për Energji bën:
- a) dhënien e pëlqimit për ndarje, bashkim apo reduktim të kapitalit fillestar për ndërmarrjet për energji të licencuara në bazë të këtij ligji;
 - b) dhënien e pëlqimit për përbarimin e pronave të përdorura për kryerjen e aktiviteteve të licencuara në rastet që çojnë apo mund të çojnë në pengimin e furnizimit të mirëfilltë me energji për shkak të borxhit të ndërmarrjes energjetike.
 - c) marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me klasifikimin e linjave të energjisë elektrike, gypërçuesve të energjisë ngrohëse, gazsjellësit të gazit natyral dhe depove të tjera sekondare, rrjetin e bartjes dhe distribuimit dhe të nxjerrë instruksione për blerjen e tyre apo të mundësojë qasje për to sipas kushteve të propozuara nga kompania përkatëse për bartje apo distribuim;
 - d) shqyrtimin e kërkesave të ndërmarrjeve energetike për kompenzim të shpenzimeve standarde të parikoperuara dhe të marrë vendime mbi shumën e arsyeshme dhe metodën e kompenzimit të tyre;
 - e) nxjerrjen e çertifikatave të origjinës për energjinë elektrike që është prodhuar nga burime riprodhuese nga hedhurinat dhe bashkëprodhimi i energjisë elektrike dhe asaj ngrohëse;
- 15.4. Zyra e Rregullatorit për Energji gjithashtu ka përgjegjësi veçanërisht të siguroj që:
- a) kushtet, konditat dhe tarifat për lidhjen e prodhuesve të rinj të energjisë elektrike apo ngrohëse të jenë objektive, transparente e jodiskriminuese, të marrë parasysh shpenzimet dhe beneficinet e burimeve të ndryshme të energjisë të riprodhuar, teknologjive të reja, distribuimin e prodhimit dhe kombinimin e energjisë ngrohëse dhe energjisë elektrike;
 - b) të përmbushen detyrat e operatorëve të sistemit për bartje dhe distribuim;
 - c) të krijohet dhe mirëmbahet tregu konkurrues, aty ku praktikohet, si dhe të pengoj e dënoj veprimet antikonkurruese;
 - d) të themelohen mekanizmat që mundësojnë veprime kur kapacitetet në sistemet e energjisë elektrike dhe të gazit janë përplot të mbushura;
 - e) rregullat për menaxhmentin dhe ndarjen e kapaciteteve ndërlidhëse të jenë transparente dhe jodiskriminuese;
- Neni 16**
- 16.1. Zyra e Rregullatorit për Energji mund të ndërmarrë masa që i vlerëson të nevojshme për të parandaluar apo rregulluar gjendjen në rastet e:
- a) abuzimit me pozitën dominante të ndonjë të licencuari,
 - b) përfundimin e synuar apo tentimin për të mbyllur një marrëveshje nga cilido i licencuar, veprime këto që po të mos pengohen mund të sjellin restriktionin, obstrukcionin apo prishjen e konkurrencës.
- 16.2. Çdo veprim i ndërmarrë nga Zyra e Rregullatorit për Energji në bazë të paragrafit (1) të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me Ligjin për Energji dhe cilindo ligj të konkurrencës në fuqi në Kosovë.
- Neni 17**
- 17.1. Zyra e Rregullatorit për Energji mund të hartojë procedura për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë përfshirë ankesat:
- a) nga konsumatorët kundër të licencuarëve që kanë të bëjnë me shërbimet e ofruara;
 - b) nga i licencuari kundër të licencuarëve të tjerë, që ka të bëjë me performansën e aktiviteteve të licencuara;
 - c) që kanë të bëjnë me qasjen e palës së tretë dhe bartjes, distribuimit të energjisë elektrike apo rrjetës të gazit natyral si dhe bartjes ndërkufitare të energjisë elektrike dhe gazit natyral .
- 17.2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve mund t'ia jap një ndërmarrjeje të energjisë, një grupi për arbitrazh, apo ndonjë organi tjetër për zgjidhjen e kontesteve, autoritetin për t'u marrur me ankesa të caktuara. Procedurat poashtu sigurojnë që Zyra e Rregullatorit për Energji mund të marrë edhe vendime apo të jap mendime që do të kontribuojnë në zgjidhjen e kontesteve.
- 17.3. Procedurat e zgjidhjeve të kontesteve, do të themelohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji, me aktet nënligjore të këtij ligji.

LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË

Neni 18

18.1. Zyra e Rregullatorit për Energji do të mbajë regjistrin publik mbi:

- a) të gjitha licencat e lëshuara me gjithë detajet e atyre licencave;
- b) të gjitha certifikatat e origjinës të lëshuara, me gjithë detajet mbi bartësin, kuantitetin e energjisë elektrike për të lëshuar si dhe periudha dhe vendodhja e prodhimit;
- c) të gjithë personave që u është dhënë statusi i konsumatorëve të privilegjuar që me kërkesën e tyre duan të figurojnë në regjistër.

18.2. Procedurat për mirëmbajtjen e një regjistri publik dhe detajet që do evidentohen në regjistrin publik do të themelohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji në një akt nënligjor të këtij Ligji.

KREU 4

FINANCIMI I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Neni 19

Aktivitetet e Zyrës të Rregullatorit për Energji dhe të administratës së saj financohen nga të hyrat në vijim:

- a) taksat e mbledhura dhe të caktuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë sipas këtij ligji;
- b) donacionet nga persona të ndryshëm me përjashtim: të të licencuarve dhe personave që janë të kontrolluar drejtpërdrejt apo indirekt nga të licencuarit; nga grupe lobistësh, grupe interesash apo shoqata të konsumatorëve;
- c) Për periudhën fillestare prej një viti kalendarik pas themelimit të Bordit do të financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Përderisa këto shpenzime nuk mbulojnë shpenzimet operacionale duke përfshirë edhe pagat e personelit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, shpenzimet e tilla do të financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, parësisht nga paragrafi (c) lart;

Neni 20

20.1. Me qëllim të përbalimit të shpenzimeve të saj, Zyra e Rregullatorit për Energji do të hapë llogarinë bankare dhe aty depoziton të gjitha të ardhurat e mbledhura në pajtim me nenin 19 të këtij ligji.

20.2. Të gjitha të hyrat e mbledhura nga Zyra e Rregullatorit për Energji depozitohen sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/17 mbi "Ligjin për Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësisë" dhe ligjet në fuqi që rregullojnë

kontabilitetin në Kosovë.

20.3. Të gjitha fondet suficitare të mbledhura nga Zyra e Rregullatorit për Energji, do të mbesin në xhironlogarinë e saj bankare dhe mund të përdoren për shpenzimet e bëra gjatë viteve vijuese, me përjashtim të shpenzimeve për rroga, kompenzimeve në punë, apo përfitimeve të tjera individuale - financiare për anëtarët e Bordit, menaxherët dhe stafin e Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Neni 21

Zyra e Rregullatorit për Energji duhet t'i përdorë fondet e depozituara në llogarinë e saj bankare për qëllimet vijuese:

- a) financimin e aktiviteteve të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe administratës ku përfshihen: shpenzimet operative, pagat, beneficionet e stafit dhe të të punësuarve, shpenzimet e studimeve, analizave, vlerësimeve dhe hulumtimeve të bëra nga ekspertë që kanë të bëjnë me funksionet e Zyra të Rregullatorit për Energji sipas këtij ligji;
- b) shpenzime kapitale për zhvillimin e aseteve materiale;
- c) përmirësimin e kualifikimeve të anëtarëve të bordit, menaxhmentit dhe punëtorëve;
- d) pagesën e borxheve ligjore që janë mbledhur si rezultat i kryerjes së funksioneve, detyrave apo kompetencave të Zyrës të Rregullatorit për Energji sipas këtij ligji apo akteve të tij nënligjore.

Neni 22

22.1. Para fillimit të çdo viti financiar, Zyra e Rregullatorit për Energji përgatitë një projekt dokument ku përfshihen përgjithësisht të gjitha projektet dhe punët e parapara që propozon t'i ndër marrë gjatë vitit vijues.

22.2. Projekt dokumenti bashkë me raportin vjetor financiar do t'i parashtrohet Kuvendit për shqyrtim.

22.3. Zyra e Rregullatorit për Energji përgatitë buxhetin vjetor çdo vit kalendarik në të cilin përfshihen:

- a) shuma e paraparë për projektet e përcaktuara në projekt dokument;
- b) shumën e detajuar për shpenzimet të cilat Zyra e Rregullatorit për Energji e planifikon t'i bëjë gjatë një viti pune;
- c) shumën e detajuar të të ardhurave që Zyra e Rregullatorit për Energji e parashikon të mbledhë gjatë një viti pune.
- d) një shumë të caktuar, që mund të nevojitet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për atë vit.

LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË

- 22.4. Për të marrë ndarjen buxhetore nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovë, Zyra e Rregullatorit për Energji parashtron kërkesën për buxhet si organizatë buxhetore e Kuvendit në pajtim me procedurat e përcaktuara në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- 22.5. Përderisa këto shpenzime nuk mbulojnë shpenzimet operacionale duke përfshirë edhe pagat e personelit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, shpenzimet e tilla do të financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, pavarësisht nga paragrafi (c) lart; Përvetësimet (ndarjet buxhetore) e tilla nuk do të interpretohen si detyrime, ose garancione për dhe nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, për mbulimin e çfarëdo mungese, ndërmjet shpenzimeve të përgjithshme të bëra nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe të ardhurat që ajo i mbledh në përputhshmëri me Nenin 20.
- 22.6. Buxheti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, do të paraqesë një vlerësim të balancit ndërmjet çmimeve dhe shpenzimeve të përgjithshme të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, si dhe të ardhurat e përgjithshme të rregullatorit në fjalë, vlerësim ky edhe për të ardhurat e vet rregullatorit, e edhe për çfarëdo përvetësimi nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.
- 22.7. Gjatë vlerësimit të të ardhurave, Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të lejojë një shumë të arsyeshme për borxhe të këqia, shumë kjo që është e barabartë me, së paku dhjetë (10) % të shumës së përgjithshme, të tarifave që pritet të mblidhen nga ndërmarrjet energjetike, përveç ndërmarrjeve në pronësi shoqërore.
- 22.8. Ministri i Financave dhe Ekonomisë emëron një auditor të kualifikuar për auditimin e llogarive dhe aktiviteteve të Zyrës të Rregullatorit për Energji.
- a) taksat fillestare për nxjerrjen apo ndryshimin e licencës, shpenzimet për përgatitjen e tyre dhe për kryerjen e aktiviteteve rregullatore deri në mbarim të vitit kalendarik;
- b) taksat vjetore për kryerjen e aktiviteteve rregullatore për çdo vit përkatës.
- 24.3. Taksat vjetore do të paguhën nga të licencuarit në fillim të çdo viti kalendarik ose përmes kisteve mujore sic mund të jetë dakorduar Zyra e Rregullatorit për Energji dhe i licencuari dhe gjithmonë duhet të paguhet në një xhironlogari bankare.
- 24.4. Taksat për nxjerrjen e çertifikatave të origjinës paguhën për nxjerrjen e secilës çertifikatë.
- 24.5. Taksat për zgjidhjen e kontesteve do të paguhën në apo para datës të shqyrtimit të kontestit. Nga secila palë në mosmarrëveshje, mund të kërkohet që të parapaguajë një pjesë të tarifës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Më zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, palës që ka dështuar mund t'i kërkohet që t'ia paguajë palës fitimtare pjesën e saj të tarifave të parapaguara.
- 24.6. Me përjashtim të taksave vjetore, taksat e vëna në bazë të këtij neni do të mblidhen në pajtim me shpenzimet administrative të dala nga procesimi i akteve të cilat u referohen taksat e tilla.
- 24.7. Taksat vjetore do të vendosen në mënyrë që të mundësohet vet financimi dhe veprimi efikas financiar i Zyrës të Rregullatorit për Energji për të arritur qëllimet adekuate me autoritetet rregullative që vepron në rrethana të ngjashme dhe që në asnjë rast nuk tejkalojnë shumën e 2% (dy përqindëshit) të qarkullimeve bruto të ndërmarrjeve të energjisë të cilave u kërkohet të paguajnë taksat e tilla.
- 24.8. Taksat mund të paguhën kesh apo në llogarinë bankare të Zyrës së Rregullatorit për Energji. Për çdo pagesë të bërë kesh, Zyra e Rregullatorit për Energji lëshon faturë dhe një kopje e mban për vete. Për çdo depozitim bankar fatura e depozitimit i dërgohet Zyrës të Rregullatorit për Energji.
- 24.9. Procedurat dhe afatet për pagesa të taksave do të vendosen në një akt nënligjor të nxjerrë nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

KREU 5**TAKSAT****Neni 23**

Zyra e Rregullatorit për Energji mbledh taksat për shqyrtimin e aplikacioneve, për licencat dhe për lëshimin e çertifikatave të origjinës si dhe taksat për zgjidhjen e kontesteve.

Neni 24

24.1. Taksat për shqyrtimin e aplikacioneve paguhën gjatë parashtrimit të aplikacionit.

24.2. Taksat për licencë përfshijnë:

KREU 6**PROCEDURAT ADMINISTRATIVE****Neni 25**

25.1. Seancat e Bordit të Zyrës të Rregullatorit për En-

LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË

ergji thirren nga kryesuesi. Seancat mund të zhvillohen kur të paktën katër nga pesë anëtarët janë prezent.

25.2. Kryesuesi i Bordit do të propozojë agjendën për seancat e Bordit dhe do të parashtrojë një agjendë të tillë anëtarëve të paktën pesë (5) ditë pune para secilës seancë.

25.3. Seancat e Bordit normalisht janë të hapura për publikun. Bordi mund të vendosë që disa nga seancat ose pikat e rendit të ditës të jenë të mbyllura. Vendimet e tilla duhet të bazohen në një akt nënligjor që përcakton rrethanat në të cilat seancat mund të jenë të mbyllura.

25.4. Vendimet e Bordit miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve dhe merren gjatë seancave të hapura.

25.5. Çdo anëtar i Bordit ka të drejta dhe detyrime të barabarta të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet. Kjo përfshinë, por nuk kufizohet, të drejtën për të inicuar propozim-vendime dhe pjesëmarrje të barabartë me të gjithë anëtarët e tjerë gjatë diskutimeve.

25.6. Vendimet e marra nga Bordi do të regjistrohen me shkrim në procesverbalet dhe vetëm në rastet kur një vendim i tillë konsiderohet si konfidencial nuk do të jetë i lirë për publikun.

25.7. Bordit do takohet të paktën dhjetë (10) herë në vit.

Neni 26

26.1. Gjatë ushtrimit të kompetencave, detyrave dhe përgjegjësiave Zyra e Rregullatorit për Energji ka kompetenca të nxjerrë vendime dhe akte si në vijim:

- akte të përgjithshme që përcaktojnë mënyrën e rregullimit të disa aspekteve të sektorit të energjisë;
- akte individuale përfshirë vendime për licencime dhe tarifa;
- vendime për zgjidhjen e kontesteve sipas nenit 17 të këtij ligji.

26.2. Vendimet dhe aktet e Zyrës të Rregullatorit për Energji nxirren në mënyrë të hapur, të pavarur dhe jashtë influencës së politikës, industrisë apo ndonjë influence tjetër.

26.3. Aktet dhe vendimet individuale, duhet t'u nënshtrohen procedurave të shqyrtimit administrativ, brenda Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Pas shqyr-

imit në fjalë vendimet mund të apelojnë pranë gjykatës kompetente. Gjatë shqyrtimit të vendimit të tillë, gjykata nuk zëvendëson diskrecionin teknik të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, me diskrecionin e vet.

26.4. Aktet e përgjithshme të Zyrës të Rregullatorit për Energji publikohen në Gazetën Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe në faqen e internetit të Zyrës të Rregullatorit për Energji.

26.5. Aktet individuale dhe vendimet e tjera që kanë të bëjnë me licencat dhe tarifat publikohen në Buletin e Zyrës të Rregullatorit për Energji. Buletini publikohet të paktën një herë në gjashtë muaj dhe postohet në faqen zyrtare të internetit të Zyrës të Rregullatorit për Energji.

Neni 27

27.1. Zyra e Rregullatorit për Energji mund të kërkojë konsultime për çështje madhore në sektorin e energjisë.

27.2. Çdo konsultim i ndërmarrë nga Zyra e Rregullatorit për Energji duhet të:

- lajmërohet në shtypin ditor që qarkullon në tërë Kosovën dhe të postohet në faqen zyrtare të internetit të Zyrës të Rregullatorit për Energji;
- identifikojë çështjet mbi të cilat bëhet konsultimi;
- lejojë të gjitha palët e interesuara të përgjigjen me shkrim brenda 14 ditësh nga publikimi;
- hartojë procedura për ruajtjen e informatave konfidenciale.

27.3. Zyra e Rregullatorit për Energji, sipas gjykimit të vet, si pjesë të konsultimeve mund të:

- publikojë ndonjë projekt-vendim mbi rregullativat, projet-vendim apo projet-akt individual;
- specifikojë se dëgjimi publik do të jetë pjesë e procesit të konsultimeve.

KREU 7

LICENCAT

Neni 28

28.1. Aktivitetet e energjisë kryhen nga ndërmarrjet për energji vetëm në bazë të licencave të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

28.2. Licencimi kërkohet për kryerjen e aktiviteteve energjetike në vijim:

LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË

- a) prodhimi i energjisë elektrike dhe ngrohjes apo bashkëprodhimi i energjisë elektrike dhe ngrohjes;
- b) bartja e energjisë elektrike dhe gazit natyral;
- c) distribuimi i energjisë elektrike, ngrohjes dhe gazit natyral;
- d) deponimi i gazit natyral;
- e) furnizimi me energji elektrike dhe gaz natyral;
- f) tregtimin e energjisë elektrike apo gazit natyral;
- g) bartje përmes kufijve (eksport, import apo tranzit) të energjisë elektrike dhe gazit natyral;
- h) çdo orerator të rrjetit për bartje apo distribuim.
- c) shfrytëzimin e tokës dhe vendvendosjes së stabilimenteve;
- d) shfrytëzimin e tokës publike;
- e) efikasitetin energjetik;
- f) natyrën e burimeve primare të energjisë;
- g) karakteristikat e veçanta të aplikantit siç janë ato teknike, ekonomike dhe mundësitë financiare;
- h) shërbimet publike obligative;
- i) mbrojtjen e konsumatorëve;
- j) promovimin e tregut konkurrues të energjisë.

28.3. Zyra e Rregullatorit për Energji lëshon licenca në bazë të kritereve jodiskriminuese, të hapura dhe transparente.

Neni 29

Nuk kërkohet licencë për:

- a) prodhimin e energjisë elektrike me kapacitet që nuk tejkalon 5 MV;
- b) prodhimin e energjisë për ngrohjen e hapësirave me kapacitet që nuk tejkalon 1 MV termik;
- c) prodhimin e energjisë elektrike apo ngrohjes për nevoja vetiake;
- d) deponimin e gazit natyral që nuk tejkalon 10,000 metra kubik.

Neni 30

30.1. Licenca i lëshohet çdo ndërmarrjeje të energjisë të regjistruar sipas ligjit në Kosovë, që:

- a) posedon mundësitë teknike e financiare, burime materiale e njerëzore dhe strukturë organizative për plotësimin e kërkesave të rregullave për kryerjen e detyrave në bazë të licencës;
- b) të ketë të drejta pronësie ose të drejta ligjore për shfrytëzimin mbi stabilimentet e energjisë me të cilat kryen aktivitetet;
- c) të jap prova se stabilimentet e energjisë me të cilat kryhen aktivitetet sipas licencës i plotësojnë kërkesat e rregullave për siguri dhe mbrojtje të mjedisit;
- d) nuk është deklaruar të jetë i falimentuar dhe nuk është në proces të likuidimit apo bankrotimit;
- e) nuk i është marrë licenca për të njëjtin aktivitet brenda pesë viteve përpara datës së parashtrimit të aplikacionit.

30.2. Kriteret për dhënien e licencës bazohen në:

- a) sigurinë dhe kualitetin e sistemit për furnizim me energji elektrike, ngrohëse dhe gaz natyral;
- b) ruajtjen e mjedisit;

Neni 31

31.1. Licenca mund të jepet për periudhën kohore deri në 30 vjet.

31.2. Kohëzgjatja dhe validiteti i licencës përcaktohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji si vijon:

- a) për aktivitetet e përcaktuara në nenin 28.2 pikat (a) – (d) dhe 28.2 pika (h) rregullohet varësisht nga jetëgjatësia e aseteve të përdorura për kryerjen e aktiviteteve relevante, por që nuk mund të tejkalojë periudhën 30 vjeçare;
- b) për aktivitetet e përcaktuara në nenin 28.2 pika (e), rregullohet që të zgjasë jo më shumë se 10 vjet, varësisht nga gjendja financiare e aplikantit;
- c) për aktivitetet e përcaktuara në nenin 28.2, pika (f), rregullohet që të zgjasë jo më shumë se 2 vjet dhe jo më pak se një vit, varësisht nga gjendja financiare e aplikantit;
- d) për aktivitetet e përcaktuara në nenin 28.2, pika (g), rregullohet që të zgjasë jo më shumë se tre vjet dhe jo më pak se një vit, varësisht nga gjendja financiare e aplikantit.

31.3. Vazhdimi i çdo licence mund të zgjatet për një periudhë kohore që nuk e tejkalon atë të përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni, duke marrë parasysh që i licensuari arrinë të plotësojë të gjitha kushtet dhe detyrimet e licencës dhe të ketë parashtruar një kërkesë me shkrim për zgjatjen e licencës aktuale për një vit, por jo më parë se 18 muaj përpara datës të skadimit.

Neni 32

32.1. Vetëm një licencë do të lëshohet në tërë Kosovën për:

- a) Operatorin e rrjetit për bartjen e energjisë elektrike dhe gazit natyral;

32.2. Vetëm një licencë do të lëshohet për çdo rajon të Kosovës për operatorin e rrjetit distributiv të energjisë elektrike, ngrohje dhe gazit natyral.

LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË

32.3. Ndërmarrja për energji të cilës i jepet licenca për bartjen e energjisë elektrike, nuk mund të marrë licencë për prodhim, distribuim, furnizim e tregtim të energjisë elektrike apo për prodhimin e energjisë ngrohëse.

32.4. Ndërmarrja për energji të cilës i jepet licenca për bartjen e gazit natyral, nuk mund të marrë licencë për një aktivitet tjetër që është subjekt licencimi sipas këtij ligji, me përjashtim të licencës për deponimin e gazit natyral.

32.5. Një ndërmarrje për energji të cilës i është dhënë licenca për operatortin e rrjetit për distribuimin e energjisë elektrike nuk mund të marrë licencë për aktivitete të tjera, që janë subjekt licencimi sipas këtij ligji.

32.6. Një ndërmarrje për energji të cilës i është dhënë licencat për distribuimin e gazit natyral, nuk mund të marrë licencë për aktivitete të tjera që kanë të bëjnë me gazin natyral dhe që janë subjekt i licencimit sipas këtij ligji.

Neni 33

33.1. Procedura për lëshimin e licencës fillon me kërkesën me shkrim të shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës.

33.2. Brenda 90 ditë nga parashtrimi i kërkesës, Zyra e Rregullatorit për Energji duhet të lëshojë licencën, lëshojë licencën me kushtëzime, apo të refuzojë lëshimin e licencës me arsyetim.

33.3. Në rastet e refuzimit të licencës sipas paragrafit (3) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës nuk mund të parashtojë kërkesë të re edhe për 90 ditë të tjera nga dita e sjelljes së vendimit të gjykatës.

Neni 34

Zyra e Rregullatorit për Energji refuzon dhënien e licencës kur:

- a) ndërmarrja për energji nuk i përmbush kërkesat dhe kushtet e këtij ligji apo akteve të tij nënligjore;
- b) një ndërmarrje tjetër për energji është seleksionuar për të kryer aktivitetin për të cilin lëshohet vetëm një licencë; ose
- c) ekziston rrezik serioz për dëmtimin e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, dëmtimit të pronës të palës të tretë dhe dëmtimit të interesave të kon-

sumatorëve duke mos patur qëndrueshmëri në furnizimin me energji elektrike, ngrohëse apo gazit natyral.

Neni 35

Licenca mund të modifikohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji në këto raste:

- a) me kërkesën e të licencuarit; ose
- b) me iniciativë të Zyrës së Rregullatorit për Energji në rrethana të përkufizuara dhe të definuara në procedurat e licencimit, siç është rreziku për sigurimin e furnizimit, siguria kombëtare apo jeta dhe shëndeti i qytetarëve dhe mjedisit.

Neni 36

36.1. Licenca mund të anulohet në këto raste:

- a) me skadimin e afatit;
- b) me kërkesën e të licencuarit, me kusht që detyrimet e të licencuarit t'u kalohen të licencuarëve që do të vijojnë ose me kusht që anulimi i licencës nuk i vë në humbje konsumatorët;
- c) me anulimin e saj nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

36.2. Zyra e rregullatorit për Energji do të tërheqë një licencë në rast se:

- a) i licencuari shkel apo neglizhon konditat madhore apo detyrimet e përcaktuara me licencë dhe nuk e përmirëson një shkelje apo neglizhim të tillë në afatin e caktuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji;
- b) operacionet e të licencuarit janë anuluar si rezultat i deklarimit të falimentimit apo likuidimit;
- c) i licencuari ka prezantuar informacione falso që janë marrë si barrë për dhënien e licencës.

36.3. Një licencë mund të tërhiqet vetëm në rastet kur detyrimet e të licencuarit mund t'i kalohen një të licencuari tjetër ose kur konsumatorët nuk janë në disavantazh nga një tërheqje e tillë e licencës.

36.4. Zyra e Rregullatorit për Energji mund të transferojë një licencë që është tërhequr tek një i licencuar tjetër.

Neni 37

37.1. Bordi i Zyrës të Rregullatorit për Energji përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat për nxjerrjen, ndryshimin apo anulimin e licencës si dhe të drejtat dhe detyrimet që do të përfshihen në licencë.

37.2. Gjatë miratimit të procedurave për njerjen e licencave, Zyra e Rregullatorit do të marrë parasysh të

gjitha politikat, rregullat dhe rregulloret që kanë të bëjnë me prodhimin e energjisë nga burime të ripërtrirëshme.

KREU 8

NDËRTIMI I KAPACITETEVE TË REJA PRODHUESE, RRJETAVE TË GAZIT, LINJAVE DIREKTE ELEKTROENERGJETIKE DHE LINJAVE GYPORE DIREKTE

Neni 38

- 38.1. Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese, rrjetave të reja bartëse dhe distribuive të gazit, linjave të reja direkte elektroenergjetike dhe linjave gypore direkte për tranzitin e gazit natyral bazohet në procedurat e autorizimit ose në procedurat e tenderimit.
- 38.2. Procedurat e autorizimit për ndërtimin e stabilimenteve të reja të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni, përcaktohen në pajtim me kritere objektive, transparente dhe jodiskriminuese. Kriteret për dhënien e autorizimit përfshijnë kriteret e përcaktuara në nenin 30 paragrafi (2) të këtij ligji.
- 38.3. Në rast se refuzohet një aplikacion për autorizim, Zyra e Rregullatorit për Energji duhet ta informojë aplikantin për arsyet e refuzimit. Arsyet duhet të jenë objektive, jodiskriminuese, të bazuara në fakte dhe të qëndrueshme.

Neni 39

- 39.1. Procedurat e tenderimit për ndërtimin e stabilimenteve të reja të përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji, lancohen vetëm në rastin kur procedura e licencimit nuk ka rezultuar me ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme që garantojnë sigurinë e furnizimit apo mbrojtjen e mjedisit.
- 39.2. Procedurat e tenderimit lancohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji e cila është përgjegjëse për organizimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e procedurave për tenderim.
- 39.3. Procedurat e tenderimit përcaktohen në pajtim me kritere objektive, transparente dhe jo-diskriminuese. Kriteret për zgjedhjen e fituesit të tenderit përfshijnë kriteret e përcaktuara në nenin 30 paragrafi (2) të këtij ligji.
- 39.4. Kushtet e procedurave të tenderimit duhet të jenë

në pajtueshmëri me Ligjin për prokurim publik.

Neni 40

- 40.1. Lajmërimi për tender si dhe detajet e procedurave të tenderit postohen në faqen e internetit të Zyrës së Rregullatorit për Energji të paktën gjashtë muaj para datës të mbylljes të tenderit.
- 40.2. Specifikimet e tenderit shpërndahen te të gjithë personat që i kërkojnë ato.
- 40.3. Specifikimet e tenderit përfshijnë përshkrimin e detajuar të kushteve të kontratës, procedurat që duhet të ndjekin tenderuesit dhe një listë gjithpërfshirëse me kriteret për seleksionimin e tenderuesve dhe formën e kontratës.
- 40.4. Tenderues mund të jenë ndërmarrjet e inkorporuara brenda apo jashtë Kosovës, përfshirë korporatat, partnershipet, trustet dhe unikorporatat.

Neni 41

- 41.1. Në ftesën për tender përparësi u jepet furnizuesve të energjisë elektrike me garanca për kohëzgjatje më të madhe dhe që vënë në përdorim stabilimentet e prodhimit ekzistues, me kusht që të mund të përballohet kërkesat në rritje për furnizim.
- 41.2. Me anë të procedurave për parakualifikim të përcaktuara në ftesën për tender, nxirret një listë e shkurtër me tenderuesit e përzgjedhur.

Neni 42

- 42.1. Në rastet kur brenda afatit të caktuar nuk parashtrohet asnjë ose vetëm një aplikacion, afati i fundit për parashtrimin e aplikacioneve mund të zgjatet nga Zyra e Rregullatorit për Energji deri në një periudhë që nuk tejkalon 60 ditë nga data e publikimit të njoftimit për zgjatjen e afatit që është postuar në faqen e internetit.
- 42.2. Zyra e Rregullatorit për Energji anulon tenderin dhe shpallë tender të ri atëherë kur:
- vetëm një tenderues i është përgjigjur ftesës;
 - asnjë nga tenderuesit nuk i përmbush kërkesat e parapara me tender.
- 42.3. Në rastet kur pas përsëritjes të tenderit vetëm një tenderues përgjigjet, Zyra e Rregullatorit për Energji mund të fillojë negociatat me tenderuesin e vetëm dhe ta deklarojë atë fitues në rast se Zyra e Rregullatorit për Energji është e kënaqur me negociatat në fjalë.

LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË

Neni 43

Brenda 3 ditë pune nga marrja e vendimit Zyra e Rregullatorit për Energji i njofton me shkrim të gjithë tenderuesit për vendimin përfundimtar dhe fituesin e tenderit.

Neni 44

44.1. Fituesit të tenderit i jepet edhe leja për ndërtimin e stabilimenteve si dhe licenca për kryerjen e aktiviteteve respektive në fushën e energjisë.

44.2. Leja dhe licenca e dhënë sipas paragrafit (1) të këtij neni përmbajnë kushtet dhe konditat për ndërtimin e stabilimenteve të energjisë dhe datën e fillimit të këtyre aktiviteteve të licencuara.

KREU 9

RREGULLIMI I ÇMIMEVE

Neni 45

45.1. Çmimet në sektorin e energjisë janë të rregulluara ose të pa rregulluara, varësisht nëse ekziston treg që mund të përballojë çmime që vendosen lirshëm ndërmjet blerësve dhe shitësve të energjisë.

45.2. Çmimet e rregulluara në sektorin e energjisë përfshijnë:

- a) Tarifat për shfrytëzimin e sistemeve për bartjeapo për distribuim.
- b) Tarifat për prodhimin e energjisë apo furnizimin me energji, siç cekët se rregullohen, me Ligjin për Energjinë Elektrike apo ligjet e ardhshme mbi Ngrohjen e Çarkut dhe Gazin Natyror.

45.3. Duke mos u kufizuar në paragrafin (2) të këtij neni, çmimet e furnizimit me energji mund të mos jenë të rregulluara në rast se energjia i shitet një klienti të privilegjuar.

Neni 46

46.1. Rregullimi i çmimeve bëhet me metodologjinë e tarifave që përgatitet dhe publikohet nga Bordi i Zyrës të Rregullatorit për Energji.

46.2. Metodologjia e tarifave bazohet në parimet vijuese:

- a) çmimet të jenë të arsyeshme, jodiskriminuese, të bazuara në kritere objektive dhe të vendosura në mënyrë transparente;
- b) çmimet të jenë të bazuara kryesisht në shpenzimet e arsyetuara përfshirë edhe shpenzimet

e pakthyeshme që lidhen me kalimin në treg konkurrues të energjisë përfshirë kthimin adekuat të investimit;

- c) Zyra e Rregullatorit për Energji mund të përcaktojë tarifa në bazë të performancës;
- d) çmimet duhet të marrin në konsideratë mbrojtjen e konsumatorit dhe mjedisit;
- e) çmimet për grupet individuale të klientëve duhet të jenë në përputhshmëri me shpenzimet e furnizimit me energji elektrike, gaz natyral dhe energji ngrohëse të konsumatorëve;
- f) nuk lejohen ndërsuvencionime të kategorive të ndryshme të konsumatorëve;
- g) nuk lejohen ndërsuvencionime të aktiviteteve të ndërmarrjeve të integruara;
- h) shpejtësitë e ndërprerjes (ose ndërprerëse), shpejtësitë balancuese të ngarkesës dhe mekanizmat e tjerë për përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe menaxhimi i nxitjes se kërkesës do të inkurajohet, duke përfshirë shqyrtimin e zhvillimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.
- i) Janë të lejuara tarifat sezonale dhe ato të intervaleve kohore ditore me çmime të rregulluara në bazë të shpenzimeve të shërbimeve gjatë kohës së pikut dhe kohës jashtë pikut;
- j) Tarifat për kyçje mund të përfshijnë kyçjen në rrjet ose rritjen substanciale të ngarkesës.

Neni 47

47.1. Zyra e Rregullatorit për Energji shqyrton, miraton apo rregullon tarifa bazuar në propozimet e ndërmarrjeve për energji si dhe në metodologjinë e tarifave.

47.2. Gjatë miratimit të tarifave fikse, Zyra e Rregullatorit për Energji siguron të licencuarit që ata të mund të rikompenzojnë të gjitha shpenzimet e arsyeshme, përfshirë:

- a) shpenzimet e deponimit dhe rezervave të lëndëve djegëse, pagat dhe mëditjet;
- b) shpenzimet e menaxhimit, veprimit, operimit, mirëmbajtjes, zëvendësimit dhe ndërtimit të stabilimenteve për energji, shpenzimet e dekomisionimit të stabilimenteve për energji dhe stabilimenteve për deponimin e rezervave të lëndëve djegëse;
- c) shpenzimet e mirëmbajtjes të rezervave dhe kapaciteteve rregulluese që janë të nevojshme për të siguruar furnizim të qëndrueshëm për konsumatorët;
- d) shpenzimet e zvogëlimit e kapitalit;
- e) shpenzimet e shërbimeve publike të detyruara dhe obligimeve tjera që i imponohen të licencuarit.

47.3. Zyra e Rregullatorit për Energji mund ta liroj një ndërmarrje të energjise nga tarifat e rregulluara, në rast se gjen se ndërmarrja vepron në tregun konkurrues.

LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË

47.4. Procedurat për shqyrtimin, miratimin dhe rregullimin e çmimeve dhe taksave do të themelohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

Neni 48

48.1. Ndërrmarrjet për energji do të kenë të drejtën të aplikojnë për kompenzim të shpenzimeve të parikthyeshme dhe të humbura që dalin nga investimet dhe transaksionet e bëra para shpalljes të këtij ligji.

48.2. Ndërrmarrjet për energji do të parashtrojnë një aplikacion tek Zyra e Rregullatorit për Energji ku do të specifikohen shpenzimet e tilla, së bashku me dokumentacionin përcjellës për shkaqet e shpenzimeve të tilla.

48.3. Zyra e Rregullatorit për Energji do të vendosë shumën maksimale që do të jetë e pranueshme për shpenzimet e humbura të parikthyeshme për secilën nga ndërrmarrjet dhe shumën e kompenzimit për secilën ndërrmarrje për një periudhë të caktuar kohore, duke marrë parasysh detyrën e ndërrmarrjes për tu deklaruar rreth shpenzimeve të tilla.

48.4. Kompenzimi për shpenzimet e humbura të parikthyeshme, do të jetë detyrim për të gjithë konsumatorët pa diskriminim në mënyrë të hapur dhe transparente.

KREU 10**NDARJA DHE TRANSPARENCA E NDËRRMARRJEVE TË ENERGJISË****Neni 49**

49.1. Ndërrmarrjet për energji që veprojnë në bartjen e energjisë elektrike apo rrjetet e distribuimit do të jenë të pavarura nga aspekti juridik, organizativ, dhe vendim-marrës në pajtim me Ligjin për Energji Elektrike.

49.2. Ndërrmarrjet për energji që kryejnë bartjen e gazit natyral apo rrjeteve distributive do të jenë të pavarura nga aspekti juridik, organizativ dhe vendim-marrës në pajtim me cilindo ligji për gazin natyral.

49.3. Të gjitha ndërrmarrjet për energji në llogaritjet e tyre interne mbajnë llogari të ndara për prodhim, bartje, distribuim dhe furnizim, sikur të gjitha këto aktivitete të ishin kryer nga ndërrmarrje të ndryshme, me qëllim pengimit të: diskriminimit, ndërsuacionimit dhe shkatërrimit të konkurrencës.

49.4. Të gjitha ndërrmarrjet për energji duhet të mbajnë

llogari të ndara për aktivitetet e tyre që nuk kanë të bëjnë me aktivitetet për energji.

49.5. Furnizuesit me energji elektrike do të kenë llogari të ndara për furnizim të konsumatorëve të privilegjuar dhe atyre tarifor ashtu sikur furnizimi të bëhej nga dy ndërrmarrje të ndryshme.

49.6. Zyra e Rregullatorit për Energji monitoron ndarjen efektive juridike dhe të llogarive për ndërrmarrjet e integruara të energjisë në pajtim me këtë ligj, Ligji për energjinë elektrike, në pajtim me cilindo ligj për gazin natyral dhe cilëndo e rregullore të UNMIK-ut apo udhërfyës për këtë çështje.

Neni 50

50.1. Zyra e Rregullatorit për Energji e ka të drejtën e qasjes në llogaritë e ndërrmarrjeve për energji, vetëm atëherë kur të jetë e nevojshme për përmbushjen e funksioneve të saj.

50.2. Zyra e Rregullatorit për Energji nuk lejohet të zbulojë informatat konfidenciale të marra sipas paragrafit (1) të këtij neni, përveç për personat kompetentë dhe organet tjera publike në bazë të procedurave sipas këtij ligji.

KREU 11**SHËRBIMET PUBLIKE TË DETYRUESHME****Neni 51**

51.1. Aktivitetet e energjisë kryhen në pajtim me rregullat që rregullojnë ato aktivitete si shërbime publike apo shërbime të bazuara në treg.

51.2. Si shërbime publike kryhen aktivitetet si në vijim:

- a) bartja e energjisë elektrike dhe e gazit natyral;
- b) distribuimi i energjisë ngrohëse, elektrike dhe gazit natyral;
- c) furnizimi publik me energji elektrike, ngrohëse, apo gazit natyral .

51.3. Zyra e Rregullatorit për Energji detyron të kryejnë shërbime publike të detyrueshme ndërrmarrjet e energjisë që kryejnë shërbime publike. Detyrimet e tilla duhet të definohen qartë, të mos jenë diskriminuese, të jenë të verifikueshme si dhe të diktohen nga interesi i përgjithshëm ekonomik. Detyrimet do të ndërrlidhen me sigurinë, besueshmërinë, kualitetin dhe çmimin e furnizimit si dhe mbrojtjen e mjedisit.

LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË

51.4. Ndërmarrjet e energjisë që ofrojnë shërbime publike duhet të organizohen në mënyrë që të mund të marrin informacione nga konsumatorët dhe klientët potencialë për çështje të ndërprerjes apo për probleme tjera që mund të pengojnë konsumatorët në qasjen në furnizimin me energji.

KREU 12

KUSHTET PËR FURNIZIM ME ENERGJI

Neni 52

52.1. Konsumatorët e fundit të energjisë, aty ku është e mundur teknikisht dhe ekonomikisht, kanë të drejtë të furnizohen nga rrjetet që ofrojnë shërbime publike në bazë të Konditave dhe Kushteve të Përgjithshme për Furnizim me Energji.

52.2. Konsumatorët e fundit të energjisë kanë të drejtë të lidhin paisjet apo stabilimentet e tyre energjetike(elektrike, ngrohëse apo gazit) në rrjetat e subjekteve energjetike që ofrojnë shërbime publike kur kjo është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur në bazë të Konditave dhe Kushteve të Përgjithshme për Furnizim me Energji.

52.3. Konsumatorët e fundit kanë të drejtë të hyjnë në marrdhënie transparente kontraktuese me furnizues të energjisë në bazë të Konditave dhe Kushteve të Përgjithshme për Furnizim me Energji.

52.4. Zyra e Rregullatorit për Energji përcakton Konditat dhe Kushtet e Përgjithshme për Furnizim, që përfshijnë:

- detyrimin për t'ua mundësuar konsumatorëve kyçjen në rrjet dhe furnizimin me energji;
- kriteret për kyçje dhe furnizim të konsumatorëve me energji;
- dhënia e miratimeve dhe kushtet në bazë të të cilave mundësohet kyçja;
- kushtet për dërgimin e energjisë elektrike, detyrimet dhe ndërprerjet gjatë dërgesës të energjisë elektrike;
- mjetet matëse dhe mënyrat matëse për dërgesën dhe konsumin e energjisë dhe kapacitetit të angazhuar.

KREU 13

BANKROTIMI I TË LICENCUARVE

Neni 53

53.1. Në rastin e likuidimit apo bankrotimit të një të licencuari, Zyra e Rregullatorit për Energji ka kompe-

tencë ta anulojë licencën dhe t'ia transferojë detyrimet e këtij të licencuari tek një i licencuar tjetër i cili pajtohet të marrë përsipër detyrimet apo ta detyrojë të kryejë këto obligime sipas dispozitës të bartjes së detyrimeve në burimin e fundit.

53.2. Në rast se asnjë nga të licencuarit ekzistues nuk është në gjendje apo nuk do që të marrë përsipër detyrimet e të licencuarit të bankrotuar apo të likuiduar, Zyra e Rregullatorit për Energji ka kompetenca të transferojë asetet e tij tek një i licencuar i ri me vlerën e tyre në treg.

53.3. Zyra e Rregullatorit për Energji mund të përfshijë në çdo licencë detyrimet e burimit të fundit dhe kjo dispozitë kërkon nga i licencuari të marrë përsipër detyrimet e furnizimit të një të licencuari të bankrotuar apo të likuiduar për një periudhë kohore fikse dhe në kushtet e konditave e njejtë për furnizim.

53.4. Zyra e Rregullatorit për Energji ka kompetenca të emërojë një furnizues të burimit të fundit në rast të likuidimit apo bankrotimit të një të licencuari me anë të imponimit, në licencë, një detyrim për të furnizuar me energji çdo klient që ka humbur furnizimin për shkak të bankrotimit apo likuidimit të një furnizuesi.

KREU 14

MBIKËQYRJET

Neni 54

Zyra e Rregullatorit për Energji ushtron mbikëqyrje mbi:

- pajtueshmërinë me konditat e licencës;
- zbatimin e tarifave dhe çmimeve;
- zbatimin e akteve, vendimeve dhe udhëzimeve të lëshuara për të licencuarin.

Neni 55

Gjatë ushtrimit të detyrave mbikëqyrëse, Zyra e Rregullatorit për Energji:

- kryen inspektime nëpërmjet personave të autorizuar për këtë;
- njoftojn autoritetet publike apo organet e pavarura që të marrin masa sipas kompetencave të tyre;
- anulon, ndryshon apo tërheqë licencën e lëshuar;
- imponon masa të domdosdoshme administrative dhe dënime administrative, të parapara me këtë ligji apo ndonjë ligj tjetër që rregullon sektorin e energjisë në Kosovë.

Neni 56

56.1. Zyra e Rregullatorit për Energji ka fuqi dhe kompetenca që pas pranimit të një ankese apo edhe me vetiniciativë, të hulumtojë nëse një i licencuar qoftë vetë ose nëpërmjet punëtorëve të tij apo përfaqësuesve tjerë ka bërë shkelje si në vijim:

- a) cilatdo nga kushtet edhe konditat e licencës;
- b) cilindo akt, vendim apo udhëzim të nxjerrë nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

56.2. Në rast se pas kryerjes së hetimeve sipas paragrafit (1), Zyra e Rregullatorit për Energji gjen një shkelje të mirëfilltë të cilësdo dispozitë, ka kompetenca që të:

- a) urdhërojë të licencuarin që të mos e përsëritë veprime kundërligjore, apo në rast se veprimi është stopuar, të lëshojë një vendim për marrjen e masave;
- b) imponojë dënime administrative varësisht nga serioziteti i shkeljes.

56.3. Zyra e Rregullatorit për Energji nxjerrë arsytetime të denja për vendimet rregullative në lidhje me ushtrimin e cilës do kompetencë sipas këtij neni.

KREU 15**DISPOZITAT NDËSHKIMORE****Neni 57**

57.1. I shqiptohet dënim çdo personi që:

- a) punëson persona që nuk ka kualifikimet e kërkuara nga ky ligj;
- b) nuk arrin të përmbushë detyrat e e tij/të saja sipas këtij ligji;
- c) nuk jep informata të kërkuara sipas nenit 13 të këtij ligji;
- d) hap informata konfidenciale në mënyrë të papranueshme;
- e) nuk jep ndihmën e kërkuar sipas nenit 14 të këtij ligji;
- f) nuk vepron në pajtim me masat e imponuara sipas nenit 16 të këtij ligji për të parandaluar abuzimin me pozitën dominante;
- g) merret me aktivitete energjetike pa patur licencë e për të cilat nevojitet licenca;
- h) nuk arrinë të përmbushë kushtet e licencës;
- i) ndërton stabilimente sipas Kreut 8 pa marrë lejen;
- j) ndërron çmimet apo tarifatat që janë subjekt rregullimi, pa miratimin e Zyrës të Rregullatorit

për Energji;

- k) mban llogaritë në mënyrë që nuk është në pajtim me kërkesat e nenit 49 të këtij ligji;
- l) refuzon të lejojë Zyrën e Rregullatorit për Energji të ketë qasje në llogaritë në pajtim me nenin 50;
- m) refuzon të hyjë në kontratë për furnizim me energji elektrike apo të lejojë qasje në rrjetë pa arsyetim ;
- n) largon, dëmton apo pengon efektivitetin e mjeteve matëse komerciale;
- o) lidhet me rrjetën pa respektuar kushtet relevante;
- p) vepron në kundërshtim me këtë ligj, me Ligjin për Energjinë Elektrike, me Ligjin për Energjinë, me aktet nënligjore apo rregulloreve teknike përkatëse, standardeve, ose kodeve.

57.2. Kur kemi të bëjmë me ndërmarrje energjetike, dënimi i cekur në paragrafin (1) të këtij neni nuk mund të tejkalojë shumën e 15 % të të ardhurave që ndërmarrja energjike ka akumuluar gjatë vitit paraprak fiskal.

57.3. Në rastet kur dënimi i cekur në paragrafin (1) të këtij neni i shqiptohet një individ, nuk mund të tejkalojë 300% e rrogës mujore të individit.

57.4. Në rastet e shkeljes të përsëritur të ligjit, dënimi i shqiptuar mund të jetë tre herë më i madh se ai i cekur në paragrafin 2 apo 3 të këtij neni.

57.5. Gjatë shqiptimit të dënimit sipas këtij kreu, Zyra e Rregullatorit për Energji duhet të merr parasysh shkallën e dëmit që i është bërë shoqërisë, sjellja paraprake e personit dhe gjendja financiare e personit.

57.6. Gjatë shqiptimit të një dënimi sipas këtij kreu, Zyra e Rregullatorit për Energji duhet të njoftojë personat për shkeljet e bëra dhe t'iu japë mundësi dhe kohë që të përgjigjen me shkrim, brenda 14 ditësh nga njoftimi.

57.7. Në rast mos pagesës të dënimit të shqiptuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Zyra e Rregullatorit për Energji inicon procesin në gjykatën kompetente për realizimin e dënimit si borxh civil.

57.8. Të gjitha dënimet e mbledhura sipas këtij kreu do të depozitohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

LIGJI PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË

KREU 16

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 58

- 58.1. Jo më vonë se gjashtëdhjetë 60 ditë, pas emërimit të anëtarëve të parë të Bordit, Bordi do të miratojë, Kodin Profesional të Punës për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë.
- 58.2. Jo më vonë se gjashtëdhjetë 60 ditë, pas emërimit të anëtarëve të parë të Bordit, Bordi do të miratojë, Statutin e Zyrës së Rregullatorit për Energji.
- 58.3. Jo më vonë se nëntëdhjetë 90 ditë pas emërimit të anëtarëve të parë të Bordit, Bordi do të miratojë procedurat për zgjidhjen e kontesteve për të adresuar ankesat e ngritura nga palët.
- 58.4. Jo më vonë se nëntëdhjetë 90 ditë, pas emërimit të anëtarëve të parë të Bordit, Bordi do të hartojë një listë taksash që duhet paguar për procesim të aplikacioneve, regjistrim, licencim, si dhe për lëshimin e certifikatave.
- 58.5. Jo më vonë se katër 4 muaj, pas emërimit të anëtarëve të parë të Bordit, Bordi do të hartojë dhe miratojë një akt nënligjor, mbi licencimin.
- 58.6. Jo më vonë se katër 4 muaj, pas emërimit të anëtarëve të parë të Bordit, Bordi do të përgatitë dhe miratojë një akt nënligjor, mbi çmimet.
- 58.7. Jo më vonë se katër 4 muaj, pas emërimit të anëtarëve të parë të Bordit, Bordi do të përgatitë dhe miratojë Kushtet dhe Konditat e Përgjithshme për Furnizim me Energji. Rregullat mbi çkyçjet, megjithatë, do të lëshohen jo më vonë se katër 4 muaj, pas emërimit të anëtarëve të parë të Bordit.
- 58.8. Jo më vonë se dymbëdhjetë 12 muaj, pas emërimit të anëtarëve të parë të Bordit, PSSP-ja, në këshillime me institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse, do të shqyrtojë strukturën e tregut dhe të vlerësojë shkallën e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike. Bazuar në rezultatet e shqyrtimeve të tilla, PSSP-ja mund të shkurtojë apo të zgjasë për një vit mandatin e anëtarëve të parë të Bordit, të emëruar nga ai, sipas nenit 5.
- 58.9. Në rast, se PSSP-ja vendosë, sipas paragrafit 58.9, të shkurtojë mandatin e parë të të gjithë anëtarëve të Bordit të emëruar nga ai, në pajtim me nenin 5.2,

Kuvendi menjëherë do të riemërojë dy anëtarët e Bordit që janë emëruar sipas nenit 5.2 (b), në pajtim me nenin 5.6.

- 58.10. PSSP-ja do të ketë autoritetin të shqyrtojë performansat e anëtarëve të parë të Bordit, të emëruar nga ai sipas nenit 5, dhe mund të shkarkojë ndonjë anëtar të Bordit nëse ai apo ajo dështon të kryej në mënyrë të duhur detyrat e veta. Në rastin e tillë, PSSP-ja emëron një anëtar të ri për të shërbyer gjatë kohës së mbetur të mandatit të anëtarit të shkarkuar, sipas nenit 58.8.

Neni 59

Ky ligji hyn në fuqi mbas miratimit të tij nga Kuvendi i Kosovës dhe në ditën e shpalljes nga PSSP-ja.

30.06.2004

UNMIK/REG/2004/20

LIGJI NR. 2004 / 8

PËR ENERGJINË

Kuvendi i Kosovës,

Duke patur parasysh Misionin e Përkohshëm të Administratës të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) Rregullorja Nr. 1999/1 të 25 korrikut 1999, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë;

Duke u mbështetur në autorizimet që u janë dhënë Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2001/9 të datës 15 maj 2001," mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme," veçanërisht Neni 5.1 (ç), dhe 9.1.26 (a) dhe kështu me radhë,

Në bazë të Nenit 8.1 (r) të Kornizës Kushtetuese mbi kompetencat e rezervuara të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm;

Duke i njohur nevojat për furnizim të qëndrueshëm dhe kualitativ me energji dhe shfrytëzimin efikas të saj, duke përfshirë edhe burimet e ripërtëritshme të energjisë, dhe nevojat për zhvillimin e një tregu konkurrent të energjisë;

Vendosi të miratojë si vijon:

LIGJI PËR ENERGJINË

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj përcakton parimet e përgjithshme të strategjisë energjetike dhe programit energjetik në Kosovë; rregullat për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe efikas të energjisë si dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë; vendosjen e rregullave tregut të energjisë; masat tjera të domosdoshme për sigurimin e funksionimit të duhur të aktiviteve në sektorin e energjisë.

Neni 2

Qëllimet e këtij ligji janë:

- të garantojë furnizim të sigurtë, të qëndrueshëm dhe kualitativ me energji;
- të promovojë një menaxhim racional dhe të koordinuar të burimeve energjetike;

- të inkurajojë ndjenjen e respektit për mbrojtjen e ambientit gjatë zhvillimit të aktiviteve energjetike;
- të promovojë kushtet e zhvillimit të një tregu modern energjetik dhe të sigurojë konkurrencën në tregun e energjisë sipas parimeve të përgjithshme që garantojnë mosdiskriminim, transparencën, barazinë dhe respektin për mbrojtjen e klientit;
- të promovojë investimet në sektorin e energjisë;
- ta përparojë kohezionin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës;
- të avancojë integrimin e Kosovës në fushën ekonomike evropiane dhe përfshirjen e tregut të rrymës elektrike të Kosovës në tregun e rrymës elektrike të Europës Juglindore;
- të promovojë përafrimin gradual të legjislacionit dhe rregullativës së Kosovës mbi energjinë me legjislacionin e Bashkimit Europian mbi energjinë si dhe pjesëmarrjen e Kosovës në marrëveshjet dhe konventat relevante ndërkombëtare në të cilat Kosova mund të merr pjesë dhe/ose të antarësohet.

Neni 3

3.1. Terminologjija e përdorur në këtë ligj do të ketë domethëniet në vijim:

„**bashkë-prodhimi**“ do të thotë proces teknologjik i cili bën prodhimin simultan të energjisë termike dhe elektrike elektrike;

„**konsumator**“ do të thotë konsumatori për blerje me shumicë ose konsumatori i fundit i energjisë;

„**kodet**“ nënkuptojnë rregullat teknike të publikuara të vendosura në një dizajn minimal teknik, kërkesat operative dhe standardet për elektroenergjetikë duke përfshirë kodin e rretit, kodin e distribucionit, kodin e standardit elektroenergjetik, kodin për mbrojtjen e konsumatorit, kodin e paisjes elektrike, kodin matës dhe kodin tregtar;

„**distribuimi**“ do të thotë transporti i energjisë elektrike, ngrohjes ose gazit natyror me anë të linjave të tensionit të lartë, të mesëm ose tubacioneve me presion të mesëm ose të ulët më qëllim të dërgimit te konsumatorët, por duke mos përfshirë furnizimin;

„**energji elektrike**“ nënkupton formën e energjisë e cila transportohet përmes përçuesve metalik;

„**konsumatori i privilegjuar**“ do të thotë çfarëdo personi fizik ose juridik i cili është i lirë për të blerë energji nga furnizuesi sipas zgjedhjes së tij/saj;

„**energji**“ do të thotë çdo formë e prodhuar ose e fituar

LIGJI PËR ENERGINË

e energjisë (energji elektrike, ngrohja ose gaz natyror) me qëllim të furnizimit ose shitjes;

„**efikasiteti energjetik**“ nënkupton qasjen e integruar që ka për qëllim të ndikojë në sasinë dhe kohën e konsumimit të energjisë elektrike në mënyrë që të reduktohet konsumi i energjisë primare dhe ngarkesa maksimale (piku) duke i dhënë përparësi investimeve në masat për efikasitetin e energjisë, ose masave tjera, sikur që janë kontratat e furnizimit me ndërprerje mbi investimet për ngritjen e kapacitetit prodhues, nëse ky është opcioni më efektiv dhe ekonomik, duke marrë parasysh ndikimin pozitiv në ambient që ka konsumimi i redukuar i energjisë si dhe aspektet e koston të sigurimit të furnizimit dhe distribuimit lidhur me të;

„**ndërmarrja e energjisë**“ nënkupton ndërmarrjen e energjisë e cila ushtron një ose më shumë nga aktivitetet energjetike në vijim: prodhimin, transformimin, bartjen, distribuimin, furnizimin, tregtimin ose deponimin e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose gazit natyror në bazë të një licence të lëshuar sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë apo pa licencë nëse licenca në fjalë nuk kërkohet;

„**tregu energjetik**“ do të thotë aktivitetet bashkëvepruese afariste dhe teknike të ndërmarrjeve energjetike dhe konsumatorëve të përfshirë në prodhimin, tregtimin dhe furnizimin me energji që e përcaktojnë çmimin e energjisë;

„**Zyra e Rregullatorit për Energji**“ nënkupton rregullatorin e pavarur të aktiviteteve energjetike, që mban kompetencat e përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, këtë ligj dhe ligjet tjera që rregullojnë ushtrimin e aktiviteteve energjetike;

„**sektori energjetik**“ nënkupton aktivitetet të cilat përfshijnë prodhimin, distribuimin, bartjen, shëndrrimin/transformimin, tregtimin, ruajtjen dhe furnizimin me energji elektrike, ngrohje dhe gaz;

„**konsumatori përfundimtar**“ nënkupton konsumatorin i cili blenë energjinë elektrike për nevoja të veta;

„**kushtet e përgjithshme për furnizim me energji**“ nënkupton detyrimet teknike dhe ekonomike të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji për furnizimin e konsumatorëve me energji;

„**prodhimi**“ nënkupton prodhimin e energjisë elektrike, ngrohjes ose ndonjë forme tjetër të energjisë;

„**ngrohja**“ nënkupton çdo formë të energjisë termike e cila është e transformuar nga uji, avulli ose nga ndonjë formë tjetër;

„**caqet indikative**“ nënkupton sasinë e furnizimit të energjisë të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë ose bashkë-prodhimi;

„**licenca**“ nënkupton autorizimin e lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji që i mundëson bartësit të licencës të ushtrorë aktivitete në sektorin e energjisë për të cilat nevojitet licenca në përputhje me dispozitat përkatëse;

„**planifikimi afatgjatë**“ nënkupton planifikimin e nevojave për investim në kapacitetet e prodhimit, bartjes ose distribuimit në baza afatgjatë me qëllim të plotësimit të nevojave për energji elektrike, ngrohje ose gaz natyror në Kosovë dhe sigurimit të furnizimit për konsumatorë;

„**paisjet matëse**“ do të thotë instrumentet e regjistruara në regjistrin për pasijet e çertifikuara të matjes në Kosovë, që përdoren gjatë procesit të furnizimit me energji;

„**Zyra ose subjekti i Qeverisë përgjegjëse për energji**“ do të thotë instanca e Qeverisë që ka përgjegjësi të plotë apo të pjesërishtme për sektorin e energjisë;

„**gazi natyror**“ nënkupton lëndën djegëse të gaztë e cila liron energji gjatë djegies ose ndonjë procesi tjetër kimik ose fizik dhe që mund të ruhet në depotë për akumulim;

„**sistemi**“ nënkupton një sistem me paisje të ndërlidhura me qëllim të bartjes dhe distribuimit të energjisë elektrike ose energjisë për ngrohje ose gazit natyror për klientët;

„**prodhuesi**“ nënkupton personin fizik apo juridik që prodhon energji elektrike ose ngrohje;

„**burimet e ripërtëritshme të energjisë**“ nënkuptojnë burimet e ripërtëritshme pa fosile të energjisë (era, energji solare, gjeotermale, valore, ujore, biologjike, gazet tokësore, uzinat për përpunimin e gazeve dhe biogazet);

„**sigurimi i furnizimit**“ nënkupton sigurinë teknike si dhe sigurimin e një sasive adekuate të energjisë për përmbushjen e nevojave të popullit të Kosovës;

„**furnizimi**“ nënkupton shitjen, përfshirë edhe rishitjen, e energjisë në formë të energjisë elektrike, ngrohjes ose të gazit natyror deri te konsumatorët;

„**tarifa**“ nënkupton çmimin e energjisë të vendosur ose miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji;

„**metodologjia tarifore**“ nënkupton parimet e përgjithshme të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji të cilat zbatohen gjatë vendosjes së çmimeve të rregulluara;

„**tregtia**“ nënkupton transaksionet e shitjes dhe blerjes ku interesi për energji transferohet pa patur nevojë të mirret pronësia e energjisë;

„**transformimi**“ nënkupton procesin e transformimit të lëndës djegëse dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë në energji;

„**tranziti**“ nënkupton transportimin e energjisë përtej kufirit nacional pa prodhuar dhe konsumuar në atë vend;

„**bartja**“ nënkupton transportimin e energjisë elektrike, ngrohjes ose gazit natyror në sistemin e tensionit të lartë dhe super të lartë, në sisteme ose tubacione me shtypje të lartë, me qëllim të dërgimit të konsumatorët e fundit ose distributorët, por duke mos përfshirë furnizimin;

„**konsumatori për shitje me shumicë**“ nënkupton çfarëdo personi fizik ose juridik i cili blenë energji me qëllim të rishitjes brenda ose jashtë sistemit ku ai është i themeluar;

„**operator i tregut**“ nënkupton personin juridik që është përgjegjës për organizimin dhe udhëheqjen e tregtisë, në marrëveshjet për elektrikë dhe pagesa, në mes të prodhuesve, furnizuesve dhe konsumatorëve. Operatori i Tregut, vë para kohe në baraspeshë furnizimin dhe kërkesën financiare.

„**operatori i sistemit distributiv**“ nënkupton personin fizik apo juridik, përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes, dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit distributiv, në një zonë të caktuar dhe ku është e mundshme, ndërlidhjen e këtij sistemi me sisteme të tjera dhe për sigurimin e mundësive afatgjata të sistemit, që të mbulojë kërkesat e arsyeshme për distribuimin e energjisë elektrike apo gazit natyror.

„**operatori i sistemit bartës**“ nënkupton personin fizik apo juridik, përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit bartës në një zonë të caktuar dhe, ku është e mundshme, ndërlidhjen e këtij sistemi me sisteme të tjera, dhe për sigurimin e mundësive afatgjate të sistemit, që të mbulojë kërkesat e arsyeshme për distribuimin e energjisë elektrike apo gazit natyror.

3.2. Termat e tjerë të përdorur në këtë ligj, do të kenë domethënie e cekur në Ligjin për Energjinë Elektrike apo në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

KREU 2

STRATEGJIA, PROGRAMET DHE

BALANCIMI

Neni 4

4.1. Dokumenti themelor që përcakton politikat energjetike dhe të planifikimit për zhvillimin e sektorit energjetik në Kosovë është Strategjia e Energjisë.

4.2. Strategjia e Energjisë do të:

- a) sigurojë furnizim të sigurtë, të qëndrueshëm dhe kualitativ me energji;
- b) promovojë balancin afatgjatë në zhvillimin e sektorit të energjisë duke marrë parasysh paqëndrueshmëritë (lëkundjet, fluktuacionin) në konsumin e energjisë;
- c) mundësojë shfrytëzimin maksimal të burimeve të energjisë në disponim në Kosovë;
- d) promovojë shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
- e) sigurojë përdorimin efikas të energjisë;
- f) mbrojë konsumatorët e energjisë;
- g) mbrojë mjedisin jetësor gjatë kryerjes së aktiviteteve të energjisë;
- h) promovojë investimet në sektorin e energjisë;
- i) promovojë konkurrencën në sektorin e energjisë bazuar në parimet e jo diskriminimit dhe transparencës;
- j) lehtësojë lidhjen e sistemit të energjisë së Kosovës ose pjesëve të saj me sistemin e energjisë të Europës ose me sistemet e vendeve të tjera.

4.3. Pjesë përbërëse e Strategjisë së Energjisë janë obligimet që ka Kosova, veçanërisht lidhur me investimet në sektorin e energjisë, tranzitin dhe kyçjen në sistemet ndërkombëtare dhe rajonale.

4.4. Strategjia për Energjinë, mbulon një periudhë për dhjetë (10) vjet. Strategjia për Energjinë, propozohet nga Zyra ose subjekti i Qeverisë përgjegjës për energjinë pas konsultimeve me Zyren e Rregullatorit për Energji, operatorët e sistemit, dhe me organet rajonale mbikëqyrëse, të aprovuar nga kabineti i Ministrave dhe miratuar nga Kuvendi.

Neni 5

5.1. Bazuar në Strategjinë e Energjisë, Zyra ose subjekti i Qeverisë përgjegjës për energjinë do të përgatisë dhe miratojë Programin për Zbatimin e Strategjisë për një periudhë minimale tri vjeçare.

5.2. Programi për Zbatimin e Strategjisë do të përcaktojë aktivitetet që duhen zbatuar duke përfshirë edhe programet për:

- a) përmbushjen e synimeve afatgjate zhvillimore;

LIGJI PËR ENERGJINË

- b) sigurimin e udhëzimeve për zhvillimin e sektorit energjetik;
 - c) sigurimin e stimulimeve për të inkurajuar shfrytëzimin efikas të energjisë;
 - d) sigurimin e stimulimeve për investime në burimet e ripërtitshme të energjisë dhe pajisjeve për eksploatimin e tyre;
 - e) konstatimin e investimeve të nevojshme në infrastrukturën publike si dhe masën e investimeve të pritura nga investitorët privatë në aktivitetet e ndërlidhura energjetike.
- 5.3. Programi për Zbatimin e Strategjisë do të caktojë njësitë përgjegjëse për ushtrimin e aktiviteteve të planifikuara si dhe orarin për realizimin e politikave dhe programeve të Strategjisë, bashkëpunimin e nevojshëm me qeveritë dhe institucionet lokale në lëminë e planifikimit të sektorit të energjisë si dhe bashkëpunimin e nevojshëm me ndërmarrjet e energjisë dhe organizatat ndërkombëtare.
- 5.4. Në mënyrë që të sigurohet financimi i Programit për Zbatimin e Strategjisë, do të vendoset një fond i veçantë sipas një ligji të veçantë. Ai ligj do të përcaktojë burimet e financimit, organet menaxhuese si dhe kompetencat e përgjegjësitë e tyre përkatëse dhe çështjet e tjera në lidhje me vepritarinë e fondit.
- 5.5. Pas skadimit të Programit për Zbatimin e Strategjisë, Zyra ose subjekti i Qeverisë përgjegjës për energjinë do t'i raportojë Kuvendit mbi Programin për zbatimin e Strategjisë dhe do t'i propozojë ndryshimet e nevojshme për Strategjinë e Energjisë.
- 5.6. Zyra ose subjekti i Qeverisë përgjegjës për energjinë paraqet një raport vjetor, para Kuvendit, mbi aktivitetet e tyre për Programin e Zbatimit të Strategjisë, së bashku me një raport financiar të Fondit.

Neni 6

6.1. Zyra ose subjekti i Qeverisë përgjegjës për energjinë do të miratojë bilanci afatgjatë dhe vjetor të energjisë që do të parashikojnë kërkesën për energji, burimet (llojet) e energjisë dhe masat që do zbatohen për përmbushjen e kërkesës. Bilancet afatgjatë dhe vjetor të energjisë elektrike do t'i propozohen Ministrisë përgjegjëse për energji nga operatori i sistemit të bartjes pas konsultimeve me Zyren e Rregullatorit për Energji.

6.2. Balanci afatgjatë i energjisë miratohet për një periudhë 10 vjeçare. Azhurnimet e balancit afatgjatë të energjisë miratohen çdo dy vjet.

6.3. Komponentet mandatore të dokumentit të Balancit afatgjatë të energjisë janë:

- a) parashikimi i kërkesave për llojet e veçanta të energjisë;
- b) parashikimi i furnizimit për llojet e veçanta të energjisë;
- c) mënyra për përmbushjen e kërkesave për burimet e veçanta të energjisë duke përfshirë energjinë primare (burimet e ripërtitshme dhe jo të ripërtitshme) dhe energjinë përfundimtare;
- d) Parashikimi i lirit të substancave të dëmshme nga burimet e energjisë si dhe ndikimi që ka në mjedinë prodhimi dhe shfrytëzimi i energjisë;
- e) një listë të niveleve të nevojshme të depozimit dhe kapacitetit rezervë të nevojshëm për sigurimin e shkallës së planifikuar të qëndrueshmërisë (stabilitetit) të furnizimit.

6.4. Balanci vjetor i energjisë do të miratohet jo më vonë se 15 dhjetor të vitit në vijim, për vitin e ardhshëm.

6.5. Pjesët mandatore të Balancit vjetor të energjisë janë:

- a) konsumi vjetor i lëndëve të para të energjisë, nivelet e rezervave dhe kapacitetet rezervë;
- b) niveli vjetor i kapacitetit rezervë (kufiri i rezervës) i centraleve të energjisë dhe pajisjeve;
- c) nivelet e duhura të rezervave operative çdo vit dhe kriteret lidhur me efikasitetin e energjisë për çdo vit.

6.6. Zyra ose subjekti i Qeverisë përgjegjëse për energjinë nxjerrë Rregullat e Bilancit të Energjisë, që përshkruajnë mënyrën dhe përmbajtjen e paraqitjes së të dhënave nga organet qeveritare, qeveritë lokale, ndërmarrjet e energjisë, dhe operatorët e tregut tek Zyra ose subjekti i Qeverisë përgjegjës për energjinë me qëllim të hartimit të Balancit të energjisë.

Neni 7

Pikëpamjet e qeverive lokale do të mirren me qëllim të përgatitjes dhe zbatimit të Strategjisë Energjetike, Programit për Zbatimin e Strategjisë dhe Bilanceve Energjetike për komunat e tyre përkatëse.

Neni 8

Operatorët përkatës të sistemit përgatisin planet zhvillimore që janë në përputhje me Strategjinë e Energjisë, Programin për Zbatimin e Strategjisë dhe Bilancet Energjetike.

KREU 3

EFIKASITETI I ENERGJISË, BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË, DHE BASHKË-PRODHIMI

Neni 9

9.1. Politika efikase e energjisë është pjesë përbërëse e Strategjisë së Energjisë.

9.2. Qëllimi i politikës efikase të energjisë është nxitja e shfrytëzimit efikas të energjisë dhe burimeve të energjisë, promovimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimit.

9.3. Gjatë vëzhgimit të mjaftueshmërisë së furnizimit, një program ekonomik për efikasitetin energjetik mund të zvogëloj nevojën për prodhim kapital shtesë. Menaxhimi i kërkesës dhe lëvizja e ngarkesës janë mjete të rëndësishme për sigurimin e furnizimit.

Neni 10

Lidhur me implementimin e një politike efikase të energjisë Zyra ose subjekti i Qeverisë përgjegjës për energjinë kryen punët si në vijim:

- a) përgatitë programet implementuese dhe promovon shfrytëzimin efikas të burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
- b) përgatitë propozimet për stimulimin e shfrytëzimit efikas të energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
- c) mbikëqyrë efikasitetin e energjisë dhe realizimin e kapaciteteve kursyese;
- d) i siguron publikut të dhëna në lidhje me çështjet e efikasitetit të energjisë;
- e) nxitë kontrollet e energjisë dhe planet zhvillimore lokale kursyese të energjisë;
- f) përgatitë aktet nënligjore, pas konsultimit me Zyrën e Rregullatorit për Energji për promovimin e shfrytëzimit efikas të energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
- g) nxitë operimin e organizatave joqeveritare që vepron në interesin e përgjithshëm në sektorin e energjisë;
- h) promovon rritjen e kontributit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë për prodhimin e energjisë në tregun e brendshëm dhe tregjet rajonale të energjisë elektrike në përputhje me objektivat e synuara të përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.

Neni 11

Pjesëmarrësit tjerë në sektorin e energjisë kryejnë detyrat që kanë të bëjnë me implementimin e një politike efikase të energjisë dhe promovimin e burimeve ripërtirëse të energjisë si vijon:

- a) gjatë shpërndarjes së prodhimit, operatori i sistemit të bartjes duhet t'i japë përparësi prodhimit që shfrytëzon burimet e ripërtëritshme të energjisë siç lejohet me Kodin e Rrjetës dhe rregullat dhe

rregulloret tjera të aplikueshme;

- b) operatorët e sistemit përcaktojnë dhe publikojnë rregullat standarde mbi atë se kush i bartë shpenzimet e adaptimeve teknike, siç janë lidhjet e sistemeve dhe përforcimet e sistemeve, të domosdoshme për integrimin e prodhuesve të rinj që furnizohen me energji elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë në sistemin e ndërlidhur. Këto rregulla që miratohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji, duhet të jenë në përputhje me Strategjinë e Energjisë dhe duhet të bazohen në kritere objektive, transparente dhe jodiskriminuese veçanërisht duke marrë parasysh të gjitha shpenzimet dhe përfitimet që dalin nga lidhja e këtyre prodhuesve me sistemin;
- c) operatorët e sistemit i sigurojnë çdo prodhuesi të ri, që dëshiron të jetë i lidhur, vlerësimin e plotë dhe të hollësishëm të shpenzimeve që dalin nga lidhja;
- d) operatorët e sistemit përcaktojnë dhe publikojnë rregullat standarde lidhur me ndarjen e shpenzimeve të sistemeve të instalimit ndërmjet të gjithë prodhuesve që përfitojnë prej tyre, siç janë lidhjet në sistem dhe përforcimet. Këto rregulla që miratohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji, duhet të jenë në përputhje me Strategjinë e Energjisë dhe aktet nënligjore të aplikueshme mbi metodologjitë e tarifave;
- e) Zyra e Rregullatorit për Energji siguron që taksat e bartjes dhe distribuimit nuk shkaktojnë diskriminim ndaj energjisë elektrike të prodhuar prej burimeve të ripërtëritshme të energjisë, duke përfshirë posaçërisht burimet e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë të prodhuar në rajonet periferike, siç janë rajonet me dendësi të ulët të popullatës;
- f) Zyra e Rregullatorit për Energji realizon dhe promovon energjinë duke ekzekutuar kontratat dhe duke nxitur ndërmarrjet për instalimin e kapaciteteve të zgjeruara pa shpenzime fillestare, të ripaguara përmes llogarive të kursimit;
- g) gjatë caktimit të tarifave, Zyra e Rregullatorit për Energji mund të sigurojë burime financimi përmes tarifave, të implementuara nga palët e treta të zgjedhura më ofertim konkurrues, duke operuar sipas një procedure transparente.

Neni 12

12.1. Zyra ose subjekti i Qeverisë përgjegjës për energjinë përcakton çdo vit caqet indikative për kërkesën (konsumin) e energjisë elektrike ose të ngrohjes, të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë ose bashkëprodhimi.

12.2. Caqet indikative caktojnë përqindjen e kërkesës

LIGJI PËR ENERGINË

bruto të energjisë në Kosovë për dhjetë vitet në vijim.

12.3. Caqet indikative shoqërohen me nga një raport që përvijon në vija të trasha masat e ndërmarra a të planifikuara, për arritjen e tyre. Ky raport merr parasysh:

- a) parimet e tregut të energjisë;
- b) karakteristikat e burimeve të ndryshme të ripërtëritshme të energjisë dhe teknologjitë e prodhimit;
- c) nevojën për zhvillimin e konkurrencës ndërmjet prodhuesve.

12.4. Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji siguron që prejardhja e energjisë elektrike së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë mund të garantohet si e tillë në pajtim me kriteret objektive, transparente dhe jodiskriminuese.

Neni 13

Ndërmarrjet e energjisë që furnizojnë me energji elektrike, ngrohje ose gaz, duhet, të paktën një herë në vit, t'i informojnë konsumatorët e tyre për trendet dhe treguesit kryesorë lidhur me konsumin e energjisë. Në këtë kontekst, ata mund të përgatisin programe, që në mënyrë të drejtë nxisin dhe udhëzojnë konsumatorët e tyre për shfrytëzimin efikas të energjisë së shfrytëzuar dhe për arritjen e kursimeve në energji.

Neni 14

14.1. Importuesit dhe prodhuesit e produkteve të konsumit të përgjithshëm që shfrytëzojnë energji gjatë aktiviteteve të tyre duhet të vëjnë tiketën e efikasitetit energjetik në produktet e tyre, me të cilën informon konsumatorët mbi konsumimin e energjisë dhe tiparet e tjera të produktit që janë të rëndësishme për efikasitetin e tyre energjetik.

14.2. Zyra ose subjekti i Qeverisë përgjegjës për energjinë vendosë formën dhe përmbajtjen e tiketave, mënyrën e matjes dhe konstatimit të konsumimit të energjisë, karakteristikat e tjera të produktit dhe metodën për klasifikimin e produktit në lidhje me efikasitetin e tij energjetik.

14.3. Kërkesat e përmendura në paragrafin (2) të këtij neni mund të përcaktojnë që tiketat të jenë të detyrueshme për disa lloje të caktuara të produkteve.

14.4. Dispozitat e këtij neni zbatohen për marka/shenja/ të tjera të produkteve dhe paisjeve, siç është

marka e efikasitetit energjetik dhe specifikacioni energjetik i ndërtesave.

KREU 4

INVESTIMET

Neni 15

15.1. Promovimi i investimeve për modernizimin, riparimin dhe zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, sistemet e bartjes dhe distribuimit duhet të jenë në interesin e Kosovës.

15.2. Ndërtimi i stabilimenteve dhe pajisjeve të reja energjetike si dhe mirëmbajtja e shfrytëzimi i tyre duhet të inkurajohet në Kosovë, me kusht që ndërtimet e tilla të jenë në përputhshmëri me parimet e efikasitetit energjetik.

15.3. Duhet të inkurajohen investimet private në sektorin e energjisë dhe investimet e favorshme të jashtme, kurse kushtet për "buy – back" (*kompenzim tregtar të ndërsjellë*) vendosen me qëllim të tërheqjes së investimeve të çfarëdo lloji si për ndërtimin e pajisjeve të reja energjetike ashtu edhe për modernizimin, riparimin dhe zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese të prodhimit si dhe sistemeve të bartjes dhe distribuimit.

KREU 5

RREGULLIMI EKONOMIK I AKTIVITETEVE ENERGETIKE

Neni 16

16.1. Rregullimi ekonomik i aktiviteteve në sektorin e energjisë duhet të zbatohet në përputhshmëri me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

16.2. Aktivitetet e energjisë në sektorin e energjisë duhet që të ushtrohen ose në bazë të licencës ose pa licencë për ato aktivitete të cilat janë përjashtuar nga kërkesa për marrjen e licencës në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 17

17.1. Aktivitetet energjetike ushtrohen në bazë të rregullave që i rregullojnë ato si aktivitete të bazuara në treg ose si shërbime publike.

17.2. Të gjitha ndërmarrjet energjetike i shërbejnë interesit të konsumatorëve individual duke siguruar

furnizim të sigurtë, efikas dhe të qëndrueshëm me energji elektrike, energji për ngrohje dhe gaz natyror kualitativ; duke siguruar shfrytëzimin efikas të burimeve energjetike; njëkohësisht duke respektuar mbrojtjen e ambientit, shëndetit, jetës dhe pronës së popullit të Kosovës.

- 17.3. Zyra e Rregullatorit për Energji mund të vendosë detyrime shtesë të shërbimeve publike për ndërmarrjet që ushtrojnë shërbime publike në lidhje me sigurinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit, rregullsinë, kualitetin, çmimin e furnizimit si dhe mbrojtjen e mjedisit. Detyrimet në fjalë duhet të jenë të definuara qartë, të mos jenë diskriminuese dhe të jenë të verifikueshme dhe në përputhshmëri me direktivat e Bashkimit Europian.
- 17.4. Çmimet dhe shpenzimet e bëra nga ndërmarrjet energjetike në lidhje me paragrafin (3) të këtij neni njihen si çmime dhe shpenzime të arsyetuara.

Neni 18

- 18.1. Çmimet e energjisë mund të jenë të rregulluara ose të pa rregulluara, varësisht nga ajo nëse ekziston apo jo tregu që mundëson çmime të parregulluara (të vendosura lirshëm ndërmjet blerësit dhe shitësit)
- 18.2. Çmimet e rregulluara të energjisë vendosen në bazë të tarifave që miratohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji.
- 18.3. Çmimet e rregulluara të energjisë rregullohen ose miratohen në përputhshmëri me Metodologjinë tarifore të përgatitur nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.
- 18.4. Sistemi tarifor siguron stimulime për promovimin e efikasitetit të energjisë dhe menxhimin e kërkesës, duke përfshirë edhe promovimin e shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.
- 18.5. Ndërmarrjet e energjisë mund të aplikojnë për njohjen dhe kompensimin e shpenzimeve të pakthyeshme ose të dështuara.
- 18.6. Çmimet e pakthyeshme ose të dështuara janë çmime që rezultojnë nga investimet e bëra dhe transaksionet e përmbyllura nga ndërmarrjet e energjisë elektrike para hyrjes në fuqi të këtij ligji, këto çmime të arsyeshme nuk mund të kthehen për arsye të vendosjes së tregut konkurrues.
- 18.7. Zyra e Rregullatorit për Energji vendosë shumën maksimale dhe periudhën e kompensimit të çmimeve të njohura dhe të pakthyeshme për ndërmarrjet energjetike në përputhshmëri me

rregullat dhe procedurat në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe direktivat e Bashkimit Europian.

Neni 19

- 19.1. Ndërmarrjet energjetike që ushtrojnë aktivitete të energjisë në fushën e energjisë elektrike, ngrohjes dhe gazit natyror janë të obliguara të mbrojnë informatat konfidenciale afariste të përvetësuara gjatë ushtrimit të aktiviteteve dhe detyrave të tyre sipas këtij ligji, përveç nëse me ligje të tjera kërkohet që informatat e tilla të publikohen ose t'u vihen në dispozicion organeve qeveritare.
- 19.2. Vendimi se cilat informata do të konsiderohet si konfidenciale do të merret në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe akteve nen normative të nxjerra nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

Neni 20

Ndërmarrjet energjetike përgatisin, dorëzojnë për revizion dhe publikojnë deklaratat e kontabilitetit në pajtim me ligjet që rregullojnë kontabilitetin në Kosovë. Ndërmarrjet energjetike që nuk janë ligjërisht të obliguara të publikojnë kontabilitetin e tyre vjetor obligohen të mbajnë kopje të këtyre llogarive në regjistrin publik në zyrën e tyre kryesore.

KREU 6

KONKURRENCA NË AKTIVITETET E ENERGIJË

Neni 21

- 21.1. Të gjitha vendimet ndërmjet ndërmarrjeve të ndërlidhura, të asociuara ose të shkrira si dhe të gjitha praktikave të qëllimshme të dy ose më shumë ndërmarrjeve janë të ndaluara nëse praktikave ose vendimet në fjalë kanë për qëllim parandalimin, kufizimin ose ç'rregullimin e konkurrencës në tregun e energjisë përmes:
- rregullimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çmimeve ose kushteve të tjera tregtare;
 - ndarjes së tregjeve ose burimeve të furnizimit;
 - kufizimit ose kontrollimit të prodhimit, tregtimit, zhvillimit teknik ose investimeve në energji;
 - zbatimit të kushteve të ndryshme ndaj personave të caktuar për llojin e njejtë të kontratës, gjë kjo që i vë këta persona në pozitë të pabarabarta si konkurrentë;
 - përmbylljes së kontratave me kusht që pala tjetër të marrë obligime shtesë ose të përmbyllë kontrata sekondare që për nga karakteri i tyre ose sipas praktikave të zakonshme nuk kanë të bëjnë me lëndën e kontraktuesit kryesor ose

LIGJI PËR ENERGINË

përmbushjes së kontratës së tij.

21.2. Të gjitha marrëveshjet dhe vendimet që janë në kundërshtim me paragrafin (1) të këtij neni janë të pavlefshme.

Neni 22

Ndërmarrjet energjetike me pozitë dominuese, konsiderohet se e kanë abuzuar pozitën e tyre nëse:

- drejtpërdrejt ose tërthorazi vendosin çmime të pa justifikuar për shitjen ose blerjen e energjisë dhe kur vendosin kushte tjera të padrejta të tregtimit;
- kufizojnë prodhimin, tregtimin dhe zhvillimin teknik në dëm të klientëve, duke përfshirë edhe krijimin e mungesës së artikujve duke shkatërruar, dëmtuar ose procesuar në mënyrë të paarsyeshme pajisjet;
- ushtrojnë varësi ekonomike si rezultat i së cilës vie deri te transformimi, shkrirja, bashkimi, ndarja ose përbeldhja e ndërmarrjeve të tjera si dhe keqësimi i pa justifikuar i marrëdhënieve afariste afatgjatë.

Neni 23

23.1. Është i ndaluar përvetësimi, shfrytëzimi dhe zbulimi i sekreteve afariste ose tregtare në kundërshtim me praktikatat e drejta tregtare.

23.2. Përvetësimi i fshehtësive të prodhimit ose tregtimit është në kundërshtim me praktikatat e drejta tregtare atëherë kur përvetësimi është bërë përmes përgjimit, infiltrimit ose kushtëzimit, hapjes së korrespondencës (letrave), fotografimit ose hetimit pa lejen paraprake të pronarit të dokumenteve ose materialeve të ruajtura me qëllim të kufizimit të qasjes në to, si dhe përmes mashtrimit ose ofrimit të përfitimeve për personat që kanë qasje në fshehtësitë e tilla për shkak të marrëdhënieve të tyre afariste ose kontraktuese.

23.3. Shfrytëzimi ose zbulimi i fshehtësive të prodhimit ose të tregtimit është i ndaluar atëherë kur fshehtësitë e tilla janë përvetësuar me kusht që të mos shfrytëzohen ose zbulohen.

Neni 24

Zyra e Rregullatorit të Energjisë do t'i fusë në fuqi dispozitat e këtij kapitulli, në pajtim me Ligjin e Rregullatorit të Energjisë dhe me çdo ligj tjetër mbi konkurrencën që është i zbatueshëm në Kosovë.

KREU 7

MASAT KUFIZUESE MBI FURNIZIMIN ME ENERGI

Neni 25

25.1. Qeveria mund të vendosë masa për kufizimin e furnizimit me energji për konsumatorët, ose të vendosë obligime të veçanta për ndërmarrjet energjitike në këto raste:

- çfarëdo "force majeure";
- çfarëdo aksidenti material në instalimet për prodhimin dhe bartjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose gazit natyror;
- çfarëdo shkurtese të papritur ose afatgjate të kapacitetit energjetik ose bartjes së energjisë;
- çfarëdo aktiviteteve terroriste.

25.2. Qeveria mund të vendosë masat në vijim:

- të vendosë kufizime mbi tregtimin me burime të caktuara të energjisë;
- të vendosë kushte të veçanta të tregtimit;
- të kufizojë eksportimin dhe importimin e energjisë ose të vendosë kushte të veçanta për eksportimin dhe importimin e energjisë;
- të detyrojë prodhimin e energjisë;
- të vendosë detyrime për furnizimin me energji për konsumatorë të caktuar.

25.3. Ministri përgjegjës për Energji shpallë të gjitha masat kufizuese përmes mjeteve të informimit publik.

25.4. Mënyrat e kufizimit të prodhuesve dhe konsumatorëve të energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe gazit natyror përcaktohen me akt nënligjor që miratohet nga Qeveria me propozimin e Ministrisë përgjegjëse për energji.

25.5. Ndërmarrjet e energjisë nuk janë të detyruara të paguajnë çfarëdo dëmi të shkaktuar si rezultat i kufizimeve apo ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike, ngrohje ose gaz natyror të përshkruara në paragrafin (1) të këtij neni, me përjashtim të atyre rasteve kur aksidentet ose ndërprerjet afatgjate janë bërë si rezultat i neglizhencës së tyre.

KREU 8

E DREJTA E KALIMIT DHE QASJES NË PRONË

Neni 26

26.1. Ndërtimi ose zgjerimi i stabilimenteve energjetike për bartjen ose distribuimin e energjisë elektrike, ngrohjes ose gazit natyror bëhet në tokë që është në pronësi të ndërmarrjes për energji dhe në të cilën ekziston e drejta për ndërtim.

26.2. Nëse ndërtimi ose zgjerimi i stabilimenteve të për-

mendura në paragrafin (1) të këtij neni bëhet në pronë private, Zyra e Rregullatorit të Energjisë duhet të verifikojë se toka në fjalë është e nevojshme për bartjen ose distribuimin e energjisë dhe pronari i tokës ka të drejtë kompensimi për dhënie e të drejtës së ndërtimit, në një shumë të barabratë me vlerën e tregut.

- 26.3. Nëse ndërtimi ose zgjerimi i stabilimenteve energjetike të përmendura në paragrafin (1) të këtij neni bëhet në tokë joprivate, Qeveria ose komuna përkatëse, me propozimin e Ministrit përgjegjës për energji, mund të trasferojë ose të vendosë të drejta për ndërtim në favor të ndërmarrjes për energji, në përputhshmëri me rregullat e parashtruara në aktet nënligjore të nxjerra sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera në fuqi.

Neni 27

- 27.1. Ndërmarrjet për energji kanë të drejtë të shfrytëzohen në rast nevoje të arsyeshme disa pjesë të ndërtesave për vendosjen e pajisjeve për matje si dhe pajisjeve të tjera që kanë të bëjnë me furnizimin me energji elektrike, ngrohje dhe gaz natyror.
- 27.2. Ndërmarrjet për energji kanë të drejtë të shfrytëzohen në rast nevoje të arsyeshme urat, rrugët, trotualet dhe ndërtesat e tjera, që nuk janë në pronësi të tyre, për ndërtimin, lidhjen, kalimin dhe mirëmbajtjen e linjave ajrore dhe tokësore të energjisë elektrike, gypave për ngrohje, gypave të gazit, gypave të ujit.

Neni 28

- 28.1. Personat fizik dhe juridik do të lejojnë zyrtarët që ushtrojnë inspektime në përputhshmëri me këtë ligj, mund të hyjnë dhe të kalojnë në pronën e çfarëdo individi për ushtrimin e aktiviteteve të tyre në lidhje me inspektimin dhe mirëmbajtjen e stabilimenteve energjetike, instalimeve apo sistemeve.
- 28.2. Personat fizikë dhe juridikë do t'u lejojnë ndërmarrjeve për energji qasje në pronën e tyre në të cilën gjenden stabilimentet, pajisjet, rrjetat, ose sistemet energjetike, me qëllim të mirëmbajtjes apo kontrollimit të tyre, prerjes së pemëve ose vegjetacionit tjetër që mund të pengoj veprimin e pajisjeve, rrjetave ose sistemit.
- 28.3. Personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar t'u lejojnë qasje ndërmarrjeve për energji, për inspektimin e pajisjeve për matje që gjenden në pronën e tyre dhe s'mund të ndalojnë ndërmarrjet për energji të bëjnë ç'kycjen e pajisjeve për matje ose pajisjeve të tjera në lidhje me sitemin e energjisë.

Neni 29

- 29.1. Ndërmarrjet për energji duhet t'i kompensojnë pronarët ose shfrytëzuesit e pronës për çfarëdo dëmi që mund të shkaktohet gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre që mund të rezultojë në kufizimit të shfrytëzimit të pronës ose zvogëlimit të vlerës së saj.
- 29.2. Zyra ose subjekti i Qeverisë përgjegjës për energjinë, do të përcaktojë kriteret dhe kushtet e kompenzimit me aktet nënligjore.

Neni 30

- 30.1. Zonat e sigurisë duhet të vendosen përreth lokaliteteve energjetike.
- 30.2. Brenda çfarëdo zone të sigurisë është i ndaluar ose i kufizuar ndërtimi ose çfarëdo ndërtesë apo godine, prerja e bimëve ose pemëve, ose ushtrimi i aktiviteteve që mund të paraqesin rrezik ndaj sigurisë ose veprimtarisë së pandërprerë të instalimeve energjetike, sigurisë së shëndetit, sigurisë së jetës dhe sigurisë së pronës.
- 30.3. Kushtet dhe mënyra e përcaktimit të lokacionit, madhësia, kufijt e zonave të sigurisë, regjimi i tyre si dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve përcaktohen me akt nënligjor që miratohet nga Qeveria.

Neni 31

Kur pronarët ose shfrytëzuesit e pronës bëjnë ndërtime të palejuara, rrethime, prerje ose aktivitete të tjera që janë në kundërshtim me rregullat për zonat e sigurisë, dhe dështojnë përpjekjet për ndalimin e ndërtimeve ose aktiviteteve të tilla ilegale të paautorizuara brenda afatëve kohore të vendosure nga ndërmarrjet për energji, ndërmarrja për energji është e autorizuar që të kërkojë nga Komuna ndalimin dhe heqjen e ndërtimeve ilegale ose ndalimin e aktiviteteve, me shpenzime të pronarit ose shfrytëzuesit.

KREU 9

MBIKËQYRJA

Neni 32

- 32.1. Inspektorati i Energjisë themelohet pranë Ministrisë përgjegjëse për energji dhe ndërmerr aktivitete të inspektimit dhe mbikëqyrjes sipas këtij ligji.
- 32.2. Roli kryesor i Inspektoratit të Energjisë është që të sigurojë veprimtari të sigurtë dhe të qëndrueshme të pajisjeve energjetike, instalimeve dhe sistemeve.
- 32.3. Inspektorati i Energjisë është përgjegjës për të sig-

LIGJI PËR ENERGJINË

uruar që ndërmarrjet për energji t'i ushtrojnë aktivitetet e tyre në përputhshmëri me ligjet mbi energjinë, rregulloret teknike, standardet dhe rregullat e tjera që zbatohen në lëminë e energjisë elektrike, në lëminë e energjisë për ngrohje dhe gazit natyror.

32.4. Në lëminë e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe gazit, Inspektorati i Energjisë ushtron mbikëqyrje në prodhimin, ndërtimin, ekzekutimin dhe testimet fillestare, eksperimentimin dhe shfrytëzimin e pajisjeve, centraleve, linjave dhe instalimeve për prodhimin, bartjen, distribuimin, matjen, deponimin dhe konsumimin e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe gazit natyror.

32.5. Aktivitetet e mbikëqyrjes mund të ndërmerren gjithashtu edhe nga autoritete tjera në bazë të ligjeve të veçanta, për të kontrolluar ndikimin e aktiviteteve të energjisë në mjedis dhe në shëndetin publik, si dhe për të siguruar që aktivitetet e tilla të jenë në përputhshmëri me ligjet dhe standardet mbi mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.

Neni 33

33.1. Gjatë inspektimeve ose mbikëqyrjeve, inspektorët e Inspektoratit të Energjisë kanë të drejtë të:

- inspektojnë pajisjet, materialet si dhe dokumentacionet teknike të tjera në përputhshmëri me qëllimin e inspektimit ose mbikëqyrjes, si dhe të kërkojnë provat e nevojshme, të marrin mostra dhe, sipas nevojës, të shfrytëzojnë organizatat profesionale ose ekspertë për ushtrimin e inspektimit ose mbikëqyrjes;
- kenë qasje të lirë në shërbimet energjetike nën mbikëqyrjen e tyre;
- kryejnë inspektime të gjendjes teknike dhe sigurisë së pajisjeve energjetike në bazë të rregullat ose kurdo që kërkohet;
- nxjerrin deklarata mbi shkeljen e këtij ligji ose akteve nënligjore të nxjerrasi pasuese të tij;
- nxjerrin urdhëra për mbylljen e ndërmarrjeve për energji kur konstatohet se janë bërë shkelje.

33.2. Të gjithë personat duhet t'i përmbushin udhëzimet e lëshuara nga inspektorët e energjisë gjatë ekzekutimit të detyrave të tyre sipas këtij ligji.

Neni 34

Personat fizikë ose juridikë që posedojnë ose operojnë stabilimente, pajisje, godina, sisteme ose instalime energjetike, për të cilat sipas këtij ligji parashihet inspektimi, obligohen të informojnë menjëherë inspektoratin e energjisë mbi çfarëdo dëmi ose gabimi që mund të shfaqet si pasojë e ndërprerjes së furnizimit të energjisë, ose nëse ekziston rreziku për jetën, shëndetin e njerëzve,

trafikut, godinave fqinje apo mjedisit rrethues.

Neni 35

Nëse një ndërmarrje për energji ose njëdonjë person tjetër fizik ose juridik ushtron aktivitete në kundërshtim me këtë ligj, me aktet nënligjore të nxjerra në bazë të tij, standardet në fuqi ose rregullat e tjera sipas këtij Kreu, Inspektorati i Energjisë mundet:

- t'u dërgojë njoftim me shkrim që përmbanë udhëzime të detyrueshme për korrigjimin e shkeljeve mbrenda një afati të caktuar;
- t'i propozojë Zyrës të Rregullatorit për Energji që të suspendojë, ndryshojë ose tërheqë licencën e tyre;
- t'i propozojë Zyrës të Rregullatorit për Energji të vendosë gjoba administrative dhe dënime sipas këtij ligji;
- ta dërgojë çështjen para autoriteteve kompetente për të ndërmarrë masa të mëtutjeshme që nuk janë nën mandatin e Inspektoratit;
- të informojë publikun mbi çfarëdo veprimtarie ilegale.

Neni 36

36.1. Inspektorët e Inspektoratit të Energjisë duhet të mbajnë të fshehtë çfarëdo informate zyrtare ose afariste që ata e hasin gjatë ushtrimit ose në lidhje me inspektimet e tyre.

36.2. Inspektorët e Inspektoratit të Energjisë ushtrojnë aktivitetet e tyre vetëm, ose, në rast të nevojës, së bashku me organe të specializuara të kontrollit siç e shohin ata të nevojshme.

KREU 10**DISPOZITAT KALIMTARE****Neni 37**

37.1. Brenda dymbëdhjetë (12) muajve pas shpalljes së këtij ligji, Kuvendi i Kosovës miraton Strategjinë për Energji.

37.2. Brenda dymbëdhjetë (12) muajve pas themelimit zyrtar të Ministrisë përgjegjëse për energji, Zyra ose subjekti i Qeverisë përgjegjës për energjinë miraton aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

37.3. Përderisa të themelohet Zyra ose subjekti i Qeverisë përgjegjës për energjinë në Kosovë, kompetencat, detyrat dhe funksionet që i janë dhënë Ministrisë në fjalë nga ky ligj do të ushtrohen nga Zyra e Energjisë pranë Zyrës së Kryeministrit.

Neni 38

Ky ligji hyn në fuqi mbas miratimit të tij nga Kuvendi i Kosovës dhe në ditën e shpalljes nga PSSP-ja.

30.06.2004

UNMIK/ REG/2004 / 21

LIGJI I SPORTIT

LIGJI NR. 2003/24

LIGJI I SPORTIT

Kuvendi i Kosovës,

Duke u bazuar në Rregulloren nr.2001/9 të dt. 15 majit 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, veçanërisht nenet 5.1 (dh), 5.7, 9.1.26.(a), 9.3.2, 9.3.3.;

Nisur nga të drejtat dhe detyrat e të gjitha institucioneve të edukimit fizik dhe të sportit, që të miratojnë kornizën ligjore për veprimin dhe sjelljen e tyre si dhe të drejtat e qytetarit për të zhvilluar veprimtarinë sportive;

Miratoi ligjin vijues:

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Ligj rregullohet organizimi, kushtet dhe mënyrat e zhvillimit të veprimtarivesportive, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e bartësve të tyre, si dhe çështjet e tjera me rëndësi për këto veprimtari veçanërisht themelimi, regjistrimi dhe menaxhimi i organizatave sportive .

Neni 2

Të gjithë personat, pa dallim moshe, gjinie, kombësie, përkatësie politike, racore, fetare, pavarësisht nga mundësitë fizike e mentale, pavarësisht nga niveli shoqëror ose ekonomik i tyre, e gëzojnë të drejtën e marrjes me veprimtari sportive.

Neni 3

3.1. Veprimtari sportive mund të zhvillojnë, organizatat sportive dhe personat e tjerë juridik dhe fizik.

3.2. Personat e tjerë juridikë dhe fizikë, sipas këtij Ligji, janë të gjithë ata persona që janë të regjistruar, si të tillë, për zhvillimin e veprimtarive sportive.

Neni 4

Aktivitetet politike dhe religjioze janë të ndaluara në organizatat të cilat zhvillojnë veprimtari sportive.

II. PËRKUFIZIMET THEMELORE

Neni 5

Sipas këtij Ligji, sportive konsiderohet, arsimimi sportiv dhe aktivitetet sportive të orientuara në arritjen e rezultateve në garat sportive, si dhe,

- veprimtaritë për zhvillimin e trupit dhe lojërat e të gjitha grupmohave;
- ripërtëritja sportive;
- sporti korektues ;
- veprimtaritë e personave profesionalë që përgatitin pjesëmarrës për garat sportive;
- veprimtaritë e personave që marrin pjesë në organizimin dhe udhëheqjen e garave sportive e të shfaqjeve të tjera sportive.

Neni 6

Sipas këtij Ligji:

- 6.1. Veprimtari sportive, konsiderohen veprimtaritë të cilat kanë për qëllim, zhvillimin e aftësive psiko-fizike për arritjen e rezultateve sportive në garat e të gjitha niveleve dhe të të gjitha grupmohave.
- 6.2. Edukim fizik konsiderohet formimi psiko-fizik i nxënësve, studentëve dhe qytetarëve të tjerë për mirëqenie të shëndoshë të tyre.
- 6.3. Sport amator, konsiderohet veprimtaria sportive mbi parimin e vullnetarizmit.
- 6.4. Sport profesionist, konsiderohet veprimtaria e sportistëve, të cilët zhvillojnë aktivitete sportive në mënyrë profesioniste dhe që janë të pajisur me kontratë me klubin përkatës nga i cili edhe financohen.
- 6.5. Organizatë sportive, konsiderohet çdo organizëm që zhvillon veprimtari sportive .
- 6.6. Klub sportiv, konsiderohet organizata sportive, që ka si qëllim të vetin, zhvillimin e veprimtarisë sportive në një njësi administrative-territoriale të Kosovës.
- 6.7. Federatë e sportit, konsiderohet organizata sportive, si shoqatë qytetare, që ka si qëllim të vetin organizimin, zhvillimin dhe përhapjen e sportit në degë të caktuara, në gjithë territorin e Kosovës.

Neni 7

- 7.1. Veprimtaria sportive, nxitet e drejtohet nga personat fizikë e juridikë, njëkohësisht mbështetet nga organet përgjegjëse për edukimin fizik dhe sportin, nëpërmjet subvencioneve e lehtësive fiskale.
- 7.2. Përkufizimet më të plota, rreth lehtësive fiskale, përcaktohen me akte nënligjore, të nxjerra në përputhje me ligjet përkatëse.

Neni 8

- 8.1. Ministria përkatëse, përcakton politikat e përgjithshme të zhvillimit të sportit, në përputhje me

prioritetet e masovizimit dhe të ngritjes së cilësisë së tyre. Ajo krijon kushtet infrastrukturale, financiare dhe kadrovike për përmbushjen e objektivave të caktuara.

8.2. Ministria përkatëse autorizon Institutin e Kulturës fizike ose ndonjë subjekt tjetër profesional, që të bëjë më përcaktimin e kriteve për zhvillimin e veprimtarisë sportive dhe zbatimin e politikave të edukimit fizik dhe të sportit.

8.3. Me shkëlqen e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga aktet e tyre normative dhe nga ky Ligj, organizatat sportive dhe të gjithë subjektet e tjerë të sportit, përgjigjen para organeve të caktuara kompetente.

III. INTERESI PUBLIK PËR VEPRIMTARINË SPORTIVE DHE MBËSHTETJA INSTITUCIONALE E SAJ

Neni 9

Çdo banor i Kosovës gëzon të drejtën e marrjes me veprimtari sportive.

Neni 10

Veprimtaria sportive, paraqet një fushë të rëndësishme të interesit publik e kosovar, e cila zhvillohet mbi bazë të vullnetarizmit ose të profesionalizmit.

Neni 11

11.1. Organet përgjegjëse për edukimin fizik dhe të sportit, janë të detyruara që të angazhohen për të zhvilluar veprimtarinë sportive si fushë të interesit publik e kosovar.

11.2. Interesi publik e kosovar i veprimtarisë sportive realizohet me sigurimin e të gjitha rrethanave dhe kushteve, e veçanërisht me mjete për programet në shkallë të vendit, me planifikimin, ndërtimin, mbajtjen e objekteve sportive, përcaktimin dhe zbatimin e politikave që nxisin, zhvillojnë dhe përparojnë këtë veprimtari.

Neni 12

Veprimtaritë sportive, në mënyrë të veçantë përfshijnë veprimtaritë me interes të përgjithshëm dhe lokal në të gjitha degët sportive dhe programet për realizimin e tyre.

Neni 13

Institucionet publike të të gjitha niveleve, veçanërisht ato, që me këtë Ligj shpallen kompetente, kujdesen për rajtimin, mirëmbajtjen dhe mbështetjen financiare të edukimit fizik dhe të sportit.

Neni 14

Edukimi fizik dhe sportiv, është i paprekshëm dhe autonom në planifikimin dhe zhvillimin e tij.

Neni 15

Organizatrat sportive dhe të gjithë subjektet e tjerë, të edukimit fizik dhe të sportit, përcaktojnë projektet për zhvillimin e edukimit fizik dhe të sportit për të gjithë, përfshirë këtu gjinitë dhe grupet e ndryshme etnike, nga zhvillimi i aktivitetit masiv e deri te niveli më i lartë.

Neni 16

Edukimi fizik dhe sporti për të gjithë mbartin vlera të veçanta dhe kombëtare, ku si të tilla, janë në vëmendjen e vazhdueshme të institucioneve publike të të gjitha niveleve, veçanërisht të atyre që shpallen kompetente në përputhje me këtë Ligj dhe për zbatimin e tij.

Neni 17

Organizatrat sportive, mbi bazën e Strategjisë së Zhvillimit të Sportit në Kosovë, ofrojnë kontributin e vet në kujdesin për shëndetin dhe zhvillimin social të vlerave të sportit, përmes tolerancës, miqësisë, bashkëpunimit, dhe parimeve të tjera të Kartës Olimpikë dhe të Kartës Europiane të Sporteve.

Neni 18

Organizatrat sportive, janë të obliguara të merren me zgjidhjen e problemeve më emergjente të sportit, duke marrë masa adekuate për përbalimin e tyre, veçanërisht duke u konsultuar e shfrytëzuar mendimin e kuadrove të specializuara dhe duke zgjeruar hapësirat menaxhuese institucionale të sportit.

Neni 19

19.1. Për kryerjen e punëve me interes publik e kosovar, për edukimin fizik e të sportit, Ministria përkatëse nxjerrë Programin për Zhvillimin e Edukimit Fizik dhe të Sportit për periudhën katër vjeçare.

19.2. Në Program, në mënyrë të veçantë përcaktohen:

- nevojat e edukimit fizik, të sportit dhe prioritetet e zhvillimit të tyre;
- kualifikimi profesional i kuadrit;
- stimulimi i talentëve të rinjë;
- projektimi dhe sigurimi i investimeve në objektet sportive;
- mjetet e nevojshme për realizimin e interesit publik e kosovar në edukimin fizik dhe sportiv.

19.3. Në Program, në mënyrë të veçantë, përcaktohen nevojat e edukimit fizik dhe sportiv të personave me aftësi të kufizuara.

LIGJI I SPORTIT

IV. QËLLIMET DHE SYNIMET E SPORTIT

Neni 20

Qëllimet dhe synimet e sportit janë:

- nxitja dhe zhvillimi i sportit masiv për të gjithë;
- ngritja e vazhdueshme e cilësisë së sportit profesionist;
- strukturimi i organizatave sportive, me qëllim të saktësisimit të funksionit publik e kosovar të sportit;
- institucionalizimi i sportit sipas përvojave europiane dhe më gjerë;
- ndërtimi i infrastrukturës sportive në aspektin social të saj;
- njohja dhe kultivimi i përvojave më të mira bashkëkohore, që synojnë ndërkombëtarizimin e sportit të Kosovës dhe integrimin e tij në sportin evropian e botëror;
- përshtatja e praktikave më të mira menaxhuese bashkëkohore në sport etj.

V. ASOCIACIONI OLIMPIK I KOSOVËS

Neni 21

Asociacioni Olimpik i Kosovës (AOK) është institucioni më i lartë sportiv kosovar, që përfshinë organizata dhe shoqata anëtare të sporteve në Kosovë.

Neni 22

AOK është i organizuar në përputje me interesat e zhvillimit të sportistëve dhe të sportit në Kosovë.

Neni 23

AOK organizon, drejton, bashkërendon zhvillimin e sportit olimpik dhe sporteve të tjera të njohura, si dhe aktiviteteve lidhur me to në bashkëpunim me organizatat e sportit dhe ato publike, bazuar në vendimet e saj si dhe rregullat dhe procedurat e miratuara në përputhje me këtë Ligj.

Neni 24

24.1. Qeveria (Ministria) do t'i përkrahë aktivitetet e AOK-ut në kuadër të mundësive buxhetore.

24.2. Asnjë organizatë sportive nuk mund ta përdorë dhe keqpërdorë emrin e AOK-ut.

Neni 25

Struktura organizative e AOK-ut përfshin Kosmisionin për Arbitrazh në Sport (KAS), i cili punon në përputhje me aktet dhe standardet e aplikueshme ndërkombëtare të arbitrazhit në sport.

Neni 26

Në kuadër të AOK-ut funksionon Komisioni i Arbitrimit Sportiv (KAS) në pajtim me aktet përkatëse të KAS-it ndërkombëtar.

VI. FEDERATAT E SPORTIT

Neni 27

Federatat e sportit, themelohen dhe funksionojnë në përputhje me dispozitat e këtij Ligji, statuteve dhe të rregulloreve të tyre të brendshme, të nxjerra në përputhje me këtë Ligj, si dhe të përshtatur me statutet e federatave ndërkombëtare përkatëse të sportit.

Neni 28

Federatat e sportit në strukturën e tyre të menaxhimit duhet të përfshijnë të dy gjinitë, të gjitha grupet etnike dhe minoritetet.

Neni 29

29.1. Federata e Sportit, i zhvillon aktivitetet e veta bazuar në politikat dhe në pajtueshmëri me programin e tyre të punës.

29.2. Ministria përkatëse do të mbikëqyrë politikat sportive të Kosovës, të realizuara nga federatat e sportit.

Neni 30

30.1. Federatat e sportit, janë të detyruara t'i publikojnë vendimet e tyre.

30.2. Federatat e sportit, mund të zhvillojnë procedurë disiplinore ndaj anëtarëve të tyre.

30.3. Federatat e sportit, zhvillojnë kontroll për zbatimin e normave të statutit, të akteve të tjera të brendshme dhe të atyre ndërkombëtare, duke u bazuar në parimet e përgjithshme dhe normat konkrete të së drejtës.

30.4. Po qe se, vendimet e federatave të sportit janë në kundërshtim të hapur me aktet normative të tyre dhe me këtë Ligj, atëherë organet përfaqësuese dhe personat përgjegjës, dalin para organeve kompetente të drejtësisë, të cilat mund ta anulojnë zbatimin e vendimeve dhe të marrin masa përkatëse ndaj personave udhëheqës.

Neni 31

31.1. Miratimi i statuteve të federatave të sportit u shërben si autorizim për të marrë e përdorë emrin me qëllim të funksionimit si federata të sportit.

31.2. Kriteret dhe procedurat përkatëse, për marrjen e lejes dhe për funksionimin e federatave të sportit,

i përcaktojnë organet profesionale, të autorizuar nga Ministri përkatës.

Neni 32

- 32.1. Për një degë të caktuar sportive, për tërë territorin e Kosovës, themelohet dhe vepron një federatë e vetme e licencuar.
- 32.2. Nxënësit, studentët dhe personat me aftësi të kufizuara, mund të themelojnë federatat e tyre në degë të caktuara sportive.

Neni 33

- 33.1. Federatat e sportit, veprojnë mbi bazën e amatorizmit.
- 33.2. Federatat e sportit, mund t'i paguajnë profesionistët dhe këtë e përcaktojnë në aktet e tyre normative.
- 33.3. Federatat e sportit, mund të marrin ndihmë nga Ministria përkatëse, nga donatorët dhe nga sponsorët.
- 33.4. Federatat e sportit, munden që, brenda rregullave të miratuara në organet e veta, nga fondet e veta, shpërblejnë sportistët cilësorë, për rezultatet e arritura sportive.

VII. KLUBET SPORTIVE

Neni 34

Klubet sportive themelohen dhe funksionojnë në bazë të këtij Ligji dhe të akteve normative të federatave përkatëse.

Neni 35

Klubet sportive mund të jenë publike ose private. Klubet publike regjistrohen si organizata joqeveritare, ndërsa klubet private regjistrohen në bazë të ligjeve përkatëse në Kosovë.

Neni 36

Klubet sportive publike, veprimtarinë e tyre e bazojnë në subvencionet financiare buxhetore ose lokale, si dhe në donacionet nga personat fizikë dhe juridikë.

Neni 37

- 37.1. Klubet sportive private, themelohen me iniciativa të lira të anëtarëve të tyre dhe, regjistrohen në federatat përkatëse.
- 37.2. Përkufizimet më të plota do të bëhen me aktet nënligjore, të nxjerra në bazë të ligjeve të veçanta.

VIII. PJESËMARRËSIT NË VEPRIMTARITË SPORTIVE

Neni 38

Sipas këtij Ligji, pjesëmarrës në veprimtari sportive janë:

- sportistët e të gjitha grupmohave;
- veprimtarët sportivë;
- pjesëmarrësit e tjerë;
- adhuruesit e sportit, si spektatorë.

Neni 39

- 39.1. Veprimtaritë sportive, zhvillohen mbi baza amatore dhe profesionale.
- 39.2. Sportistët të cilët veprimtaritë sportive i zhvillojnë profesionalisht, të gjitha të drejtat dhe detyrat për marrëdhënie pune, i realizojnë në klubin sportiv, si punëdhënës, në mënyrën e përcaktuar me Ligjin e Punës, me marrëveshjen kolektive dhe me kontratën individuale.

Neni 40

- 40.1. Ministria autorizon trupin profesional që t'a bëjë kategorizimin e sportistëve sipas standardeve ndërkombëtare.
- 40.2. Mund të përcaktohen tri kategori sportistësh, të cilat veprimtarinë sportive e zhvillojnë profesionalisht: sportistë të kategorisë botërore; sportistë të kategorisë ndërkombëtare dhe sportistë të kategorisë së vendit.
- 40.3. Verifikimin e dy kategorive të para, në bazë të propozimit të Trupit profesional, e bën Ministria përkatëse, ndërsa verifikimin e kategorisë së sportistëve të kategorisë së vendit, e bëjnë federatat përkatëse të sportit.
- 40.4. Rezultatet sportive, përbëjnë kriterin themelor për kategorizimin e sportit dhe të sportistëve.
- 40.5. Ministria përkatëse merr përsipër përkujdesjen materiale dhe profesionale për sportistët kulminantë.

Neni 41

- 41.1. Sportistëve të cilët veprimtarinë sportive e zhvillojnë mbi baza amatore klubi sportiv obligohet t'u sigurojë kompenzim material.
- 41.2. Sportistët amatorë marrin edhe shpërblime të tjera për rezultate të arritura sportive, sipas kushteve të përcaktuara me aktet e klubit sportiv.

Neni 42

- 42.1. Sportisti nuk ka të drejtë të bëjë kontratë me një

LIGJI I SPORTIT

klub sportiv në të njëjtën kohë kur është i lidhur me kontratë me klubin tjetër sportiv.

42.2. Çdo shkelje e kësaj dispozite dënohet sipas sanksioneve të përcaktuara me këtë Ligj.

Neni 43

Mënyra e kalimit të sportistëve profesionistë, dhe e sportistëve amatorë, përcaktohet me rregulloret e federatave të sporteve përkatëse, në përputhje me normat e federatave ndërkombëtare.

Neni 44

Konfliktet lidhur me respektimin e kontratave në mes të klubeve sportive, nëse nuk zgjidhen përmes federatave përkatëse, zgjidhen nga gjykatat kompetente.

IX. MARRËDHËNIET SPORTIVE ME JASHTË

Neni 45

Në asociacionet sportive ndërkombëtare, mund të anëtarësohet vetëm një federatë sportive nga një sport i caktuar, që vepron në mbarë territorin e Kosovës.

Neni 46

Klubet sportive, mund të kontaktojnë dhe të lidhin marrëveshje për gara jasht vendit, sipas pëlqimit të federatave të sporteve përkatëse.

Neni 47

Sportistët e zgjedhur në ekipin përfaqësues, kanë të drejtën e grumbullimit e të trajtimit të veçantë për takimet zyrtare ndërkombëtare të të gjitha niveleve.

Neni 48

48.1. Sportistët e ekipit përfaqësues të Kosovës, në çdo sport, paraqiten me embleme dhe me fanelat me kombinim të njëjtë ngjyrash.

48.2. Ekipi përfaqësues ka selektorin e vet të cilin e zgjedhë federata përkatëse.

X. RAPORTI I ORGANEVE PËRGJEGJËSE PËR SPORTIN DHE I ORGANIZATAVE SPORTIVE

Neni 49

49.1. Organizata sportive, mund të zhvillojë veprimtari sportive, po qe se i përmbushë kushtet e përcaktuara me këtë Ligj, të cilat, qysh më parë i publikon Ministria përkatëse dhe organet përgjegjëse të pushtetit lokal.

49.2. Organizata sportive, mund të fillojë ta zhvillojë veprimtarinë sportive, kur organi përgjegjës vërteton se janë përmbushur kushtet për të cilat i lëshon vendimin përkatës.

49.3. Po qe se organizata sportive, zhvillon veprimtarinë sportive, pa marrjen e vendimit përkatës, organi përgjegjës, nisë procedurën para gjykatës kompetente për pushimin e veprimtarisë së saj.

Neni 50

50.1. Ministria përkatëse, në mënyrë të veçantë e mbikëqyrë:

- përmbushjen e kushteve për realizimin e detyrave me rëndësi publike dhe kosovar për sportin;
- shpenzimin e mjeteve publike;
- menaxhimin dhe shfytëzimin e objekteve sportive publike;
- përmbushjen e standardeve dhe parimeve për realizimin e programeve në shkallë të vendit;
- përmbushjen e kushteve për organizimin e garave sportive ndërkombëtare për të cilat jep pëlqimin;
- përmbushjen e standardeve për kontrollimet mjekësore të përkohshme dhe periodike;
- keqpërdorimin ose shkeljen e të drejtave të sportistëve dhe të klubeve sportive,
- rregullsinë e punës së federatave të sporteve.

50.2. Mbikëqyrja, ushtrohet nga komisioni përkatës profesional të cilin e emëron Ministria.

50.3. Organi mbikëqyrës mund t'ia ndalojë organizatës sportive ose individit, zhvillimin e veprimtarisë sportive ose t'i shqiptojë masa të tjera, në përputhje me këtë Ligj.

50.4. Kundër vendimeve të shqyrtuara mund të ushtrohet e drejtë e ankesës në KAS të AOK-ut në afat prej 15 ditësh. Palët e pakënaqura në vendimet e KAS-it mund të ankohen në Komisionin e Arbitrimit Sportiv Ndërkombëtar.

XI. EDUKIMI FIZIK DHE SPORTI NË SHKOLLA DHE NË UNIVERSITET

Neni 51

Rinia shkollore dhe studentore, e gëzojnë të drejtën, që gjatë shkollimit dhe studimit të mirren me edukim fizik dhe sport në shkollë dhe në universitet.

Neni 52

52.1. Edukimi fizik dhe sporti në shkolla dhe në universitet, kanë për synim,

- zhvillimin e veprimtarive të edukimit fizik dhe të sportit me qëllim të krijimit të kushteve për një gjendje të mirë shëndetësore, fizike dhe të lëvizjeve psiko-motorike të tyre;
- përballimin e pasivitetit dhe apatisë së nxënësve dhe studentëve në planin intelektual, emocional, lëvizor e shoqëror;
- orientimin shkollor dhe universitar të nxënësve dhe studentëve, sipas prirjeve e aftësive të tyre;
- ndalimin e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe ndalimin e rritjes së konflikteve në shoqëri;
- bashkërendimin e bashkëveprimin në veprimtaritë e edukimit fizik dhe të sportit në shkolla e në universitet;
- inkurajimin e dëshirave, prirjeve e talenteve të nxënësve e të studentëve për sporte të caktuara dhe,
- ngritjen e ekipeve të ndryshme të nxënësve dhe studentëve sipas llojeve të sporteve, sipas kushteve dhe mundësive të shkollave e universitetit.

52.2. Ministria përkatëse në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë kujdeset për zhvillimin dhe edukimin fizik dhe të sportit në shkolla dhe në universitet.

XII. KUADRI PROFESIONAL

Neni 53

Kuadër profesional konsiderohen personat të cilët kanë të kryer më së paku shkollimin e lartë sportiv universitar, përkatësisht personat që në formë të specializimit kanë arritur shkallë të duhur kualifikimi profesional.

Neni 54

Kuadri i huaj profesional, mund të angazhohet në udhëheqjen e treningut sportiv dhe të ndeshjeve sportive në vend, nëse i plotëson kushtet sipas nenit 53 të këtij Ligji.

XIII. OBJEKTET DHE MJEDISËT SPORTIVE

Neni 55

Objektet dhe mjediset sportive mund të jenë:

- publike dhe
- private.

Neni 56

Përkatësia e objekteve dhe e mjediseve sportive, përcaktohen me vendim të veçantë të organit përgjegjës për sportin.

Neni 57

Objektet dhe mjediset sportive janë private, atëherë kur

ndërtohen tërësisht nga personat privatë.

Neni 58

Objektet dhe mjediset sportive në pronësi publike qeverisen nga organi përgjegjës për sportin. Objektet dhe mjediset e tjera sportive qeverisen nga pronarët ligjorë të tyre.

Neni 59

Ndalohet ndryshimi i destinimit të objekteve dhe mjediseve sportive.

XIV. MBROJTJA SHËNDETËSORE DHE PËRDORIMI I SUBSTANCËVE DHE METODAVE STIMULUESE NË SPORT

Neni 60

60.1. Personat të cilët në klubet sportive aktivisht zhvillojnë veprimtari sportive, janë të detyruar që t'i nënshtrohen kontrollit mjekësor.

60.2. Kontrolli mjekësor përfshinë, vizitën mjekësore përpara fillimit të ndeshjes, ndërsa kontrollin sistematik gjatë kohës së pjesëmarrjes në veprimtari sportive.

60.3. Numrin e kontrollimeve sistematike, e përcakton secila federatë sportive, më së paku një herë në vit.

Neni 61

Kontrollin shëndetësor të pjesëmarrësve në veprimtari sportive, e kryen mjeku specialist i mjekësisë sportive në ambulancat përkatëse.

Neni 62

Çdo person, i cili në një klub sportiv, aktivisht zhvillon veprimtarinë sportive, pajiset me kartelë mjekësore.

Neni 63

Përdorimi i substancave dhe metodave të ndaluara stimuluese, si dhe nxitja për përdorimin e tyre, dënohen sipas normave ndërkombëtare të pranuar nga federatat e sporteve përkatëse, të përfshira në aktet normative të tyre.

Neni 64

Kosova ka komisionet përkatëse të specializuara të cilat merren me edukimin, propagandën, luftën dhe kontrollin për kundërstimulimin në sportin e Kosovës.

XV. FINANÇIMI

Neni 65

65.1. Bazën e financimit të sportit dhe të nevojave

LIGJI I SPORTIT

publike e kosovare, e përbëjnë mjetet financiare që sigurohen nga buxheti i Kosovës.

65.2. Komunat i formojnë fondet e veta për financimin e sportit.

65.3. Programin e nevojave publike e kosovare në sport, në bazë të propozimit të Ministrisë përkatëse, e miraton Qeveria e Kosovës.

65.4. Pjesa tjetër e financimit të sportit realizohet në bazë të të ardhurave që personat juridikë dhe fizikë, të cilët zhvillojnë veprimtari sportive, realizojnë me zhvillimin e kësaj veprimtarie, nëpërmjet kuotave të anëtarësisë, nga lojërat e fatit dhe burimet e tjera që ndihmojnë veprimtarinë e rregullt të organizatave sportive.

65.5. Mjetet plotësuese për financimin e sportit, mund të sigurohen nëpërmjet reklamave dhe sponsorizimit.

XVI. REKLAMA DHE SPONSORIZIMI

Neni 66

Shoqëritë tregtare dhe prodhuese kanë të drejtën që të hyjnë në marrëdhënie me organizatat sportive me qëllim reklamimi ose sponsorizimi.

Neni 67

67.1. Marrëdhëniet në mes të shoqërive tregtare dhe prodhuese, me organizatat sportive, përcaktohen me kontratë.

67.2. Lehtësitë tregtare që mund t'i gëzojnë shoqëritë tregtare dhe prodhuese, që sponsorojnë veprimtarinë e organizatave sportive, përcaktohen me akte nënligjore, të nxjerra në bazë të ligjeve përkatëse.

XVII. E DREJTA RADIOTELEVIZIVE

Neni 68

Personi fizik a juridik, që organizon një veprimtari sportive është pronar i së drejtës së transmetimit në radiotelevizion për të cilin bëhet kontrata.

XVIII. INFORMIMI

Neni 69

69.1. Për të siguruar një evidencë të rregullt dhe të saktë për gjendjen në sportin e Kosovës, në Ministrinë përkatëse vepron një shërbim i veçantë për

mbledhjen dhe ruajtjen e informatave.

69.2. Shërbimi për informata, mban evidencën (regjistrat) e sportistëve, të pjesëmarrësve të tjerë në veprimtari sportive, mban evidencën e garave sportive, kombëtare e ndërkombëtare, të objekteve sportive dhe të të dhënave të tjera me interes për sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm.

XIX. LUFTIMI I DHUNËS NE SPORT

Neni 70

Çdo shfaqje e dhunës në kuptimin e saj fizik ose moral, si fyerje, dënohet sipas dispozitave disiplinore të federatave sportive, Ligjit për Kundërvajtje, dhe Ligjit Penal të Kosovës.

Neni 71

Ndalohet mbajtja dhe përdorimi i fishekëzjarreve dhe armëve të të gjitha llojeve, në objektet dhe mjediset sportive.

Neni 72

Ndalohet tregtimi dhe përdorimi i pijeve alkoolike në objektet dhe mjediset sportive.

Neni 73

73.1. Ndalohet duhani në objektet dhe mjediset e mbyllura sportive.

73.2. Personat që shkelin këtë dispozitë, largohen nga objektet dhe mjediset e mbyllura sportive.

Neni 74

74.1. Personi që merr pjesë në veprimtarinë sportive, në cilësinë zyrtare (gjyqtari, vëzhguesi etj.) është i paprekshëm.

74.2. Çdo cenim ose synim për cenim të personit që merr pjesë në veprimtarinë sportive, në cilësinë zyrtare, konsiderohet cenim ose synim për cenim i personit zyrtar dhe, ndiqet në procedurë disiplinore ose penale.

Neni 75

75.1. Ruajtja e rendit publik në objektet dhe mjediset sportive, është kompetencë e policisë.

75.2. Organizatori i një veprimtarie sportive, është i detyruar, që për këtë veprimtari të njoftojë policinë tri ditë para zhvillimit të veprimtarisë në territorin e të cilit ajo zhvillohet.

XX. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 76

76.1. Me dënim me gjobë, në shumë prej 1000-5000 €,

dënohen organizatat sportive:

- nëse kryejnë veprimtari sportive pa marrjen e pëlqimit nga organi përgjegjës;
- nëse merren me organizimin politik e fetar;
- nëse veprimtaritë sportive i kryejnë në objekte sportive të papërshtatshme dhe me kuadër të paspecializuar profesional.

76.2. Për shkelje të Ligjit nga alineja e mësipërme, përveç dënimit me gjobë, mund të shqiptohen edhe masa të ndalimit të veprimtarisë sportive për kohë të caktuar, prej 6 muaj deri në 3 vjet.

Neni 77

77.1. Me dënim me gjobë, prej 1000-5000 €, dënohet personi profesional i cili detyron sportistin të stërvis ose të merr pjesë në gara sportive kur nuk është i aftë për shkak të ndonjë lëndimi ose sëmundjeje.

77.2. Për shkelje të Ligjit nga alineja e mësipërme, përveç dënimit me gjobë, personit profesional mund t'i shqiptohet edhe masa e ndërprerjes së punës së tij profesionale për kohë të caktuar prej 6 muaj deri në 3 vjet.

Neni 78

78.1. Me dënim me gjobë, prej 1000-10.000 €, dënohet personi i cili jep ose merr preparate stimuluese të cilat janë të ndaluara dhe të dëmshme për shëndet.

78.2. Për shkelje të Ligjit nga alineja e mësipërme, personit mund t'i shqiptohet edhe masa e ndalimit të profesionit për kohë të caktuar prej 1 deri në 5 vjet.

Neni 79

79.1. Me dënim me gjobë prej 1000-2500 euro, dënohet organizatori i garave dhe shfaqjeve sportive, i cili nuk siguron ndihmën e shpejtë medicinale gjatë kohës së mbajtjes së garave ose shfaqjeve sportive.

79.2. Për shkelje nga alineja e mësipërme organizatorit të garave dhe shfaqjeve sportive mund t'i shqiptohet edhe masa e ndalimit të veprimtarisë sportive për kohë të caktuar prej 3 muaj deri në 1 vjet.

Neni 80

80.1. Në rastet e përsëritjes së shkeljeve nga të njëjtit subjekt ose individë, ndeshkimet mund të dyfishohen.

80.2. Kundër vendimeve për dënime me gjobë ose për masën e ndalimit të veprimtarisë sportive për kohë të caktuar, në procedurat përkatëse, mund të ushtrohet e drejta për ankesë.

XXI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 81

Me miratimin e këtij Ligji, shfuqizohen dispozitat e tjera për sportin në Kosovë.

Neni 82

Organizatrat sportive dhe subjektet e tjerë, duhet që, në afatin prej gjashtë muajsh të bëjnë harmonizimin e akteve të tyre normative me këtë Ligj.

Neni 83

Ministria përkatëse, duhet që, në afatin prej 6 muajsh të nxjerrë aktet nënligjore në bazë dhe për zbatimin e këtij Ligji.

Neni 84

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi, në datën e shpalljes së tij nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

28.07.2004

UNMIK/ REG/ 2004/26

LIGJI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE

LIGJI NR. 2004 / 17

PËR MBROJTJEN E
KONSUMATORËVE

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Rregullores nr. 2001/ 9 të dt. 15 majit 2001 të Kornizën Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, Kreut 5.1 (ç), 5.7, 9.1, 9.3.3, 11.2,

në bazë të Rregullores nr. 1999/ 1 dt. 25 qeshor 1999 mbi autorizimet e Misionit të Përkohshëm të OKB-së në Kosovë, të plotësuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 të dates 12 dhjetor 1999 mbi ligjin e aplikueshëm në Kosovë dhe me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit në tregun e lirë në Kosovë,

duke siguruar që përmbajtja e rregullave të mënjanoj dukuritë e paligjshme dhe duke avancuar mbrojtjen vendore në përputhshmëri me përvojat ndërkombëtare.

Aprovon:

LIGJIN PËR MBROJTJEN E
KONSUMATORËVE

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj përcakton, rregullon dhe mbron të drejtat themelore të konsumatorëve gjatë blerjes së mallrave, shërbimeve dhe formave të tjera në tregun e lirë. Ligji siguron mbrojtjen e shëndetit, mjedisit, dhe interesave ekonomike të konsumatorit.

Përkufizimet dhe rregullat e interpretimit

Neni 2

Secila prej termave në vijim, kudo në këtë ligj do të ketë kuptimin e dhënë, përveç nëse konteksti brenda të cilit një term i tillë paraqitet, nënkupton qartë diçka tjetër:

Ministri nënkupton Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë të themeluar në pajtim me Rregulloren nr. 2001/19 të UNMIK-ut.

Ministër nënkupton Ministrin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Konsumator nënkupton çdo person fizik që blen dhe përdor mallra ose shërbime për plotësimin e nevojave të veta dhe jo për qëllime që janë të lidhura me veprimtari tregtare, respektivisht për rishitjen e atyre mallrave.

Shitës nënkupton personin fizik dhe/apo juridik që shet mallra apo i kryen shërbim konsumatorit.

Tregtar në kuptim të këtij ligji, është personi fizik apo juridik, i cili ushtron veprimtari tregtare dhe i regjistruar për ushtrimin e kësaj veprimtarie,

Furnizues është çdo person fizik dhe/apo juridik që ofron mallra tek shitësi në përputhje me veprimtarinë tregtare apo profesionin e tij.

Prodhues është çdo person fizik dhe/apo juridik që vë emrin e tij, marken e prodhimit ose çdo shenjë tjetër dalluese në mallrat e konsumit si dhe importuesi i mallrave në territorin e Kosovës që vepron në kuadrin e veprimtarisë së tij tregtare.

Mall konsumi është çdo send i prekshëm, i luajtshëm, i matshëm dhe i përcaktuar për t'iu shitur konsumatorëve në çdo mënyrë të ligjshme.

Kontratë është çdo marrëveshje ndërmjet prodhuesit, shitësit, furnizuesit dhe ofruesit të shërbimeve nga njëra anë dhe konsumatorëve nga ana tjetër, me objekt kalimin e pronësisë së mallit apo kryerjen e shërbimit.

Garanci është detyrimi, i përcaktuar me kontratë, i prodhuesit, shitësit, furnizuesit ose ofruesit të shërbimeve ndaj konsumatorëve për riparimin, zëvendësimin me mall tjetër ose për kthimin shumës së paguar për atë mall konsumatorit.

Deklaratë është dokumenti, me të cilin prodhuesi deklaron në përgjegjësinë e vet personale se një mall apo shërbim i ofruar prej tij është konform një standardi dhe specifikimi teknik.

E meta në mall është mungesa e sigurisë dhe cilësisë së mallit apo shërbimit të paguar nga konsumatori .

Riparimi është sigurimi i gjendjes së mallrave sipas kontratës së shitjes në rastet e mungesës së përputhjes me të.

Çmimi i shitjes së mallit është çmimi përfundimtar i dhënë për njësinë e mallit ose për sasinë e tij duke përfshirë dhe taksat.

Të drejtat themelore të konsumatorit

Neni 3

3.1. Me këtë Ligj rregullohet mbrojtja e së drejtës themelore të konsumatorëve pranë blerjës së prodhimeve dhe shërbimeve, si dhe pranë formave tjera të përvetësimit të prodhimeve dhe shërbimeve në treg, të cilat janë:

- a) e drejta për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve,
- b) e drejta për mbrojtjen nga rreziku për jetë, shëndet dhe pasuri,
- c) e drejta e mbrojtjes juridike të konsumatorit,
- d) e drejta për informim dhe riedukim të konsumatorëve,
- e) e drejta në bashkim të konsumatorëve me qëllim të mbrojtjes së interesit të tyre, e drejta në përfaqësim dhe pjesëmarrje të përfaqësuesit të konsumatorëve në punën e organeve të cilat zgjidhin çështjet nga interesi për konsumator.

3.2. Të drejtat e konsumatorëve mundën të kufizohen në raste të jashtëzakonshme, me qëllim të mbrojtjes së interesit dhe të sigurisë së Kosovës, natyrës, rrethinës njerëzore dhe shëndetit të njerëzve, por jo në mënyrë që konsumatorët t'i sjellë në pozitë të pabarabartë.

KAPITULLI I II

SIGURIA E KONSUMATORËVE

Neni 4

4.1. Prodhuesit dhe ofruesit e shërbimeve duhet të nxjerrin-plasojnë në treg mallra dhe shërbime të sigurta.

4.2. Mallra dhe shërbime të sigurta konsiderohen ato mallra dhe shërbime, të cilat i përmbushin:

- a. Standardet vendore,
- b. Standardet Evropiane të përcaktuara në Konventat Ndërkombëtare,
- c. Kërkesat legjitime të konsumatorit në lidhje me sigurinë.

4.3. Rregullat dhe rregulloret, që kanë të bëjnë me standardet dhe kushtet e sigurisë dhe shëndetit, të cilat malli apo shërbimi duhet t'i përmbush para se të dalin në treg, do të themelohen me ligje të posaçme që trajtojnë këtë lëmi.

Neni 5

Detyrimet shtesë për prodhuesit dhe shitësit lidhur me

sigurinë e mallit si dhe masat përkatëse detyruese nga kjo fushë do të përcaktohen me ligje të veçanta që trajtojnë këtë lëmi.

Neni 6

Përgjegjësia e prodhuesit apo shitësit për dëmin e shkakuar nga malli i tij me defekt do të rregullohet nga një ligj i veçantë që trajton këtë lëmi.

KAPITULLI I III

DETYRIMET E SHITËSIT NDAJ KONSUMATORIT

Neni 7

7.1. Shitësi i mallrave dhe ofruesi i shërbimeve është i detyruar:

- a. të shes sasinë, vëllimin dhe masën e saktë të mallit dhe t'i mundësojë konsumatorit me kërkesë të tij, vërtetimin e saktësisë së mallit;
- b. të shesë mallrat apo të kryejë shërbimet në cilësinë e përshkruar dhe të paraparë me dispozita ligjore,
- c. të shesë mallrat, ofrojë shërbime me çmimet e deklaruar.

7.2. Në tregje të hapura këto rregulla përcaktohen nga organet e njëjësive të qeverisjes lokale.

7.3. I ndalohe tregtarit dhënia e shënimeve personale të konsumatorit, si dhe personit juridik ose fizik i cili vepron brenda ndërmarrjes së tregtarit (koncernit), pa lejen paraprake të theksuar dhe të shkruar të konsumatorit.

7.4. Për shërbimet e servisimit dhe mirëmbajtjes së prodhimit, vlera e të cilit është më e lartë se 50€, tregtari duhet jepë profaturë dhe urdhër pune me përshkrim të punëve, materialit dhe pjesëve të përdorura për servisim. Urdhërin e punës e nënshkruan tregtari dhe konsumatori, kurse një kopje e urdhërit për punë duhet t'i dorëzohet konsumatorit.

7.5. Në qoftë se në situatat nga paragrafi 4 i këtij neni, gjatë servisimit lajmërohet nevoja për punë plotësuese dhe ngjitje të pjesëve plotësuese (zgjerimi i urdhërit të punës), tregtari duhet që paraprakisht të merr pëlqimin me shkrim nga konsumatori në qoftë se me zgjerimin e urdhërit për punë çmimi ngritet më tepër se pesë përqind (5%)

Neni 8

Shitësi i mallrave dhe shërbimeve është i detyruar që t'i plotësojë kushtet higjeno-tekniko- sanitare në përputhje

LIGJI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE

me ligjin e posaçëm që trajton këtë lëmi.

Neni 9

- 9.1. Shitësi i mallrave apo/dhe shërbimeve duhet të sigurojë që mallrat që shet të jenë të pajisura me etiketë, e cila përmban informacione për prodhuesin dhe adresën e tij, emërtimin e mallit, sasinë, përbërjen, cilësinë, datën e prodhimit, afatin e përdorimit, mënyrën e përdorimit dhe të mirëmbajtjes, rrezikshmërinë nëse ekziston, si dhe çmimin.
- 9.2. Për mallrat ushqimore informacioni për etiketim caktohen me akte të tjera nënligjore.
- 9.3. Shitësi nuk ka të drejtë të heqë ose të ndryshojë etiketën e mallit apo informacionet e tjera lidhur me mallrat e dhëna nga prodhuesi dhe/ose furnizuesi.
- 9.4. Nëse natyra e mallit nuk e lejon etiketimin, shitësi është i detyruar të sigurojë, sipas kërkesës së konsumatorit, informacionin në përputhje me pikën 1 të këtij neni, në mënyrë tjetër apo edhe përmes paraqitjes së dokumenteve përkatëse.
- 9.5. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes të një udhëzimi administrativ, mund të përcaktojë përjashtime për disa mallra për të cilat nuk kërkohet etiketa, sipas këtij neni.

Çmimi i mallrave dhe i shërbimeve

Neni 10

- 10.1. Të gjitha mallrat e ofruara për konsumatorin duhet të kenë çmimin e shitjes.
- a. për mallrat e paketuara duhet të jepet çmimi për sasinë e paketuar dhe çmimi për njësi,
- b. për mallrat që nuk janë të paketuara dhe maten në prezencë të konsumatorit është i mjaftueshëm çmimi për njësi.
- c. në rastet kur çmimi për njësi të mallit është i njëjtë me çmimin e shitjes, është e mjaftueshme vendosja e çmimit të shitjes.
- 10.2. Konsumatorit i duhet treguar çmimi përfundimtar për të gjitha shërbimet e ofruara. Në rast se nuk është dhënë çmimi përfundimtar në momentin e lidhjes së kontratës, ofruesi i shërbimit është i detyruar të tregojë metodën e llogaritjes së tij.
- 10.3. Shitësi i mallrave apo shërbimeve është i obliguar që çmimin e mallit apo shërbimit të ofruar ta paraqes qartë, lexueshëm dhe në vend të dukshëm. Çmimi duhet të jetë gjithmonë i paraqitur në Euro.
- 10.4. Shitësi duhet të informojë konsumatorët në

mënyrë të qartë për çmimin e mallrave që shet apo shërbimeve që kryen, të vlefshme për momentin kur bëhet oferta e tyre, apo për afate të përcaktuara nga ai vet.

- 10.5. Informacioni për çmimin ose fakti që informacioni nuk është i plotë apo mungon nuk duhet të krijoj përshtypjen se:
- a. çmimi është më i ultë se ai faktik,
- b. fiksimi i çmimit varet nga rrethanat e në fakt nuk është ashtu,
- c. çmimi përfshin operacione apo shërbime, për të cilat në fakt bëhen pagesa të veçanta,
- d. çmimi ishte ose do të rritet, ulet ose nuk do të ndryshojë e kjo nuk është e vërtetë.
- 10.6. Ndalohej krijimi dhe shfrytëzimi i situatave për përfitime spekulative.
- 10.7. Ky nen nuk aplikohet për mallrat apo shërbimet e ofruara nëpërmjet ankandit si dhe për shitjen e veprave të artit.

Neni 11

- 11.1. Shitësi në asnjë mënyrë nuk mund të bëjë diskriminimin e konsumatorit e në veçanti, ai nuk mund të refuzojë shitjen e mallit apo shërbimit të ekspozuar dhe të përgaditur për të. Ai nuk mund ta lidhë shitjen e mallit dhe/apo kryerjen e shërbimit me blerjen e një malli apo shërbimi tjetër, me përjashtim të rasteve kur një kufizim i tillë përbën praktikë të detyrueshme në tregti.
- 11.2. Shitësi është i detyruar të informojë blerësin për kushtet dhe mënyrën e paraqitjes së reklamimeve për mallrat dhe/ose shërbimet me të meta, duke përfshirë vendin ku bëhet reklamimi dhe kushtet përkatëse të riparimit sipas garancisë.
- 11.3. Në qoftë se malli gjatë kohës së garancisë përkeqësohet dhe konsiderohet me defekt sipas mënyrës së paraparë me garanci, atëherë prodhuesi, shitësi apo ofruesi i shërbimeve duhet t'i përgjigjet garancisë së dhënë.

Neni 12

- 12.1. Shitësi në njësinë e tij është i detyruar:
- a. me kërkesën e konsumatorit, tregtari duhet t'ia tregoj mallin konsumatorit, nëse natyra e mallit e lejon këtë;
- 12.2. Shitësi duhet të përcaktojë mallrat e rezervuara, kohëzgjatjen si dhe arsyen e rezervimit. E njëjta gjë duhet zbatuar edhe për mallrat e shitura e të paguara, të cilat lihen në vendin ku tregtohen,

derisa të dërgohen apo të merren nga blerësi/konsumatori.

- 12.3. Shitësi duhet të informojë paraprakisht konsumatorët kur shet mallra të përdorura apo të ndryshuara si dhe mallra me të meta që nuk prekin sigurinë e tyre. Këto mallra duhet të jenë të veçuara nga mallrat e tjera dhe për ato duhet të vihet shënimi "mallra të përdorura" apo "mallra me të meta".

Neni 13

Nëse shitësi vihet në dijeni të ndonjë fakti që sugjeron se i ka shitur ndonjë konsumatori mall që paraqet rrezik, është i detyruar ta informojë atë menjëherë. Nëse nuk është e mundur që konsumatori të lajmërohet personalisht, shitësi është i detyruar të informojë konsumatorët përmes organit administrativ që kontrollon zbatimin e këtij ligji.

Faturat

Neni 14

- 14.1. Shitësi, furnizuesi apo ofruesi i shërbimeve duhet që për mallin e shitur apo shërbimin e ofruar konsumatorit t'i japë faturë të saktë, të qartë dhe të lexueshme.
- 14.2. Shitësi, furnizuesi apo ofruesi i shërbimeve duhet t'i mundësojë konsumatorit kontrollimin e saktë të shumës së llogaritur në krahasim me kualitetin dhe sasinë e mallrave të blera apo të shërbimeve të ofruara.
- 14.3. Shitësi duhet t'i përmbahet dhe të vërë në dukje kushtet e çmimeve të shitjes me pakicë.
- 14.4. Pas lëshimit të faturës nuk lejohet pagesë plotësuese për të njëjtin mall.

Shitja e mallrave me gabime

Neni 15

Nëse shitësi shet mallra që kanë mangësi apo ndonjë gabim, atëherë duhet që ato mallra fizikisht t'i ndajë prej mallrave të tjera dhe në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme, t'i vendos në vende të ndara nga mallrat pa gabime dhe për to të vërë shënimin "mallra me të meta" ose "mallra të përdorura".

Neni 16

- 16.1. Gjatë shitjes së mallit, tregtari duhet t'ia japë konsumatorit dokumentacionin e paraparë nga prodhuesi, për t'i siguruar konsumatorit informacionin e duhur për përdorim.
- 16.2. Dokumentacioni nga pika 1 e këtij neni duhet të

jetë i shkruar qartë, dukshëm dhe i lexueshëm në gjuhën zyrtare. Ligji nuk e përjashton mundësinë e përdorimit të gjuhëve të tjera dhe shenjave që janë të kuptueshme për blerësin.

Paketimi i mallit

Neni 17

- 17.1. Paketimi duhet të jetë jo i dëmshëm për shëndetin, duhet t'i përshtatet formës dhe masës së mallit dhe mos ta bëjë konsumatorin konfuz.
- 17.2. Mbështjellja në bazë të porosisë me detaje dekoruese të mallrave dhe shërbimeve e detyron ofertuesin që të qartësojë dhe të theksojë çmimin për këtë shërbim nëse ai ekziston.
- 17.3. Tregtari duhet që me kërkesë të konsumatorit ta mbajë paketimin e mallit të shitur.

Deklaracioni i mallit

Neni 18

- 18.1. Deklaracioni është i obligueshëm për çdo mall dhe duhet të përmbajë të paktën këto të dhëna:
- emrin e prodhuesit apo të importuesit të mallit,
 - emrin me të cilin shitet malli,
 - llojin dhe modelin e mallit,
 - shenjën matëse të mallit nëse është shenjë me rëndësi për indentifikimin e prodhimit,
 - datën e prodhimit dhe afatin e përdorimit,
 - emrin e firmës (adresën e plotë) të prodhuesit për mallrat e importuara dhe emrin e firmës (adresën e plotë) të importuesit dhe prejardhjen e vendit nga importohet,
 - paralajmërimin për rrezikun e mundshëm në përdorim, nëse ekziston një rrezik i tillë.
- 18.2. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes akteteve ligjore plotësuese përcakton rregullat të cilat parashohin informata shtesë për disa deklarata të mallërave të caktuara, dhe rregullat që lirojnë disa mallëra për të patur deklarata.
- 18.3. Të gjitha shënimet nga deklaracioni duhet të jenë të dukshme, të lexueshme dhe të shkruara në gjuhët zyrtare. Ligji nuk e përjashton mundësinë e përdorimit të gjuhëve tjera si dhe shenjave të kuptueshme për konsumatorin. Për të dhënat nga deklaracioni për mallrat e importuara përgjegjësinë e mban importuesi.
- 18.4. Përmbajtja më e detajzuar e deklaracionit si dhe kushtet tjera për mallrat e veçanta ose grumbuj mallrash caktohen nga Ministria për Tregti dhe

LIGJI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE

Industri në bashkëpunim me Ministritë përkatëse.

18.5. Adresa e plotë nga neni 18.1 pika (f) detyrimisht duhet të përmbajë vendin, rrugën dhe numrin e shtëpisë, numrin e telefonit, faksit, adresën elektronike nëse ato ekzistojnë.

Neni 19

19.1. Mallrat në gjendje të lirë (të shpërndarë- refuz) janë mallrat që ofrohen për shitje, e të cilat më parë nuk kanë qenë të paketuara dhe të matura në prani të konsumatorit.

19.2. Mall i paketuar paraprakisht konsiderohet shitja e mallit dhe e paketimit pa përpunimin e mëtutjeshëm për konsumatorin.

19.3. Për mallrat në gjendje të shpërndarë, të cilat plasohen në shitje, deklaracioni në paketime duhet të jetë i lexueshëm dhe i dukshëm në vendin e shitjes nëse ato mallra nuk vendosen në paketime të posaçme.

Dispozitat për mallin me lirim

Neni 20

20.1. Malli në lirim, duhet të jetë i qartë, i lexueshëm dhe i shënuar me çmimin para dhe pas lirimit.

20.2. Malli, i cili është në lirim për shkak se i skadon afati i përdorimit, duhet patjetër t'i shënohet afati i fundit i përdorimit në mënyrë të qartë, dukshme dhe lexueshme.

Neni 21

21.1. Tregtari duhet që fizikisht të bëj ndarjen e mallrave për lirim nga mallrat që nuk janë në lirim, si dhe në mënyrë të qartë dhe të lexueshme të tregojë se bëhet fjalë për mallrat në lirim duke vënë shënime si "shitje diskont", "ulje çmimi" apo "lirim".

21.2. Nëse tregtari i nxjerr mallrat me gabime ose me të meta në lirim, atëherë duhet ta njoftojë konsumatorin se ku qëndron gabimi në mallra.

Shitja e energjisë, ujit dhe shërbimeve të telekomunikimit

Neni 22

22.1. Shitja e energjisë dhe e ujit llogaritet përmes konsumit real të lexuar në aparatën matës të konsumatorit.

22.2. Mënyra e matjes dhe e llogaritjes të energjisë dhe ujit rregullohet me ligje të posaçme.

22.3. Furnizuesi detyrohet që konsumatorit t'ia

mundësojë paraprakisht njoftimin me të gjitha kushtet e konsumit të energjisë dhe ujit.

22.4. Furnizuesi duhet të paraqesë në faturë shënimet që i mundësojnë konsumatorit kontrollin e sasisë dhe vlerës për konsumin e energjisë dhe ujit.

Neni 23

Furnizuesi është i detyruar t'i përmbahet standardeve të (deklaruar) shkruara, të cilësisë dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve të energjisë dhe ujit.

Faturimi i shërbimeve të telekomunikimit

Neni 24

Ofruesi i shërbimeve të telekomunikimit duhet që për kryerjen e atyre shërbimeve t'ia dorëzojë faturën konsumatorit, e cila përmban shënime të nevojshme të shkruara për llogarinë e shumës së përgjithshme që e detyron konsumatorin, çmimin, vlerën, taksat si dhe shumën e përgjithshme të llogaritur në Euro për atë periudhë kohore.

Neni 25

Ofruesi i shërbimeve të telekomunikacionit duhet që me kërkesë të konsumatorit, veçanërisht kur bëhet fjalë për ankesën me shkrim për shumën e faturuar, t'i vërtetojë konsumatorit në formë të shkruar saktësinë e shumës së paraqitur në faturë duke mos i llogaritur shpenzime shtesë.

Publikimi i mallrave dhe shërbimeve

Neni 26

26.1. Në bazë të këtij ligji, publikimi i mallrave dhe shërbimeve nënkupton prezantimin në çfarëdo forme, të cilën dikush e shpreh përmes mediave të komunikimit me qëllim të promovimit të ndonjë prodhimi, shërbimi apo të vetë kompanisë.

26.2. Publikimi mashtrues nënkupton çdo publikim që në njëfarë mënyre, duke përfshirë këtu mënyren e paraqitjes, mashtron apo ka mundësi të mashtrtojë personat të cilëve u është drejtuar apo tek të cilët ka arritur publikimi, dhe që mund të ndikojë në sjelljet e tyre ekonomike, apo të dëmton ose që mund të dëmtojë konkurrentin.

26.3. Në përcaktimin se a është një publikim mashtrues apo jo, do të shqyrtohen të gjitha karakteristikat e tij dhe çdo informatë që përmbanë, siç janë:

a) veçoritë e mallrave dhe shërbimeve: gjendja në dispozicion, natyra, zbatimi, përmbajtja, metoda

dhe data e prodhimit të mallit apo e kryerjes së shërbimit, mundësitë e përdorimit, përshtatshmëria, sasia, specifikacioni, prejardhja gjeografike apo tregtare apo rezultatet që priten nga shfrytëzimi i tyre;

- b) çmimi apo mënyra e llogaritjes së çmimit dhe kushtet me të cilat furnizohet malli apo kryhet shërbimi;
- c) natyra, vetitë, dhe të drejtat e publikuesit, siç janë: identiteti dhe pasuria e tij, kualifikimet e tij, prona e tij mbi të drejtat industriale, komerciale, intelektuale, apo shpërblimet dhe veçoritë e tij.

26.4. Publikimi krahasues është çdo publikim që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthore veçon një konkurrues apo veçon mallrat dhe shërbimet e ofruara nga ai.

Neni 27

27.1. Publikimi mashtrues nuk është i lejuar.

27.2. Publikimi krahasues është i lejuar vetëm në ato raste kur përmbush parakushtet nga neni 28 pika 1 e këtij ligji.

Neni 28

28.1. Publikimi krahasues është i lejuar:

- a. nëse nuk është mashtrues në kuptimin paraprak të dispozitave të këtij ligji,
- b. nëse bëhet krahasimi i mallrave dhe shërbimeve me të cilat plotësohen nevojat,
- c. nëse objektivisht krahasohen vetitë (cilësitë) e mallrave dhe shërbimeve të ndryshme të cilat janë materiale, të rëndësishme, të krahasueshme dhe verifikueshme,
- d. nëse nuk krijon huti në treg përkatësisht, në mes të publikuesve dhe konkurruesve ose nuk krijohet hutia në treg, në mes të prodhuesit dhe ofruesit të shërbimit që publikon prodhimin dhe shërbimin konkurrent,
- e. nëse nuk e zhvlerëson konkurrentin në treg, aktivitetet e tij, mallrat e tij, shërbimet e tij, shenjat mbrojtëse të tij apo emrat e mbrojtur,
- f. nëse mallrat me shenjë të prejardhjes krahasohen me mallrat e të njëjtës prejardhje,
- g. nëse nuk është drejtuar në shfrytëzimin e padrejtë të shenjës me renome, emrit mbrojtës ose shenjave të tjera të konkurruesve në treg, mallit ose shërbimit të tij,
- h. nëse nuk është drejtuar në shfrytëzimin e padrejtë të shenjave të prejardhjes së mallrave ose shërbimeve konkurrencte,
- i. nëse nuk ka të bëjë për mallra dhe shërbime të cilat publikohen si imitacion i mallit dhe shërbimit me shenjë mbrojtëse ose me emrin e mbrojtur.

28.2. Nëse publikimi krahasues ka të bëjë me mallrat ose shërbimet, të cilat ofrohen në suaza të ofertës së posaçme, në shpallje patjetër dhe pa hamendje duhet të caktohet afati kohor, brenda të cilit është e vlefshme oferta e posaçme.

KAPITULLI I IV

DETYRIMET E AUTORITETEVE TË ADMINISTRATËS QENDRORE

Neni 29

Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, realizon mbrojtjen e konsumatorit duke detyruar zbatimin e këtij ligji nga ana e subjekteve prodhuese, tregtare dhe shërbyese.

Neni 30

Për zbatimin e këtij ligji në Ministri krijohet sektori për mbrojtjen e konsumatorit i cili ka këto detyra:

- a. studimin dhe paraqitjen e propozimeve për çdo çështje që ka të bëjë me mbrojtjen e konsumatorit,
- b. studimin dhe paraqitjen e propozimeve për rregullim ligjor të çështjeve që kanë të bëjnë me konsumatorët dhe zbatimin sa më rezultativ të ligjeve që për mbrojtjen e konsumatorit,
- c. studimet dhe paraqitjen e propozimeve për programet e edukimit të konsumatorit,
- d. studimin e kushteve të tregut dhe parashtrimin e propozimeve për funksionimin sa më të mirë të tij,
- e. ndjekja e zhvillimeve në sektorin e konsumit nga ana teknologjike, ekonomike dhe ligjore,
- f. bashkëpunimin dhe shkëmbimin e pikëpamjeve me shoqatat e konsumatorëve brenda dhe jashtë vendit,
- g. kontaktin me publikun e konsumatorëve me çfarëdo mënyre dhe mjete.

Neni 31

31.1. Kur kontrata ndërmjet shitësit apo furnizuesit dhe konsumatorit përmbanë kushte të padrejta për konsumatorin, kushtet e këtilla do të jenë të pavlefshme për konsumatorin. Kontrata mund ta ruaj vlerën e saj, vetëm kur është e mundshme të hiqen kushtet e padrejta.

31.2. Një kusht kontraktues që nuk është negociuar në baza individuale, do të konsiderohet si i padrejtë nëse shkakton pabarazi domethënëse në të drejtat dhe detyrimet e palëve që rrjedhin nga kontrata, e që janë në dëm të konsumatorit.

LIGJI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE

- 31.3. Një kusht do të konsiderohet gjithnjë si i negociuar në baza jo-individuele, nëse është hartuar paraprakisht, kështu që konsumatori nuk ka pasur mundësinë të ndikojë në përmbajtjen e kushtit, posaqërisht në kontekst të kontratave standarde të parapërgatitura.
- 31.4. Në rast se një shitës apo furnizues pohon se një kusht standard është negociuar në baza individuale, ai ka për detyrë që këtë pohim ta dëshmojë vetë.
- 31.5. Një listë indikative dhe e pashterrshme e kushteve që mund të konsiderohen si të padrejta, janë të parapara në Shtojcën 1 të Direktivës Evropiane 93/13/EEC mbi Kushtet e Padrejta në Kontratat e Konsumatorëve.

Programi i Kosovës për mbrojtjen e konsumatorëve

Neni 32

- 32.1. Programi i Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorëve përcakton bazën politike për mbrojtjen e konsumatorëve për pesë vite dhe kryen zgjedhjen e përgjithshme të punëve prioritare në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve.
- 32.2. Programi i Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorëve do të përgatitet nga një Këshill i cili do të emërohet nga Qeveria, dhe do të përbëhet prej anëtarëve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, organizatave për mbrojtjen e konsumatorit, Oda Ekonomike, dhe ekspertë të tjerë nga fusha e mbrojtjes së konsumatorit.
- 32.3. Programi i Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorëve do të aprovohet nga Qeveria dhe do t'i dorëzohet Kuvendit jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes së këtij ligji në fuqi.
- 32.4. Programi i Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorëve do të miratohet nga Kuvendi jo më vonë se 90 ditë pas pranimit të tij.
- 32.5. Detyrat lidhur me përcaktimin e politikave për mbrojtjen e konsumatorit, veçanërisht përcjelljen dhe evidentimin e punëve të kryera nga Programi i Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorit e udhëheq Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 33

Programi i Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorit veçanërisht përcakton:

- a. parimet dhe qëllimet e politikave të mbrojtjes së konsumatorit,

- b. detyrat që kanë prioritet me rastin e hartimit të politikave për mbrojtjen e konsumatorit,
- c. programin për shfrytëzimin e mjeteve financiare për realizimin e detyrave nga programi nacional,
- d. madhësia e kornizës së programit për shfrytëzimin e mjeteve financiare për nxitjen e zhvillimit dhe aktivitetin e shoqatave të konsumatorëve.

KREU I V

SHOQATA E KONSUMATORËVE

Neni 34

- 34.1. Shoqata e Konsumatorëve themelohet për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të konsumatorit. Ajo është organizatë e shoqërisë civile e pavarur nga prodhuesit, shitësit, furnizuesit apo ofruesit e shërbimeve.
- 34.2. Regjistrimi i Shoqatës së Konsumatorëve bëhet në përputhje me procedurat e parapara për shoqatat që kryejnë veprimtari joekonomike.
- 34.3. Veprimtaria e shoqatave të konsumatorëve rregullohet nëpërmjet statutit të tyre.
- 34.4. Përfaqësuesit e konsumatorëve që marrin pjesë në organet e administratës qëndrore për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorëve caktohen nga vetë shoqata.
- 34.5. Shoqata për Mbrojtjen e Konsumatorëve prezantohet në emër të anëtarëve të saj dhe vepron në interes të të gjithë konsumatorëve. Nëpërmjet përfaqësuesit të saj ajo jep mendime për aktet ligjore të propozuara që mund të kenë ndikim tek konsumatorët, merr pjesë në mbledhje që janë në interes për konsumatorin, ndërmjetëson në mes të organeve qëndrore dhe konsumatorëve si dhe në mes të tregtarëve dhe konsumatorëve me qëllim të mbrojtjes së interesave të këtyre të fundit.
- 34.6. Shoqata për Mbrojtjen e Konsumatorit i informon konsumatorët për të drejtat e tyre si dhe paraqet listën e tregtarëve të cilët gjatë viteve të shkuara kanë dëmtuar konsumatorët, ose qëllimisht kanë shitur mallra të rrezikshme për shëndet dhe siguri të konsumatorit.

Neni 35

Shoqatat për mbrojtjen e konsumatorit kryejnë këto punë:

- a. informojnë konsumatorin për të drejtat dhe detyrimet e tyre në treg,
- b. përcjellin përmes laboratorëve të autorizuar në

LIGJI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE

- vend e sipas nevojës edhe jashtë vendit hulumtime shtesë për mallrat e plasuara në treg,
- c. përcjellin përmes personave të autorizuar, testet krahasuese të mallrave dhe rezultatet i prezanton përmes mediave,
 - d. i ofrojnë ndihmë konsumatorit të dëmtuar kundrejt tregtarit,
 - e. mbajnë evidencën e fletëparaqitjeve të pranuara nga konsumatorët si dhe procedurat e ndërmarra për vendosjen e tyre,
 - f. iniciojnë procedurën në gjykatën kompetente duke kërkuar nga gjykata që tregtarit të caktuar ose bashkësisë së tregtarëve nga i njehti sektor, t'ju ndalojë shfrytëzimin e dispozitave kontraktuese të padrejta në kontratat standarde,
 - g. kryejnë edhe punë të tjera nga lëmia e mbrojtjes së konsumatorit.

Trajtimi i ankesave**Neni 36**

- 36.1. Për çdo të drejtë që shkelet, konsumatori ose shoqata për mbrojtjen e konsumatorit mund të ankohet pranë organeve administrative kompetente, të ngarkuara me ligj për mbrojtjen e konsumatorit.
- 36.2. Organet administrative kompetente për mbrojtjen e konsumatorit dhe shoqatat e konsumatorëve, kur konstatojnë shmangie nga dispozitat e këtij ligji, obligojnë zbatueshmërinë e ligjit për prodhuesin, shitësin, furnizuesin dhe ofruesin e shërbimeve,
- 36.3. Nëse brenda dy javësh nga njoftimi për prodhuesin, shitësin, furnizuesin dhe ofruesin e shërbimeve nuk përmbushen kërkesat, konsumatorët, organet mbrojtëse të konsumatorëve dhe shoqatave të konsumatorëve kanë të drejta të paraqesin çështjen në gjykatë.

KAPITULLI I VI**INSPEKSIONI SI ORGAN MBIKËQYRËS****Neni 37**

Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji e ushtron inspektori kompetent qëndror si dhe inspektorët tjerë komunal në pajtim me kompetencat e përcaktuara me ligj.

Neni 38

- 38.1. Inspektori ndalon përkohësisht me vendim shitjen e mallit nëse vërteton se:
 - a. tregtari e shet mallin me mangësi ose gabime, pa e ndarë mallin fizikisht nga mallrat e tjerë dhe

- pa treguar qartë, lexueshëm në mallra dhe në vendin e shitjes se bëhet fjalë për mallra me të meta dhe mangësi (neni 15);
- b. tregtari nuk i dorëzon konsumatorit dokumentacionin e duhur gjatë shitjes së mallit (neni 16.1);
- c. mallrat në lirim nuk janë treguar qartë, lexueshëm me çmimin para dhe pas lirit (neni 20 pika 1);
- d. mallrat në lirim, të cilave shumë shpejtë i skadon afati i përdorimit, nuk e kanë qartë dhe lexueshëm afatin minimal dhe të fundit të përdorimit (neni 20 pika 2);
- e. tregtari i cili fizikisht nuk e ka bërë ndarjen e mallrave në lirim nga mallrat të cilat nuk janë në lirim, dhe nuk ka theksuar qartë dhe lexueshëm se bëhet fjalë për lirim (neni 21 pika 1)

- 38.2. Ankesa ndaj vendimit sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Sanksionet administrative**Neni 39**

- 39.1. Gjjobitet me shumë prej 2.500 € deri në 10.000 € personi fizik apo juridik i cili bën publikim mashtrues sipas nenit 26 apo publikim krahasues që nuk lejohet me nenin 28.
- 39.2. Personi fizik gjjobitet me gjobë prej 250 deri 500 € për kundërvajtje.

Neni 40

- 40.1. Personi juridik-tregtari gjjobitet me gjobë prej 400 gjerë 4.000 € për kundërvajtje nëse :
 - a. të gjitha mallrat e ofruara nuk e kanë çmimin e shitjes qartë dhe lexueshëm në shitore, si dhe mostregimi i qartë i kushteve të veçanta për disa mallra në vendet e shitjes së atyre mallrave (neni 10 pika 1);
 - b. për shërbimet të cilat i ofrohen konsumatorit nuk tregon çmimin përfundimtar dhe metodën e llogaritjes (neni 10 pika 2);
 - c. çmimi i shitjes së mallrave dhe shërbimeve nuk theksohet qartë, lexueshëm dhe dukshëm në € në mënyrën e përshkruar (nenit 10 pika 3) ;
 - d. paketimi është i dëmshëm për shëndet dhe e vënë konsumatorin në huti sa i përket masës dhe madhësisë së mallit (neni 17 pika 1) ;
 - e. nuk i përmbahet paketimit për mallin e shitur (neni 17 pika 3);
 - f. nuk i përmbahet garancisë së dhënë (neni 11 pika 3);

- 40.2. Personi fizik dhe personi përgjegjës tek personi juridik gjjobitet për kundërvajtje me gjobë në shumë prej 250 € gjerë 500 €.

LIGJI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE

40.3. Inspektori kompetent në rastet kur vërteton kundërvajtjen tek personi fizik dhe juridik shqipton gjobë në shumë prej 50 gjer 100 €.

Neni 41

41.1. Personi juridik – tregtar gjobitet me gjobë në shumën prej 1.000 gjer 5.000 € për kundërvajtje nëse :

- a. shitësi nuk i jep konsumatorit faturë të shkruar qartë, lexueshëm (neni 14 pika 1),
- b. nuk i mundëson konsumatorit qasje në llogari të mallrave të blera (neni 14.pika 2),
- c. nuk i përmbahet kushteve të çmimeve të shitjes me pakicë (neni 14 pika 3),
- d. nëse lejohet faturë plotësuese për të njëjtin mall (neni 14 pika 4),
- e. nëse shitja e energjisë dhe ujit, konsumatorit nuk i llogaritet në bazë faktike të lexuar në njëhisorin e konsumatorit (neni 22 pika 1),
- f. furnizuesi paraprakisht nuk e njofton konsumatorin me të gjitha kushtet e konsumit të energjisë dhe ujit (neni 22 pika 3),

41.2. Personi fizik, person përgjegjës tek personi juridik i tregtarit dhe publikuesit gjobitet për kundërvajtje me gjobë në shumë prej 100 gjer 400 €.

Neni 42

42.1. Me gjobë në shumë prej 2.000 € gjer 10.000 € gjobitet për kundërvajtje personi juridik - tregtari nëse vë në shitje prodhimet të cilat nuk kanë deklaracion apo nëse deklaracioni nuk përmban të gjitha shënimet e përcaktuara nga neni 18 pika 1, 2 dhe 3, dhe neni 19 pika 1 dhe 3 të këtij ligji.

42.2. Personi fizik, person përgjegjës tek personi juridik ose publikuesi gjobitet për kundërvajtje me gjobë me shumë prej 400 gjer 500 €.

Neni 43

Të gjitha pagesat që rrjedhin nga aplikimi e dispozitave ndëshkuese të këtij ligji derdhën në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

KAPITULLI I VII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 44

Sipas dispozitave të përcaktuara sipas nenit 18 pika 4, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Ministritë e tjera kompetente nxjerr akte të brendshme normative në afat deri 6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi

të këtij ligji. Deri në aprovimin e dispozitave nga neni 22 pika 2 e këtij ligji zbatohen rregulla dhe standarde nga fusha me të cilën llogaritet matja reale e energjisë dhe ujit.

Neni 45

45.1. Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit, çdo rregullativë e përpiluar më parë shfuqizohet dhe zbatohen normat të cilat i parash-ton ky ligj.

45.2. Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe shpalljes nga PSSP.

19.10.2004

UNMIK/ REG/2004 / 42

LIGJI NR. 2003/22**PËR INSPEKTORATIN SANITAR
TË KOSOVËS**

Kuvendi i Kosovës,

Duke u bazuar në Rregulloren nr .2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, nenet 5.1 (ë) , 5.7, 9.1.1, 9.1.26 (a) dhe 9.3.2

Me qëllim të vënies së bazës ligjore për rregullimin, përparimin e kontrollit të kualitetit të ushqimit, zbatimin e masave për pengimin dhe eliminimin e sëmundjeve ngjitëse si dhe kontrollimin e kushteve higjiene sanitare të objekteve industriale-ushqimore, shëndetësore, tregtare-ushqimore, hoteliere, objekteve parashkollore, shkollore, objektet e kulturës, sportit, rekreacionit, të objekteve të mbajtës së higjiënës personale, objekteve publike dhe vendbanimeve publike me një qëllim “Mbrojtjen e shëndetit të popullatës së Kosovës”.

Miraton :

Ligjin për Inspektoratin Sanitar të Kosovës

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**Neni 1**

1.1. Me këtë Ligj përcaktohet: organizimi, punët, të drejtat dhe detyrat e Inspektoratit Sanitar si dhe kompetencën për emërime në funksionet dhe detyrat e Inspektoratit Sanitar.

1.2. Termat e përdorura në këtë Ligj kanë këtë domethënie:

1. HACCP –(Analisis Hazards Criticl Conrtol Point- Analiza e Rrezikut Pikës Kritike Kontrollit, HAC-CP- është sistem i ri i kontrollit të ushqimit)
2. Objektet e mbajtjes së higjiënës personale – janë sallonet e kozmetikës, floktoret, saunat etj.
3. Higjiena – disiplinë e mbrojtjes shëndetësore që ka për detyrë të mbroj shëndetin e individëve.
4. Sanitari- disiplinë mjekësore që merret më ndikimin e faktorëve të mjedisit jetësor në shëndetin e njerëzve, në të njëjtën kohë gjetjen e mënyrave të eliminimit të faktorëve negativ.
5. Objektet publike- çdo objekt që i ofron shërbimet e veta qytetarëve.
6. Objektet me rëndësi të veçantë- industritë e

mëdha ushqimore, spitalet , universiteti, burgjet etj.

7. Objektet me rëndësi lokale- objektet ushqimore, shkollore, objektet hoteliere, kulturore etj.
8. Sëmundje ngjitëse –Është gjendje e sëmurë e njeriut apo kafshës, e cila vjen si rezultat i infeksionit me mikroorganizma dhe përcjellët me shenjat tipike klinke.
9. Eks-humimi –Zhvarrosja e personave të vdekur
10. ISHPK-Instituti i Shëndetit Publik të Kosovës.

KAPITULLI I**ORGANIZIMI****Neni 2**

- 2.1. Ministria e Shëndetësisë organizon, dhe mbikëqyrë punën e Inspektoratit Sanitar të Kosovës në tërë territorin e Kosovës , si organ më i lartë i kontrollit sanitar.
- 2.2. Ky organ do të ushtroi funksionin e vet ligjor si strukturë e veçantë, në shkallë të parë (në Komunë) dhe në shkallë të dytë (në Ministrinë e Shëndetësisë)
- 2.3. Ministria e Shëndetësisë nxjerrë akte nënligjore për funksionimin e kësaj strukture.

Neni 3

- 3.1. Inspektorati Sanitar i Kosovës bën mbikëqyrjen në zbatimin e Ligjit dhe të dispozitave, me të cilat përcaktohet mbrojtja e shëndetit të popullatës.
- 3.2. Në kuadër të Inspektoratit Sanitar të Kosovës bëjnë pjesë:
 - a) Kryeinspektori Sanitar i Kosovës
 - b) Inspektorët Sanitar të Kosovës
 - c) Shefi i Inspektoratit Sanitar Komunal
 - d) Inspektorët Sanitar Komunal
 - e) Inspektorët Sanitar Kufitar.
- 3.3. Punët e inspektoratit sanitar në Komunë i kryen shefi i Inspektoratit sanitar komunal dhe inspektorët sanitar komunal. Punët në Inspektoratin Sanitar në Ministrinë e Shëndetësisë i kryen Kryeinspektori sanitar, inspektorët sanitar dhe inspektorët sanitar të kufirit.
- 3.4. Inspektorët sanitar komunal bëjnë inspektimin në kuadër të autorizimeve të veta nën mbikëqyrjen e shefit të inspektoratit sanitar komunal.
- 3.5. Shefin e inspektoratit dhe inspektorët sanitar komunal i zgjedhë organi përkatës i komunës me

LIGJI PËR INSPEKTORATIN SANITAR TË KOSOVËS

pëlqimin e Kryeshefit të Ekzekutivit të Komunës në pajtim me rregullat e Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës.

3.6. Shefi i inspektoratit sanitar komunal, për punën e inspektoratit, paraqet raport periodik dhe vjetor kryeinspektorit sanitar të Kosovës.

3.7. Kryeinspektorin Sanitar, inspektorët sanitar dhe inspektorët sanitar të kufirit në Ministrinë e Shëndetësisë i zgjedh Ministria me pëlqimin e ministrit të shëndetësisë, në pajtim me rregullat e Ligjit për Shërbimin Civil.

3.8. Inspektorët sanitar të kufirit, për punën e vet paraqesin raportin periodik dhe vjetor Kryeinspektorit Sanitar të Kosovës.

Neni 4

4.1. Kryeinspektori Sanitar i Kosovës kryen këto detyra:

- Siguron zbatimin unik të ligjeve dhe rregulloreve tjera që hyjnë në kompetencë të Inspektoratit Sanitar dhe i propozon organeve kompetente nxjerrjen apo ndryshimin e rregullave të inspektimit sanitar.
- Drejton veprimtarinë e Inspektoratit Sanitar qendror dhe mbikqyrë punën e inspektorëve sanitar komunal.
- Inicon dhe organizon mbajtjen e këshillimeve profesionale për zbatimin unik të ligjeve dhe rregulloreve dhe inicon bashkëpunimin e ndërsjelltë të inspektorëve dhe personave tjerë juridik për çështjet me interes të përbashkët.
- Përcjellë dhe koordinon punën e Inspektorëve sanitar kufitar dhe mbikëqyrë punën e Shefit të inspektorëve komunal.
- Kujdeset për përparimin e punës dhe aftësimin profesional të Inspektorëve Sanitar.
- Në raste të jashtëzakonshme, si epidemitë, fatkeqësitë natyrore etj, Kryeinspektori Sanitar i Kosovës, në bashkëpunim me organet tjera pëkatëse, merr masa konkrete për tejkalimin e situatës.
- Në rast nevojë, kërkon ndihmën e Inspektorëve Sanitar të një Rajoni për Rajonin tjetër.
- Bën promovimin dhe implementimin e sistemit HACCP-së për kontrollin e ushqimit.
- Bënë raportin vjetor për veprimtaritë e Inspektoratit Sanitar të Kosovës dhe punët tjera të caktuara nga organi kompetent.

Neni 5

5. Mbikëqyrja sanitare përfshin kontrollin e kualitetit të ushqimit, kushteve higjieno-sanitare të objekteve industriale-ushqimore, tregtare-ushqimore, shëndetësore, hoteliere, objekteve parashkollore, shkollore,

objekteve të kulturës, sportit dhe rekreacionit, të objekteve të mbajtjes së higjenës personale, objekteve publike dhe venbanimeve publike.

Neni 6

Shef i Inspektorëve Sanitar të Komunës ka këto detyra:

- Organizon punët, bashkëpunon, përkrah dhe monitoron Inspektorët Sanitar të Komunës;
- organizon mbledhjen e mostrave të ushqimit dhe të ujit të pijshëm si dhe dërgimin e tyre në institute përkatëse për analiza;
- Këshillon autoritetet relevante për projekte të reja të ujit të pijshëm që kanë ndikim në nivel të Komunës;
- Zhvillon strategjinë e menaxhimit të sanacionit dhe mbeturinave në nivel të Komunës;
- Përgatit raporte mujore dhe raporte vjetore për ushqim dhe ambientin e shëndoshë në shkallë të Komunës;
- Organizon aksione për një ushqim të shëndoshë në Komunë;
- vKryen edhe punë tjera të caktuara nga Kryeinspektori Sanitar i Kosovës.

Neni 7

Organet e Inspektoratit Sanitar të Kosovës posedojnë letërnjoftimin, me të cilin dëshmojnë autorizimin, për kryerjen e inspektimit sanitar.

Neni 8

Për Inspektor Sanitar emërohen personat që kanë përgatitje të lartë arsimore, sipas prioritetit, me edukim të veçantë në Shëndetësi Publike.

Neni 9

Mbikëqyrja sanitare nënkupton mbikëqyrjen ndaj:

- Prodhimit, përpunimit, ruajtjes, transportit, bartjes së ushqimit, pajisjeve dhe veglave,
- Zbatimit të masave për pengimin dhe eliminimin e sëmundjeve ngjitëse,
- Gjendjes shëndetësore të personave të cilët punojnë në punët me te cilat mund të rrezikojnë shëndetin e popullatës,
- Ujit, objekteve, stabilimenteve dhe aparateve për furnizim me ujë të pijshëm,
- Përmbushjes së kushteve sanitaro-teknike dhe higjienike në procesin e dhënies se lejeve ndërtime, për të gjitha objektet e përshkruara në nenin 5 të këtij Ligji,
- Marrjes së masave mbrojtëse të shëndetit të popullatës nga veprimi i dëmshëm i produkteve të duhanit, dhe i pirjes së duhanit në vendet publike.
- Objekteve dhe mjeteve të komunikacionit publik,

LIGJI PËR INSPEKTORATIN SANITAR TË KOSOVËS

- h) Eks-humimit dhe bartjen e personave të vdekur në territorin e Kosovës dhe bartjen e personave të vdekur përtej kufirit.

Neni 10

10.1. Organet e Inspektoratit Sanitar të Kosovës, për zgjedhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë veprimtarisë së tyre, bashkëpunojnë me IK-SHP-në, organet e rendit, prokurorinë, gjykatat, policinë financiare, organet e shërbimit veterinar dhe organe të tjera.

10.2. Në bashkëpunim me IKSHIP-në propozon nxjerrjen e akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me shëndetin e popullatës.

Neni 11

Për një kontrollë efektive të një shkalle të gjerë të detyrave shëndetësore e ambientale, numri i Inspektorëve Sanitar duhet të jetë në proporcion –një inspektor në çdo 15,000 – 25,000 banorë.

KAPITULLI II**KOMPETENCAT E INSPEKTORATIT SANITAR TË KOSOVËS****Neni 12**

Inspektorati Sanitar i Kosovës është organ ekzekutiv i specializuar, që kontrollon zbatimin e ligjeve e të akteve nënligjore sanitare në sektorët shtetërorë, publik e privat, veprimtaritë e ndryshme të ushtruara nga persona fizikë e juridikë, vendas e të huaj, në objektet e mëposhtme:

- Në objektet e prodhimit, të ruajtjes, magazinimit, transportimit e tregtimit të produkteve ushqimore,
- Në objektet ku ushtrohen veprimtari socialkulturore, shëndetësore, arsimore dhe kërkimore shkencore,
- Në repartet dhe strukturat e mbrojtjes dhe sigurisë, në pikat kufitare, aeroportet, doganat, si dhe në mjetet e transportit të të gjitha llojeve.

Neni 13

13.1. Organet e Inspektoratit Sanitar të Kosovës ushtrojnë kontrollin sanitar në objektet e caktuara në nenin 5 dhe 12 të këtij Ligji gjatë gjithë kohës së funksionimit të tyre.

13.2. Kur shihet e nevojshme, kontrolli sanitar ushtrohet edhe jashtë kohës së funksionimit të objektit, në bashkëpunim me Prokurorinë, organet e SHPK-së dhe organet tjera të specializuara.

Neni 14

Inspektorati Sanitar i Kosovës ka edhe këto detyra :

- bashkëpunon, përkrah dhe monitoron inspektoratin sanitar të komunës;
- bën planifikimin e mostrave të ushqimit dhe ujit të pijshëm;
- zhvillon strategjinë e menaxhimit të sanacionit dhe mbeturinave në nivel të Kosovës;
- bën promovimin dhe implementimin e HACCP;
- bënë mbikëqyrjen sanitare të: Industrive të mëdha ushqimore Qendrave spitalore, qendrave klinike universitare Burgjeve dhe objekteve tjera të rëndësisë së veçantë.

Neni 15

Inspektori sanitar komunal bënë mbikëqyrjen sanitare në kuadër të autorizimeve të veta në pajtim me nenin 5.1 të këtij ligji.

Neni 16

Inspektorati Sanitar i Kosovës jep pëlqimin sanitar për lokacionet e propozuar të objekteve të kompanive ushqimore, ujësjellësve, të objekteve spitalore, pompave të karburanteve, të objekteve dhe të stabilimenteve për lëshuarjen dhe mënjanimin e ujërave të hedhura dhe për deponimin e mbeturinave.

Neni 17

17.1. Inspektori Sanitar bën inspektimin sanitar pa paralajmërim. Mirëpo para fillimit të inspektimit është i detyruar që për kontrollin të njoftoj punëtorin përgjegjës, gjegjësisht personin fizikë, veprimtaria e të cilit i është nënshtruar kontrollit sanitar.

17.2 Në rast të mungesës së punëtorit përgjegjës, gjegjësisht personit, veprimtaria e të cilit i nënshtrohet kontrollit, Inspektori Sanitar është i obliguar që për kontrollin të njoftoj punëtorin të cilin e ka takuar në vendin e punës.

17.3. Pas kontrollit, inspektori sanitar duhet të bëjë procesverbalin, ku një kopje të procesverbalit i jepet palës, ku është bërë kontrolli sanitar .

Neni 18

Inspektorati Sanitar Komunal jep pëlqimin sanitar për lokacionet e propozuara të objekteve, të prodhimit dhe qarkullimit të artikujve ushqimore, objekteve për furnizim me ujë të pijshëm, objekteve për eliminimin dhe deponimin e mbeturinave, objektet kulturore, edukativo- arsimore, objekteve sociale, objekteve të kulturës fizike, varrezat dhe krematoriumet si dhe objekte tjera të cilat mund të rrezikojnë shëndetin e popullatës.

LIGJI PËR INSPEKTORATIN SANITAR TË KOSOVËS

Neni 19

Inspektori Sanitar i Kufirit bën mbikëqyrjen ndaj:

- a) Personave, gjësendeve dhe mjeteve qarkulluese të tyre që hyjnë këtej kufirit, me qëllim të mbrojtjes së popullatës nga sëmundjet ngjitëse,
- b) Rregullshmërisë shëndetësore të ushqimit, artikujve të konsumit të gjërë dhe lëndëve të para ushqimore që importohen,
- c) Importimit dhe eksportimit të helmeve dhe elementeve radioaktive,
- d) Bartjes së personave të vdekur prej vendeve të ndryshme këtej kufirit.

Neni 20

- 20.1 Inspektori Sanitar i urdhëron me gojë dhe me shkrim zbatimin e masave të duhura.
- 20.2. Në qoftëse masat e urdhëruara nuk zbatohen në afatin e caktuar, Inspektori Sanitar ndalon përdorimin e lokaleve dhe aparaturës deri në menjanimin e mangësive.

Neni 21

- 21.1. Në kryerjen e kontrollit sanitar, Inspektori Sanitar në kuadër të autorizimeve të inspeksionit, merr vendim për:
 - a) Menjanimin e mangësive të vërtetuara, gjegjësisht parregullsive në pajtim me ligjet dhe me dispozitat tjera me të cilat përcaktohet mbrojtja e shëndetit të popullatës,
 - b) Ndalimin e përdorimit të lokaleve të punës, gjegjësisht hapësirës, makinave dhe instalimeve për kryerjen e veprimtarisë deri në përmbushjen e kushteve të përcaktuara me dispozita,
 - c) Në vendimet me të cilat urdhërohet zbatimi i masave, caktohet afati për kryerjen e tyre.

- 21.2 Afati sipas ligjit nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë.

Neni 22

- 22.1. Organet e Inspektoriatit Sanitar të Kosovës i obligojnë të pajisen me librezë sanitare të gjithë personat që punojnë në objektet e prodhimit, të ruajtjes, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore, në ujësjellës, në institucionet parashkollore, shkollore, shëndetësore dhe në objektet e shërbimit publik, ku mund të bëhet përhapja e sëmundjeve ngjitëse.
- 22.2 Lista e profesioneve dhe kategoritë e punonjësve që pajisen me librezë sanitare, përcaktohet nga IKSHP-ja dhe miratohet nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 23

Inspektori Sanitar gjatë ushtrimit të inspektimit sanitar nëse vlerëson se me shkeljen e dispozitave dhe të masave është bërë kundërvajtje, përkatësisht delikt ekonomik ose vepër penale, ka për detyrë të paraqesë kërkesen, për fillimin e procedurës për kundërvajtje, përkatësisht fletëparaqitje për delikt ekonomik ose vepër penale, organit kompetent.

Neni 24

Në raste kur Organet e Inspektoratit Sanitar në kryerjen e punëve veprojnë kundër këtij Ligji dhe dispozitave ligjore, në të cilat përcaktohet mbrojtja e shëndetit të popullatës, i nënshtrohet përgjegjësisë ligjore.

Neni 25

Në procedurën e dhënies së lejeve ndërtimore për ndërtimin e objekteve ndërtimore, Inspektorati Sanitar Komunal jep çertifikatën mbi harmonizimin e projektit kryesor me kushtet sanitaro-teknike të ndërtimit.

Neni 26

Inspektorati Sanitar i Kosovës, në rastet urgjente, gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes sanitare mund të urdhëroj me gojë ose me shkrim Inspektorin Sanitar të Komunës, për zbatimin e masave dhe të veprimeve me qëllim të menjanimit të rrezikut të drejtëpërdrejtë për shëndetin e popullatës.

Neni 27

- 27.1. Organet e Inspektoratit Sanitar janë të autorizuar të ndërpresin ndërtimin e objekteve, të cilat nuk posedojnë pëlqimin e përcaktuar sanitar të organit kompetent të Inspektoratit Sanitar .
- 27.2. Organet e Inspektoratit Sanitar të Kosovës ndaljnë përdorimin e lokaleve afariste dhe të stabilimenteve derisa të mënjanohen të metat të cilat rrezikojnë shëndetin e popullatës dhe ambientin jetësor.

Neni 28

- 28.1. Pa pëlqimin e organit kompetent të Inspektoratit Sanitar, investitorit nuk mund t'i lëshohet leja për ndërtim ose për përdorimin e objektit të ndërtuar ose të rikonstruktuar.
- 28.2 Organi kompetent i Inspektoratit Sanitar merr pjesë në punën e komisionit për kontrollimin teknik të objekteve dhe jep mendimin për zbatimin e masave të përcaktuara sanitare - teknike dhe higjienike me projektin paraprak.

Neni 29

Organet e Inspektoratit Sanitar të Kosovës pezullojnë përkohësisht veprimtarinë e një pjese ose tërë veprimtarinë në objekt ose ta mbyllin pjesërisht a plotësisht atë, kur ai

LIGJI PËR INSPEKTORATIN SANITAR TË KOSOVËS

nuk plotëson kushtet higjiene-sanitare ose kur rrezikohet shëndeti i punonjësve dhe konsumatorëve.

Neni 30

30.1. Organet e Inspektoratit Sanitar të Kosovës përzulajnë ose ndalojnë veprimtarinë në objektet që i nënshtrohen kontrollit të tij në këto raste:

- a) Kur objektet nuk i plotësojnë kushtet sanitare në përputhje me projektin e miratuar dhe me destinimin, për të cilin ato janë ngritur;
- b) Kur përdoren substanca ose tregtohen artikuj ushqimor që nuk përputhen me normat sanitare në fuqi dhe për pasojë paraqesin rrezik për shëndetin e popullatës.

30.2. Për objektet me interes të veçantë, vendimi jepet nga Inspektorati Sanitar i Kosovës, kurse për objektet me karakter lokal, vendimi jepet nga Inspektorati Sanitar Komunal.

30.3. Vendimin për pezullimin ose për ndalimin e veprimtarisë së objektit është i formës së prerë.

30.4. Rihapja e veprimtarisë bëhet me vendimin e organeve të sipërpërmendura, kur të jenë plotësuar kushtet e përcaktuara.

KAPITULLI (III)**KUNDËRVATJET SANITARE****Neni 31**

Shkeljet e mëposhtme, përbëjnë kundërvajtje sanitare:

- a) Shkelja e rregullave të zbuluara gjatë kontrollit të ushtruar sanitar në objektet e përcaktuara në nenin 5 dhe 12 të këtij Ligji,
- b) Mosrespektimi i kushteve të prodhimit, sipas standardeve sanitare,
- c) Falsifikimet ose maskimet në teknologjinë e prodhimit,
- d) Papastërtitë personale dhe të mjeteve të punës,
- e) Tregtimi i produkteve ushqimore jashtë vendeve të lejuara,
- f) Shkeljet sanitare në mirëmbajtjen e ujësjellësit,
- g) Mungesa e klorizimit në sistemin e ujit të pijshëm,
- h) Grumbullimi dhe depozitimi i plehrave në vende që mund të bëhen shkak ose burim i shfaqjes së përhapjes së sëmundjeve ngjitëse,
- i) Hedhja e mbeturinave dhe kafshëve të ngordhura në vende të hapura, jashtë vendeve të lejuara ose të destinuara,

- j) Përdorimi i papërpunuara i ujërave të zeza për ujitjen e prodhimeve bujqësore të konsumit.
- k) Pranimi në institucionet parashkollore i personave të sëmurë ose të dyshimtë për sëmundje ngjitëse,
- l) Mosmarrja e miratimit prej organeve të Inspektoratit Sanitar të Kosovës për ndërtimin dhe funksionimin e objektit,
- m) Moszbatimi i pjesshëm ose i plotë i detyrave e vendimeve që merren nga organet e Inspektoratit Sanitar të Kosovës,
- n) Mospajjsja me librezë sanitare në afatet e caktuara,
- o) Konstatimi i mosmbajtjes së higjenes dhe prezenca e brejtësve brenda dhe jashtë mjediseve të të gjitha objekteve të përcaktuara në nenin 5 dhe 12 të këtij Ligji,
- p) Pengimi, kërcënimimi në ushtrimin e detyrës së Inspektorëve Sanitar.

Neni 32

32.1. Për kundërvajtje administrative sanitare të parashikuar në bazë të Ligjit, shqiptohen dënime me gjobë nga organet e Inspektoratit Sanitar të Kosovës, si vijon:

- a) Për shkeljet e parashikuara në Nenin 31, paragrafi 31.1 në pikat, a), b), f), g), m), n), masa e gjobës është prej 1.000 – 1.500 € për persona fizik, për persona juridik 2.000 – 5.000 €, ndërsa për personat përgjegjës 1.000 – 1.500 €.
- b) Për shkeljet e parashikuara në Nenin 31, paragrafi 31.1 në pikën c) masa e gjobës është prej 5.000-10.000 € për personat fizik, për persona juridik prej 30.000 – 35.000 €, ndërsa për personat përgjegjës 1.000 – 1.500 €.
- c) Për shkeljet e parashikuara në Nenin 31, paragrafi 31.1 në pika h) masa e gjobës është prej 2.000 – 5.000 € për personat fizik, për persona juridik prej 5.000 – 10.000 €, ndërsa për personat përgjegjës 1.000 – 1.500 €.
- d) Për shkeljet e parashikuara në Nenin 31, paragrafi 31.1 në pikat i), j), k), l), masa e gjobës është prej 2000 – 5.000 € për personat fizik, për persona juridik prej 5.000 – 10.000 €, ndërsa për personat përgjegjës 1.000 – 1.500 €.
- e) Për shkeljet e parashikuara në Nenin 31, paragrafi 31.1 në pikat, d), e), masa e gjobës është prej 3.000 – 5.000 € për persona fizik, për persona juridik 5.000-10.000€, ndërsa për personat përgjegjës 1.000 – 1.500 €.
- f) Për shkeljet e parashikuara në Nenin 31, paragrafi 31.1 në pikën o), masa e gjobës është 5.000-10.000 € për persona juridik 10.000-15.000€,ndërsa për personat përgjegjës 1.000 - 1.500 €.
- g) Për shkeljet e parashikuara në Nenin 31, para-

LIGJI PËR INSPEKTORATIN SANITAR TË KOSOVËS

grafi 31.1 në pika p) masa e gjobës është prej 10.000 – 15.000 € për personat fizik, për persona juridik prej 20.000 – 35.000 €, ndërsa për personat përgjegjës 3.000 – 5.000 €.

32.2 Mjetet financiare të arkëtuara nga gjambat, derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 33

Dënimet mandatare përcaktohen me rregullore të posaçme nga ana e Inspektoriatit Sanitar të Kosovës.

Neni 34

34.1. Ekzekutimi i vendimit të denimit me gjobë bëhet brenda një muaji (30 dite) nga data kur vendimi merr formë të prerë.

34.2. Në rastet kur gjoba nuk paguhet brenda kohës së caktuar për çdo ditë vonesë, masa e gjobës rritet me 3% të vlerës deri në 30 ditë.

34.3. Pas kalimit të këtij afati seksioni përkatës i financës bën ekzekutimin e detyrueshëm të denimit me gjobë sipas Ligjit.

Neni 35

Në rastet kur personat juridik apo fizik, vendas ose të huaj, përsërisin të njejtat shkelje sanitare më shumë se dy herë brenda 1 viti, organet e Inspektoratit Sanitar të Kosovës vendosin pezullimin ose mbylljen e përkohshme, apo të përhershme të objektit, ose të veprimtarisë së personit juridik a fizik.

Neni 36

36.1 Kundër vendimit të shkallës së parë, ankesa i parashtrohet Inspektoriatit Sanitar të Kosovës.

36.2. Ankesa kundër vendimit të shkallës së parë, parashtrohet brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

36.3. Ankesa nuk e shtyn afatin e zbatimit të masave dhe veprimeve të urdhëruara në rastet kur ekziston rreziku i drejtëpërdrejtë për shëndetin ose jetën e popullatës ose ambientin jetësor.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 37

Për implementimin e këtij Ligji është përgjegjës Ministria e Shëndetësisë.

Neni 38

Ligjet e zbatueshme

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji pushojnë së aplikuari të

gjitha dispozitat ligjore të cilat kanë qenë në fuqi lidhur me sferën e Inspektoratit Sanitar të Kosovës.

Neni 39

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe në datën e shpalljes së tij nga PSSP-ja.

17.12.2003

UNMIK/ REG/2003/39

LIGJI NR. 2004 / 6**PËR TRANSPORTIN E
MALLRAVE TË RREZIKSHME**

Kuvendi i Kosovës

Duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/9 të 15 majit mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, veçanërisht në nenet 5.1 (h), 5.7, 9.1.26 (a)

Me qëllim të sigurimit të komunikacionit gjatë transportit të mallrave të rrezikshme në sektorin individual të transportit, obligimet e personave të përfshirë gjatë transportit në fjalë, kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve përkatëse rreth mbikëqyrjes lidhur me zbatimin e këtij ligji dhe adaptimit të standardeve ndërkombëtare, duke përfshirë përafrimin me standardet Europiane të cilat janë të rëndësishme për parandalimin e rrezikut gjatë transportit të mallrave të rrezikshme.

Aprovon:

**LIGJIN PËR TRANSPORTIN E
MALLRAVE TË RREZIKSHME****Dispozita të Përgjithshme****Neni 1**

Nëpërmes këtij ligji synohet të parandalohet rreziku dhe të shtohet mbikëqyrja dhe siguri i komunikacionit gjatë transportit të mallrave të rrezikshme të cilat me vetitë vetëndezëse, helmuese, shpërthyes, avulluese infektuese dhe radioaktive paraqesin rrezik për sigurinë e njerëzve dhe të mjedisit, rregullon kushtet për transportin e mallrave të rrezikshme në sektorin individual të transportit, obligimet e personave të përfshirë në Transportin e Mallrave të Rrezikshme, kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve përkatëse rreth mbikëqyrjes lidhur me zbatimin e këtij ligji.

Përkufizimet**Neni 2**

Mallrat e Rrezikshme sipas këtij ligji janë substancat

dhe objektet, të cilët rrezikojnë sigurinë publike ose rendin publik, posaçërisht publikun, jetën dhe shëndetin e njerëzve si edhe të kafshëve, bimëve, dhe objekteve në sajë të natyrës së tyre, karakteristikave ose kushteve të tyre gjatë transportimit, bartja e të cilave është e ndaluar nga ADR, ose lejohen të transportohen në kushte të posaçme.

Ministria nënkupton Ministrinë e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit.

Personi nënkupton personin juridik dhe fizik.

Personi për sigurimin e transportit nënkupton personin e punësuar me kualifikim përkatës.

Transporti sipas këtij ligji nuk përbën vetëm procedurat e ndërrimit të vendit, por gjithashtu edhe marrjen në posedim të mallrave si edhe dërgimin e mallrave, duke përfshirë qëndrimet e përkohshme gjatë transportit, përgaditjen dhe finalizimin (paketimin dhe shpaketimin e mallrave, ngarkimin dhe shkarkimin) edhe në rastin kur këto aktivitete nuk janë bërë nga dërguesi.

Kontenjeri është mjeti i caktuar, i cili shërben për vendosjen, shtrëngimin dhe mbrojtjen e mallrave të ngarkuara në të.

Kazani është ena e cila mban një masë jo më të vogël se 150 litra e as më të madhe se 1000 litra.

Çisterne është mjeti i vendosur në platformën e mjetit transportues (kazanat, fuçitë) për transportin e materieve në gjendje të lëngët ose me gazra të komprimuar.

Licenca është e drejta për të kryer veprimtari të rregullt transporti të mallrave të rrezikshme.

Transport do të thotë ndërrimi i vendit të mallrave të rrezikshme duke përfshirë ndalesat që bëhen në varësi të kushteve të transportit, duke përfshirë çfarëdo lloj periudhe të kaluar të mallrave të rrezikshme në automjet, cisternë dhe kontenjer, të cilat varen nga kushtet në komunikacion, gjatë dhe pas ndërrimit të vendit.

Transportues- është ndërmarrja, e cila merret me aktivitete transportuese.

Operator i transportit është personi juridik a fizik, i cili ushtron veprimtarinë e transportit publik të mallrave të rrezikshme.

Dërguesi i mallit është ndërmarrja, e cila bën dërgimin e mallrave të rrezikshme, qoftë në emër të saj ose për palët e treta, nëse transporti bëhet sipas kontratës për bartje. Dërguesi i mallit do të thotë dërguesi sipas kontratës për bartje.

LIGJI PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME

Ngarkuesi është çfarëdo ndërmarrje, e cila bënë ngarkimin e materieve të rrezikshme në automjet ose kontejner.

Paketim do të thotë paketimi komplet i një produkti, i cili është i gatshëm për bartje; ky term nuk ka të bëjë me substancat që barten në cisternë.

Etiketimi apo Shenjëzimi do të thotë etiketat, të cilat vendosen në mjete transportuse për definimin e materies së rrezikshme si dhe rrezikshmërinë e materies.

Organet e autorizuara janë organi apo çfarëdo organe të tjera të përcaktuara si të tilla në secilin vend dhe në çdo rast specifik, në pajtim me ligjin vendor.

ADR është marrëveshja europiane për transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë tokësore.

RID është marrëveshja europiane për transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë hekurudhore.

COTIF është Konventa e Transportit Hekurudhor Ndërkombëtar.

Marrësi i Mallrave- Në pajtim me kontratën për bartje nëse marrësi i dërgesës e cakton një palë të tretë në dispozitat e aplikueshme në kontratën për bartje, ky person duhet të jetë bartës sipas kuptimit ADR-së.

Objekti i ligjit

Neni 3

Objekt i këtij ligji është Transporti i Mallrave të Rrezikshme në rrugë tokësore (konform rregullave të ADR-it) dhe hekurudhore (COTIF dhe RID)

Përjashtimi nga zbatimi

Neni 4

Ky Ligj nuk zbatohet për transportin brendapërbrenda një uzine ekzistuese, në të cilën Mallrat e Rrezikshme prodhohen, trajtohen, procesohen, ruhen apo sistemohen, ndërkohë që transportohen brenda një hapsire të mbyllur.

Standardet ndërkombëtare

Neni 5

Ligji bazohet në direktivat e komunitetit europian dhe të mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë për sigurinë dhe transportin e mallrave të rrezikshme (ADR-së, RID-it, COTIF-it) Direktivat në fjalë Ministria do ti përcaktojë dhe zbatojë nëpërmes udhëzime administrative dhe shpalljet e tjera.

Ndalimi

Neni 6

Asnjë person nuk mund të merret me transportin e mallrave të rrezikshme pa licencën e lëshuar nga Ministria.

Klasifikimi dhe Emërtimi

Neni 7

Ministria përcakton në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse klasifikimin dhe emërtimin e mallrave të rrezikshme, të cilat janë të paspecifikuara me rregullat e ADR-it)

Marrëveshjet ndërkombëtare

Neni 8

Transporti i mallrave të rrezikshme nga, në ose nëpër Kosovë, i kryer nga subjektet e huaja ose subjektet vendore, kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe udhëzimeve administrative dhe shpalljet e tjera të cilat rrjedhin prej tij, për aq sa ato nuk bien ndesh me marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga personat kompetentë të Kosovës në koordinim me UNMIK-un.

Transportimi i Mallrave të Rrezikshme me mjete që nuk i përmbushin kushtet

Neni 9

Lejohet transportimi i mallrave të rrezikshme me mjete që nuk i përmbushin kushtet e nenit 8 në ato raste kur natyra e mallrave që transportohen garanton ruajtjen dhe transportimin e tyre me enë, ambalazhe e kontejner që janë të garantuar nga çertifikata përkatëse e lëshuar nga prodhuesi i mallit.

Marrëveshja ndërmjet dërguesit e transportuesit

Neni 10

Ndërmjet dërguesit dhe transportuesit lidhet marrëveshja për transportin e Mallrave të Rrezikshme, ku përcaktohen detyrimet e ndërsjella dhe përgjegjësitë që burojnë nga zbatimi i saj.

Dokumentacioni i nevojshëm

Neni 11

11.2. Transporti quhet i kryer me konfirmimin me shkrim të marrjes në dorëzim të mallit nga pranuesi, e

LIGJI PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME

përcaktuar me marrëveshje nga dërguesi dhe një kopje mbahet nga transportuesi.

- 11.3. Afati i ruajtjes së dokumenteve të transportit të mallrave të rrezikshme nga të gjitha subjektet që kanë lidhje me të është 10 vjet.

Ndalimi i transportimit me mjete të pastandardizuara.

Neni 12

Nuk lejohet transportimi i mallrave të rrezikshme me mjete të pastandardizuara.

Kërkesa për marrjen e licencës

Neni 13

- 13.1. Për marrjen e licencës për transportin e mallrave të rrezikshme operatori ia bën kërkesën Ministrisë.
- 13.2. Ministria brenda një afati jo më të gjatë se 30 ditë do të njoftojë pretenduesin në fjalë nëse kërkesa e tij aprovet apo refuzohet.
- 13.3. Kur operatorit i refuzohet kërkesa për marrjen e licencës ai njoftohet me shkrim për këtë.
- 13.4. Zbatohet procedura e ankimit e përcaktuar në nenin 29 të këtij ligji.

Lëshimi i licencës

Neni 14

- 14.1. Operatorit të transportit të mallrave të rrezikshme i lëshohet licenca kur i përmbush kushtet e parashikuara me këtë Ligj.
- 14.2. Operatorit të Transportit të Mallrave të Rrezikshme i revokohet licenca kur personat e autorizuar vërtetojnë se operatori i transportit nuk ka përmbushur apo i ka humbur kushtet e parashikuara për marrjen e licencës.
- 14.3. Licencat jepen për kohë të caktuar dhe në përputhje me kushtet kufizuese të ngarkesës, shpejtësisë, rrugëve të kalimit dhe shoqërimit të ngarkesës.
- 14.4. Licencën e lëshon Ministria.
- 14.5. Licenca nuk tjetërsohet dhe nuk transferohet.

Kriteret për realizimin e të drejtës së licencës

Neni 15

- 15.1. Kriterët për marrjen e licencës janë:

- a) Kompetenca profesionale;
- b) Reputacioni i mirë;
- c) Besueshmëria financiare;
- d) Përmbushja e standardeve teknike.

- 15.2. Rregullat e detajuara për subjektin që kërkon të marrë licencën për transportin e mallrave të rrezikshme nxirren nga Ministria me akte të veçanta juridike.

Obligimet e personit të licencuar

Neni 16

- 16.1. Çdo person i licencuar duhet të përgadisë raporte vjetore mbi veprimtarinë në lëminë e transportimit të mallrave të rrezikshme dhe masat e ndërmara për sigurinë e transportit. Këto raporte i dorëzohen organeve kompetente sipas kërkesës dhe duhen të ruhen për më së paku pesë vite.
- 16.2. Çdo person i licencuar për transportin e mallrave të rrezikshme e punëson një person i cili bën sigurimin e transportit.

Detyrat e personit për sigurimin e transportit

Neni 17

- 17.1. Personi për sigurimin e transportit nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e punëdhënësit përkujdeset për ndërmarrjen e masave të nevojshme për sigurimin e transportit të sigurtë të mallrave të rrezikshme. Detyrat e tij përqëndrohen në mbikëqyrjen e sigurisë së transportit dhe zbatimin e normave të përcaktuara me akte ligjore duke përfshirë edhe këshillimin e ndërmarrësve mbi transportin e mallrave të rrezikshme konform standardeve të përcaktuara me ligj dhe akteve të tjera ligjore si dhe vlerësimin e rrezikshmërisë së mallrave për transport, duke përfshirë edhe këshillimin mbi masat e nevojshme për sigurinë e transportit dhe ngarkimshkarkimit të mallrave të rrezikshme. Përveç këtyre detyrave, ky person është i detyruar të përgadisë raporte të detajuara për aksidentet e ndryshme.
- 17.2. Detyrat e këtij punëtori mund të kryhen edhe nga udhëheqësi i ndërmarrjes ose një person tjetër i ngarkuar me punë tjera në ndërmarrje, përderisa këta persona janë në gjendje dhe posedojnë aftësi profesionale të kryejnë detyra të tilla.
- 17.3. Personi për sigurimin e transportit duhet të ketë përgatitje adekuate profesionale për kryerjen e këtyre detyrave. Përgatitja e duhur profesionale caktohet përmes organit kompetent, i cili organizon kurse për aftësim profesional. Për këtë qëllim organi kompetent lëshon certifikata.

LIGJI PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME

17.4. Transportuesi e njofton organin kompetent për punësimin e këtij punëtori.

Revokimi dhe pezullimi i licencës

Neni 18

18.1. Revokimin apo pezullimin e licencës e bënë Ministria sipas përcaktimeve në nenin 15.1 dhe 15.2.

18.2. Revokimi dhe pezullimi i licencës mund të bëhet edhe me kërkesën e personit që e ka marrë atë.

Përfundimi nga marrja e licencës

Neni 19

Autoritetet e KFOR-it, TMK-së, Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-së përfundohen nga licenca kur merren me transportin e mallrave të rrezikshme gjatë përfundimit të tyre.

Autorizimet

Neni 20

20.1. Ministria është e autorizuar nëpërmes akteve të veçanta juridike të nxjerrë rregulla mbi transportin e mallrave të rrezikshme duke përfshirë:

- a) lejimin e mallrave për transport;
- b) paketimin, paketimin e përbashkët, ngarkimin e përbashkët;
- c) etiketimin e ngarkesave;
- d) ndërtimin, natyrën, pajisjen, kontrollin dhe shenjzimin e automjeteve dhe kontejnerëve të transportit;
- e) sjelljen gjatë transportimit;
- f) licencën e transportit dhe dokumentet e transportit;
- g) informatat-detyrimet e regjistrimit dhe raportimit;
- h) puna e automjeteve;
- i) kualifikimet;
- j) masa dhe mënyra e kontrollit të veprimit;
- k) mënyra mbrojtëse e veprimit për personelin e transportit;
- l) sjellja, mbrojtja dhe mënyra e ndihmës së parë të veprimit pas aksidenteve me mallra të rrezikshme;
- m) obligimet e pjesëmarrësve përsa i përket sigurisë në transportin e mallrave të rrezikshme;
- n) personeli i transportit, përfshirë monitorimin dhe ekzaminimin mjekësorë të tyre, nevoja për trajnim, testim dhe edukim të mëtejshëm si edhe përcaktimin e standardeve të cilësive të personelit të trajnimit dhe të instruktorëve;
- o) këshilltarët për siguri në një kompani për transportin e mallrave të rrezikshme, përfshirë trajnimin, testimin dhe edukimin e tyre të mëtejshëm

si edhe përcaktimin e standardeve të cilësive të personelit të trajnimit dhe të instruktorëve;

- p) dokumentacioni dhe obligimin për të raportuar për mbeturinat e rrezikshme;
- q) transportimi i mallrave të rrezikshme me rrugë hekurudhore sipas RID-it.
- r) bartja në rrugë postare e materialeve shpërthyes, të ndezshme, dhe të rrezikshme.

20.2. Nga rregullat e nxjerra konform neni 3 përjashtime mund bëhen për KFOR-in, TMK, Policinë e UNMIK-ut, SHPK-ne dhe Zjarrëfiksit përderisa kjo mendohet se është e nevojshme për çështjet që kanë të bëjnë me subjektet në fjalë.

Edukimi

Neni 21

21.1. Ministria do të angazhohet që të gjejë mundësi dhe forma për avancimin e edukimit, testimin dhe edukimin e mëtejshëm të personave që merren me transportin e mallrave të rrezikshme, nëpërmjet programeve trajnuese.

21.2. Ministria organizon kurse dhe provime profesionale për aftësimin e kandidatëve me qëllim të fitimit të njohurive mbi mallrat e rrezikshme, evitimit të rreziqeve të lidhura me transportin e mallrave të rrezikshme si dhe mbi normat ligjore ekzistuese për rregullimin e transportit të mallrave të rrezikshme.

21.3. Kurset përbëhen prej dy komponenteve kryesore: Masat e përgjithshme për mbrojtjen ndaj rreziqeve si dhe trajnimin për normat vendore, europiane dhe ndërkombëtare në lëminë e transportit të mallrave të rrezikshme.

Masat urgjente

Neni 22

22.1. Ministria mund të ndalojë ose lejoj sipas kufizimeve të caktuara transportin e mallrave të rrezikshme, nëse udhëzimet administrative dhe shpalljet e tjera ekzekutive për sigurinë nuk janë të përshtatshme që të zvogëlojnë rreziqet e transportit.

22.2. Masat e këtij lloji merren me anë të akteve të veçanta juridike.

Masat e sigurisë/ refuzimi i transportit të mallrave të rrezikshme

Neni 23

23.1. Nëse një person që transporton mallra të rrezik-

LIGJI PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME

shme vepron në kundërshtim me legjislacionin për transportin e mallrave të rrezikshme, ose nuk mund të tregoj dokumentacionin e nevojshëm, autoritetet kompetente mund të marrin masa që të eliminojnë të metën, nëse është e nevojshme, mund të ndalojnë transportin e filluar derisa kushtet për transportin të përmbushen.

- 23.2. Neni 6. aplikohet edhe për ngarkesën (barrën) e transportit të mallrave të rrezikshme.

Kontrolli**Neni 24**

- 24.1. Transporti i mallrave të rrezikshme kontrollohet nga organet e autorizuar.
- 24.2. Personat përgjegjës për transportin e mallrave të rrezikshme janë të detyruar që t'i japin dokumentacionin dhe informata autoriteteve kompetente të kontrollit.
- 24.3. Detyrimi ekziston edhe ndaj kërkesës për raportin e analizave laboratorike dhe testimit të substancave dhe mallrave të rrezikshme, mostrave të paketimit në mënyrë që të mundësohet hulumtimi zyrtar(hetimi)
- 24.4. Personi i detyruar për dhënien e informacionit duhet të ndihmoj autoritetin kompetent të kontrollit për kryerjen e hetimeve të tyre.

Përgjegjësia**Neni 25**

Përgjegjës për transportin e mallrave të rrezikshme është operatori, ose pronari i kompanisë, i cili:

- paketon, ngarkon, dërgon, transporton, shkarikon, bën pranimin e mallrave të rrezikshme;
- prodhon materiale për paketim, kontenjerë ose automjete për transportin e mallrave të rrezikshme.

Ndihma Zyrtare dhe Sigurimi i të Dhënave**Neni 26**

- 26.1. Transmetimi i të dhënave personale në rastin e dhënies së ndihmës zyrtare autoritetit kompetent të shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian (BE), apo shteteve të tjera që Kosova ka marrëveshje bilaterale në mënyrë që të kontrollojnë transportimin e mallrave të rrezikshme, lejohet vetëm nëse kjo është thelbësore për ndjekjen e shkeljeve serioze të rregulloreve mbi transportin e mallrave të

rrezikshme (ADR)

- 26.2. Shkeljet serioze të kompanisë që gjendet në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian apo shteteve të tjera duhet t'iu njoftohen autoriteteve përkatëse të shtetit përgjegjës. Në të njëjtën kohë këtyre autoriteteve kompetente duhet t'iu kërkohej që të ndërmarrin veprime në lidhje me kompaninë.
- 26.3. Shkeljet serioze me automjetin që është i regjistruar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, apo në një shtet tjetër në bazë të një marrëveshjeje reciproke duhet t'iu njoftohen autoriteteve kompetente të shteteve përkatëse.
- 26.4. Në të njëjtën kohë këtyre autoriteteve të shteteve me kompetence përkatëse mund t'iu kërkohej që të ndërmarrin veprime të caktuara në lidhje me kompaninë.

Bashkëpunimi me Ministrinë e tjera**Neni 27**

Për çështjen e transportit të mallrave të rrezikshme Ministria bashkëpunon me: Ministrin e Shëndetësisë, Ministrinë e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Shërbimeve Publike, Ministrinë e Financave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe me të gjitha entitetet që merren me transportin e mallrave të rrezikshme.

Gjobat**Neni 28**

- 28.1. Shkelja e këtij ligji do të shkaktojë aplikimin e dispozitave ndëshkimore, për personat juridik dhe fizik.
- 28.2. Shkeljet mund të bëhen me paramendim dhe nga pakujdesia.
- 28.3. Personi juridik, i cili është përgjegjës për shkeljen e akteve ligjore dhe nënligjore do të dënohet me gjobë jo më të vogël se 500 Euro dhe jo më të madhe se 5000 Euro.
- 28.4. Personi fizik, i cili është përgjegjës për shkeljen e akteve ligjore dhe nënligjore do të dënohet me gjobë jo më të vogël se 300 Euro dhe jo më të madhe se 3000 Euro.
- 28.5. Të gjitha pagesat që rrjedhin nga aplikimi i dispozitave të këtij ligji derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

LIGJI PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME

Ankesat

Neni 29

- 29.1. Kundër vendimit të personave kompetentë të Ministrisë, personi juridik dhe fizik mund të bëjë ankese në Ministri brenda afatit 8 ditor .
- 29.2. Ministria vendos në lidhje me ankesën brenda afatit 30 ditor.
- 29.3. Kundër vendimit të Ministrisë në lidhje me ankesën, personi juridik apo fizik mund të fillojë procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente.

Zbatimi

Neni 30

Ministria nxjerr udhëzimet administrative dhe shpalljet e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e këtij Ligji.

Hyrja në fuqi

Neni 31

Ky Ligj hyn në fuqi pasi që të miratohet nga Kuvendi, në ditën kur shpallet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

05.06.2004
UNMIK/REG/ 2004 / 17

LIGJI NR. 2004 / 13**PËR MATERIALIN FIDANOR**

Kuvendi i Kosovës

Duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, neni 9.1.26 (a) dhe 5.1 (j)

Me qëllim të rregullimit të prodhimit dhe tregimit të materialit fidanor të varieteteve bujqësore, duke përfshirë edhe varietetet hibride të fidaneve pyjore në Kosovë.

Aprovon:

LIGJIN PËR MATERIALIN FIDANOR**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1**

Ky Ligj rregullon çështjet që kanë të bëjnë me prodhimin, tregtimin, importin, eksportin, kontrollin si dhe regjistrimin e prodhuesve dhe tregtuesve të materialit fidanor.

DEFINICIONET**Neni 2**

Shprehjet e përdorura në Ligj kanë këto domethënie:

“**Varietet**” nënkupton grupacionin e bimës brenda një klasifikimi të veçantë botanik të një niveli më të ulët, grupet e të cilave pa marrë parasysh kushtet e rritjes mund të:

- definohehen nga shprehja e karakteristikave që rrjedhin nga një gjenotip ose nga një kombinim gjenotipesh,
- dallohen nga çfarëdo grupacioni tjetër bimor me anë të shprehjesh të së paku një tipari të thënë më parë dhe,
- konsiderohen si njësi përsa i përket përshtatshmërisë së vet për t'u shumuar të pandryshueshme.

“**Materiali Fidanor**” nënkupton bimët e tëra, pjesët e bimëve, filizat, rrënjët, nënshartesat dhe gjithë materialin shumues dhe fidanin e gatshëm e që përdoren:

- për prodhimin e perimeve, përveç për farëra,

- për prodhimin e pemëve,
- për prodhimin e bimëve, shkurreve dhe drunjëve zbukurues,
- për prodhimin e hardhisë,
- për prodhimin e drunjëve pyjorë,

“**Ministria**” është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

“**Ministër**” është Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)

“**Inspektor**” është personi i autorizuar nga Ministria për inspektimin e materialit fidanor sipas këtij ligji.

“**Departamenti**” është Autoriteti Zyrtar i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përgjegjës për zbatimin e Ligjit.

“**Person**” është çdo person fizik apo juridik.

“**Eksporti**” është qarkullimi i materialit fidanor jashtë Kosovës.

“**Importi**” është futja e materialit fidanor në Kosovë.

“**Etiketa**” është përmbajtja e shkruar grafike që përmban të dhënat për materialin fidanor.

“**Tregtues**” është çdo person i regjistruar për plasim në treg të materialit fidanor.

“**Regjistrim**” është akti i aprovimit nga Autoriteti kompetent për t'u marrë me materialin fidanor.

“**Autoriteti licencues**” është Autoriteti i cili bënë licencimin e personave që merren me materialin fidanor.

REGJISTRIMI I PRODHUESVE DHE TREGTUESVE TË MATERIALIT FIDANOR**Neni 3**

3.1. Të gjithë prodhuesit, importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor duhet të regjistrohen në regjistrin zyrtar të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

3.2. Ministria do t'i mbajë të dhënat vijuese të çdo personi që bënë kërkesë për regjistrim:

- a) emrin e personit,
- b) adresën e personit me të cilin ka të bëjë kërkesa,
- c) numrin unik të regjistrimit në regjistrin zyrtar të Ministrisë.

LIGJI PËR MATERIALIN FIDANOR

3.3. Kërkesa që do të regjistrohet në regjistrin zyrtar duhet të plotësohet nga:

- a) kërkuksi që merret ose dëshiron të merret me shumim, rritje, tregtim ose me çfarëdo aktiviteti tjetër që ka të bëjë me materialin fidanor,
- b) kërkuksi që ka për qëllim importin apo eksportin e materialit fidanor.

3.4. Kërkesa duhet të plotësohet me shkrim, në formën e përcaktuar me Udhëzim Administrativ.

3.5. Ministria mund të refuzojë regjistrimin e kërkuksit nëse konstaton se nuk janë plotësuar kriteret sipas Udhëzimit Administrativ.

3.6. Në vendimin për refuzimin e regjistrimit pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqes ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të vendimit. Ankesa i dërgohet Ministrisë.

3.7. Prodhuesit të cilët prodhimin e materialit fidanor e bëjnë për përdorim vetanak nuk janë të obliguar të regjistrohen në regjistrin zyrtar të Ministrisë.

KATEGORITË E MATERIALIT FIDANOR**Neni 4**

4.1. Kategoritë e materialit fidanor për bimët frutore dhe hardhinë janë:

- a) materiali fidanorë para-bazë, i prodhuar nën përgjegjësinë e mirëmbajtësit dhe që përdoret për prodhim të materialit bazë fidanor, duhet të jetë i painfektuar nga sëmundjet, dëmtuesit, mykoplazmat dhe virozat dhe i nënshtrohet inspektimit zyrtar.
- b) materiali fidanorë bazë, i prodhuar prej materialit para-bazë qoftë në mënyrë direkte apo në një proces të njohur të fazave në mënyrë vegjetative nga materiali para-bazë, e që ka për qëllim prodhimin e materialit fidanor të çertifikuar. Ky material i nënshtrohet inspektimit zyrtar, është i painfektuar nga virozat dhe duhet të etiketohet me etiketë të bardhë.
- c) materiali fidanor i çertifikuar, i prodhuar nga materiali bazë qoftë në mënyrë direkte apo në një proces të njohur të fazave në mënyrë vegjetative nga materiali bazë, i cili i plotëson kushtet për material të çertifikuar mund të përdoret si material për shumim. Materiali fidanor i çertifikuar mundet gjithashtu të përdoret edhe për prodhimin e fidaneve dhe pjesëve që shërbejnë për prodhimin e materialit fidanor standard. Materiali fidanor i çertifikuar është i painfektuar nga virozat dhe duhet të etiketohet me etiketë të kaltër.
- d) materiali fidanor standard nënkupton materialin

për shumim me prejardhje nga trungu ose bimët e çertifikuara prindore, të cilat e kanë të vërtetuar identitetin, pastërtinë varietore dhe shëndetin, e të cilat përdoren për prodhim të bimëve të reja ose të pjesëve të bimëve e që përdoren për prodhim të fidaneve të hardhisë së rrushit. Materiali fidanor standard duhet të etiketohet me etiketë të verdhë.

- e) CAC (Conformitas Agraria Communitati) nënkupton materialin shumues frutorë dhe pemëve që i plotësojnë kushtet minimale të përshkruara për këtë kategori relative në lidhje me llojet përkatëse.
- f) Materiali CAC duhet të paktën gjatë inspektimit vizuel të jetë kryesisht i painfektuar nga çfarëdo organizmi dhe sëmundje të dëmshme që zvogëlon përdorimin e materialit shumues ose pemëve. Organizmat e dëmshëm nga të cilët materialin fidanor duhet të jetë i painfektuar do të përcaktohen me Udhëzim Administrativ.
- g) CAC duhet të ketë identitet dhe pastërti të duhur ndaj gjinisë përkatëse ose llojit dhe duhet të ketë identitet dhe pastërti varietore

4.2. Përdorimi i kategorive të materialit fidanor para-bazë, të çertifikuar dhe materialit fidanor standard është i detyrueshëm gjatë prodhimit të materialit fidanor të hardhisë dhe pjesëve të saj.

4.3. Përdorimi i kategorive të materialit fidanor para-bazë, bazë të çertifikuar dhe materialit fidanor CAC është i detyrueshëm gjatë prodhimit të materialit fidanor dhe pemëve.

4.4. Për llojet e fidaneve pyjore janë përshkruar kategoritë vijuese të materialit fidanor:

- a) identifikimi sipas prejardhjes nënkupton materialin fidanor të prodhuar nga materiali bazë i cili mund të jetë nga fara ose pjesët e bimës me vendorigjinë të pranuar.
- b) i zgjedhur, nënkupton materialin fidanor të prodhuar nga materiali bazë i cili është i zgjedhur nga objektet e pranuar dhe i njihet vendorigjina. Materiali bazë zgjedhet sipas karakteristikave fenotipe në nivel të grumbullimit pyjor, grup drunjëve dhe drurët individual,
- c) i kualifikuar nënkupton materialin fidanor të prodhuar nga materiali bazë i cili rrjedh nga plantacionet farore, amëzave, kloneve ose përzirjet e kloneve. Përparësitë e cilësive të materialit bazë janë zgjedhur sipas karakteristikave fenotipe të grumbullit pyjor, grup drunjëve dhe drurët individual,
- d) i testuar nënkupton materialin fidanor të prodhuar nga materiali bazë i cili rrjedh nga drurët,

plantacionet, amëzat, klonet ose klonet e përziera. Përparësia e materialit fidanor do të shihet me anë të testeve krahasuese dhe me anë të vlerësimeve të materialit fidanor si dhe vlerësimit gjenetik të përbërësve të materialit bazë,

- e) Të gjitha kategoritë e materialit fidanor nga pika 4 duhet të jenë të paefektuara nga sëmundjet, dëmtuesit, mykoplazmat dhe virozat.

PRODHIMI I MATERIALIT FIDANOR

Neni 5

Materiali fidanor mund të prodhohet vetëm nga personat e regjistruar në Regjistrin e prodhuesve të materialit fidanor, me përjashtim të prodhuesve nga neni 3.7.

Neni 6

6.1. Prodhuesi i materialit fidanor do të prodhojë material vetëm të atyre llojeve dhe varieteteve të përfshira në Listën e Varieteteve të Kosovës, listë e cila mbahet nga Zyra e të Drejtave të Varietetit Bimor në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

6.2. Vënia e një varieteti të ri në Listën e Varieteteve të Kosovës do të rregullohet me Udhëzim Administrativ.

6.3. Ministria mund të autorizoj prodhimin e materialit fidanor të llojeve dhe varieteteve të caktuara të cilat nuk janë të përfshira në Listën e Varieteteve të Kosovës për qëllime hulumtuese.

Neni 7

7.1. Prodhuesi i materialit fidanor është i obliguar të mbajë shënime për sasinë, llojin dhe varietetin e materialit fidanor të prodhuar, tregtuar dhe të asgjësuar.

7.2. Prodhuesi i materialit fidanor është i obliguar të paktën një herë në vit ta njoftoj Departamentin e Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve mbi sasinë, llojin dhe varietetin e materialit fidanor të prodhuar, tregtuar dhe të asgjësuar.

7.3. Përmbajtja, forma dhe procedurat e mbajtjes së shënimeve të cekura në paragrafin (1) dhe (2) të këtij neni do të përcaktohen nga Ministria me Udhëzim Administrativ.

Neni 8

8.1. Ministria mund të lejoj prodhuesin ta shumojë materialin fidanor të varietetit i cili nuk është i përfshirë në Listën e Varieteteve të Kosovës për nevojat e një partneri të jashtëm dhe nga materiali prindor i importuar, me kusht që kontrata me partnerin e jashtëm ta obligoj atë ta blejë tërë sasinë e materialit fidanor të prodhuar.

8.2. Prodhimi i materialit fidanor i përmendur në paragrafin (1) të këtij neni do t'i nënshtrohet inspektimit të detyrueshëm shëndetësor nga inspektori i autorizuar nga Ministria.

KONTROLLIMI I PRODHIMIT TË MATERIALIT FIDANOR

Neni 9

9.1. Gjatë procesit të prodhimit materiali fidanor do t'i nënshtrohet kontrollit zyrtarë të cilësisë, pastërtisë varietore dhe shëndetësore nga Inspektorët e Ministrisë dhe pas raportit profesional nga Institucionet përkatëse shkencore.

9.2. Kontrolli nga paragrafi (1) i këtij neni, përcakton prejardhjen e materialit fidanor, autenticitetin e varietetit, gjendjen shëndetësore dhe cilësinë e materialit fidanor.

Neni 10

Materiali fidanor që i plotëson standardet e cilësisë dhe shëndetit të përshkruara në Udhëzim Administrativ do të çertifikohet nga Departamenti i Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Departamenti i Pylltarisë së MBPZHR dhe do të etiketohet në përputhje me rregullat e përcaktuara.

Neni 11

Prodhuesi i materialit fidanor është i obliguar që në prezencë të inspektorit të bëjë asgjësimin e materialit fidanor i cili nuk i plotëson standardet cilësore dhe shëndetësore.

Neni 12

12.1. Departamenti i Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve është i obliguar të mbajë shënime mbi kontrollin e fidanishteve nga të cilat prodhohet materiali fidanor, i pemëve, perimeve dhe hardhisë sipas llojeve, varieteteve dhe sasive të prodhuara të materialit të veçantë fidanor.

12.2. Departamenti i Pylltarisë mbanë shënime mbi kontrollin e materialit fidanor pyjor dhe fidaneve të bimëve zbukuruese pyjore.

CILËSIA E MATERIALIT FIDANOR

Neni 13

13.1. Cilësia e materialit fidanor përcaktohet nga prejardhja, autenticiteti i varietetit dhe llojit, zhvillimi vegjetativ dhe gjendja shëndetësore.

13.2. Cilësia e materialit fidanor duhet të plotësojë standardet e përshkruara në Udhëzimin Administrativ në bazë të propozimeve të Departamenteve për-

LIGJI PËR MATERIALIN FIDANOR

katëse të Ministrisë.

PAKETIMI DHE ETIKETIMI I MATERIALIT FIDANOR

Neni 14

- 14.1. Materiali fidanor i planifikuar për tregtim duhet të paketohet, mbyllet dhe etiketohet në përputhshmëri me procedurat e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ.
- 14.2. Paketimi, mbyllja dhe etiketimi i materialit fidanor do të kryhet nga prodhuesi, në vendin e prodhimit të këtij materiali.

TREGTIMI I MATERIALIT FIDANOR

Neni 15

- 15.1. Materiali fidanor do të tregtohet vetëm nga personat e regjistruar për atë veprimtari nga Ministria.
- 15.2. Materiali fidanor i cili do të tregtohet duhet të ruhet dhe transportohet në kushte të cilat do ta ruajnë cilësinë e materialit fidanor të përcaktuara me Udhëzim Administrativ.
- 15.3. Materiali fidanor i pemëve do të tregtohet vetëm si material fidanor bazë i çertifikuar ose material fidanor CAC – Conformitas Agraria Communitatis, nëse i përket varietetit që është në Listën e Varieteteve të Kosovës dhe nëse përputhet me standardet cilësore dhe shëndetësore të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ.
- 15.4. Materiali fidanor i hardhisë do të tregtohet vetëm si material fidanor bazë, i çertifikuar ose material fidanor standard, nëse i përket varietetit që është në Listën e Varieteteve të Kosovës dhe nëse përputhet me standardet cilësore dhe shëndetësore të përcaktuara me Udhëzim Administrativ.
- 15.5. Materiali Fidanor i perimeve do të tregtohet vetëm nëse i përket varietetit që është në Listën e Varieteteve të Kosovës dhe nëse përputhet me standardet cilësore dhe shëndetësore të përcaktuara me Udhëzim Administrativ.
- 15.6. Materiali fidanor pyjor do të tregtohet vetëm si material fidanor i identifikuar sipas burimit, i zgjedhur, i kualifikuar ose material fidanor i testuar nëse përputhet me standardet cilësore dhe shëndetësore të përcaktuara me Udhëzim Administrativ dhe është në Listën e Varieteteve të Kosovës.
- 15.7. Materiali fidanor i bimëve zbukuruese, drurëve dhe shkurreve do të tregtohet nëse përputhet me standardet cilësore dhe shëndetësore të përcaktuara

me Udhëzim Administrativ.

IMPORTIMI I MATERIALIT FIDANOR

Neni 16

- 16.1. Materiali fidanor do të importohet vetëm nga personat që janë të regjistruar për atë qëllim sipas nenit 3 të këtij Ligji.
- 16.2. Materiali fidanor bazë i çertifikuar, standard dhe material fidanor CAC – Conformitas Agraria Communitatis do të lejohet të importohet vetëm nëse i përket varietetit që është në Listën e Varieteteve të Kosovës dhe nëse është i shoqëruar me çertifikatë të prejardhjes dhe autenticitetit të llojit, çertifikatë fitosanitare, varietetit dhe llojit të lëshuar nga Autoriteti zyrtar i vendit eksportues, duke vërtetuar se materialit fidanor i plotëson kërkesat e këtij Ligji dhe Udhëzimeve Administrative.
- 16.3. Të gjitha dërgesat e materialit të importuar fidanor do të inspektohen zyrtarisht në pikat e vendhyrjes në Kosovë ose në lokalet e shfrytëzuesve të fundit, në përputhje me dispozitat e Ligjeve në fuqi, mbi shëndetin e bimëve lidhur me paraqitjen, shpërndarjen, asgjësimin e sëmundjeve dhe dëmtesve të bimëve, prodhime bimore dhe në objekte të destinuara.

Neni 17

- 17.1. Importuesi lejohet të tregtoj materialin e importuar fidanor në paketimin e vet origjinal.
- 17.2. Materiali fidanor i importuar duhet të jetë i etiketuar me etiketë të lëshuar nga Autoriteti zyrtar i vendit eksportues.

Neni 18

Importuesi është përgjegjës për cilësinë dhe autenticitetin e materialit fidanor të importuar.

Neni 19

Ministria mund të lejoj importin e materialit fidanor të një varieteti që nuk është në Listën e Varieteteve të Kosovës, me një leje të veçantë, me qëllim të hulumtimeve shkencore.

INSPEKTIMI

Neni 20

- 20.1. Kontrolli zyrtarë i cilësisë, paketimit, etiketimit, tregtimit dhe kontrollave të tjera të nevojshme të materialit fidanor, bëhet nga Inspektorët e Ministrisë sipas mënyrës së përcaktuar me Udhëzim Administrativ.
- 20.2. Kundër vendimeve të lëshuara nga Inspektorët

pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Ankesa i dërgohet Ministrisë.

- 20.3. Kundër vendimit të Ministrisë pala e pakënaqur mund të inicoj kontestin administrativ në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit. Ankesa nuk e pezullon zbatimin e vendimit.

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 21

- 21.1. Me gjobë në lartësi prej 1.000 € deri në 15.000 € dënohet për kundërvajtje personi i cili:

- a) prodhon, tregton dhe e vënë në qarkullim materialin fidanor e nuk është regjistruar në regjistrin e prodhuesve (neni 3) i këtij Ligji dhe Udhëzimeve Administrative,
- b) prodhon, tregton dhe vënë në qarkullim materialin fidanor, cilësia dhe shëndeti i të cilit është në kundërshtim me standardet e përcaktuara (neni 13) i këtij Ligji dhe Udhëzimeve Administrative,
- c) bënë importin dhe eksportin e materialit fidanor në kundërshtim me këtë Ligj (neni 16) dhe Udhëzimeve Administrative.,
- d) paketon, etiketon apo ruan materialin fidanor në kundërshtim me këtë Ligj (neni 14) dhe Udhëzimeve Administrative,
- e) nuk mbanë dhe nuk deklaron shënimet për sasinë, llojin dhe varietetin e materialit fidanor sipas (nenit 7) të këtij Ligji dhe Udhëzimeve Administrative,
- f) pengon personin e autorizuar zyrtarë në inpektimin e prodhimit, tregtimit, vënies në qarkullim, paketimit, etiketimit, ruajtjes dhe transportimit të materialit fidanor (neni 9, 10) i këtij Ligji dhe Udhëzimeve Administrative.

- 21.2. Për shkelje të përsëritura, përveç dënimit me gjobë, kundërvajtësit i merret licenca dhe hiqet nga regjistri i personave të regjistruar për prodhimin dhe tregtimin e materialit fidanor.

Neni 22

Të gjitha pagesat që rrjedhin nga aplikimi i dispozitave të këtij ligji derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

ZBATIMI

Neni 23

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është kompetente për të nxjerrë Udhëzime Administrative për zbatimin e këtij Ligji.

Neni 24

Çështja e regjistrimit dhe lartësia e taksave për regjistrim do të përcaktohen me Udhëzim Administrativ.

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 25

- 25.1. Pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji do të shfuqizohen dispozitat e të gjitha Ligjeve të aplikueshme për materialet fidanore e që janë në kundërshtim me këtë Ligj.

- 25.2. Çdo person që aktualisht prodhon, paketon, etiketon dhe tregton material fidanor në Kosovë do të paraqitet për leje sipas nenit 3 të këtij Ligji, jo me vonë se 30 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

HYRJA NË FUQI

Neni 26

Ky Ligj, pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës, hyn në fuqi në ditën e shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

28. 05. 2004
UNMIK/REG/ 2004/16